Gusht 2020
Numri: 149
E përmuajshme

ETIKA

Revistë edukative-kulturore - www.progresibotime.com

Shqipëri: 200 Lekë
Kosovë: 1.5 Euro
Maqedoni: 90 Den
Evropë: 7 Euro


Të ekzistosh apo të jetosh?


revistaetika progresibotime

PROGRESI
BOTIME

TË RINJ

Shtëpia botuese Progresi vjen me 2 libra të rinj, të cilët do të ushqejnë botën tonë shpirtërore dhe do t'i japin drejtim jetës sonë individuale dhe shoqërore.





SHQIPËRI: Rr: Studenti; Sheshi "2 Prilli"; Shkodër; Shqipëri | Mob: +355 67 340 6182 | e-mail: rev.etika@gmail.com
KOSOVË: Rr: Ardian Zurnaxhiu; pn. Ralin; Prizren; Kosovë | Mob: +377 44 566 577
MAQEDONI: Drvarska 28; Stara Carsija; Skopje; Makedonija | Mob: +389 7042 8245

Editorial

بسم الله الرحمن الرحيم

Shumë njerëz e ngatërrojnë të qenurit kontradiktor me hipokrizinë. E para, sipas çdo gjase, është pjesë e natyrës njerëzore (në jetën e kafshëve nuk ka kontradikta, as në atë të alienëve); ndërsa e dyta, jo se nuk është, por nuk duhet të jetë.

Një njeri që nuk ndryshon asnjëherë, që noton gjithnjë në të njëtët ujëra, që bën një jetë të ashquajtur lineare, që është i sigurt dhe i qartë për çdo gjë, që karakerizohet nga një gjendje pothuajse e njëjtë emocionale rezulton të ketë bërë vetëvrasje shpirtërore, pasi në një mënyrë apo në një tjetër ka flijuar botën e tij të brendshme.

Krahasimi i personazheve të Dostojevskit me tipat psikologjikë të Jung-t na tregon shumë në këtë drejtim: të parët janë të veçantë, të papritur, spontanë, dramatikë, me dilema, pasionantë e kështu me radhë; ndërsa të dytët janë të gjithë një prerje, të ftohtë, sikur janë bërë në laborator. Dallimi është themelor, po aq dhe paralajmërues.

Dostojevski na kumton se natyra njerezore është e paparashikueshme, dhe çdo përpjekje apo ambicie për ta parashikuar dhe përkufizuar është hapi i parë drejt dhunimit të lirisë.

Në fakt, te shumë shkrimtarë pas Dostojevskit, si Kafka, Joyce, Beckett-i, Camus, Zamjatin, Huxley, Orwell, Kavabata etj., një vend qendror në veprën e tyre zë pikërisht rrjedhoja e dhunimit të kësaj lirie përmes pushtetit të dijes racionale apo shkencore (në dhjetëra disiplina) për t'i vënë një emër të dytë njeriut, pra, për ta përkufizuar, për t'i treguar rrugën, për t'i dhënë një manual përdorimi të vetes.

Nëse romani i shekullit XIX, ndër të tjera na paralajmëronte se çfarë mund të bëjë një person që është i sigurt në vetvete, që nuk ka asnjë mëdyshje, që ndihet superior ndaj të tjerëve, që beson pa kushte në idhuj abstraktë si progresi1, romani i shekullit pasardhës, ndër të tjera, u fokusua edhe te pasojat e mosmarrjes parasysh të këtij paralajmërimi.

Kështu, romani na ndihmoi dy herë: njëherë duke na paralajmëruar, herën tjetër duke na treguar se çfarë ndodhi me ne, meqë nuk e morëm seriozisht herën e parë.

Trashëgimia e dishepujve të progresit sot është rënia e vazhdueshme e diversitetit gjithandej dhe një botë gjithnjë e më e zbrazur nga qëllimi, dhe për pasojë gjithnjë e më e përqendruar te funksioni. Natyrisht, njeriut po synohet t'i hiqet qoftë dhe funksioni, pasi në skenë kanë filluar të zënë vend me ngulm robotët e zgjuar, kopjet e menjëhershme të njeriut, që në një fazë më të zhvilluar do të arrijnë të shkruajnë edhe poezi (pa poezi), ashtu siç po bëjnë kafe pa kafeinë.

Kopjet e menjëhershme të njeriut do arrijnë të përmbushin çdo funksion, derisa njeriu ta ketë të gjithë kohën e lume në dispozicion për të bërë asgjënë e përsosur, për t'u çliruar më në fund një herë e mirë nga çdo orvatje për kuptim, pasi kjo asgjë e përsosur do të jetë në gjendje të përpijë çdo kuptim.

Revista ETIKA

Gusht 2020
VITI: XIV
NUMRI: 149

BOTUESI
Shtëpia botuese "Progresi"

DREJTOR
Albert Halili

KRYEREDAKTOR
Alban Kali

PËRKTHYES
Albert Halili
Fatmir Sulaj
Ilir Hoxha

DIZAJN
Bledar Xama

ADRESA
Rr: Studenti; Sheshi "2 Prilli"
Shkodër; Shqipëri

MOBILE
+355 67 340 6182

E-MAIL
rev.etika@gmail. com

WEBSITE
www.progresibotime.com

KOSOVË
Rr: Ardian Zurnaxhiu; pn. Ralin
Prizren; Kosovë
Mob: +377 45 639 143
Prishtinë; Kosovë
Mob: +377 44 566 577

MAQEDONI
Drvarska 28; Stara Carsija
Skopje; Makedonija
Mob: +389 7145 6003

ABONIMI VJETOR
Shqipëri: 2000 lekë
Kosovë: 15 Euro
Maqedoni: 900 Denar
Evropë: 80 Euro

Ju bëjmë të ditur
se materialet e sjella në redaksi
pavarësisht nëse botohen apo jo
nuk i kthehen autorit. Koha e botimit
të një materiali përcaktohet
nga redaksia. Honoraret e shkrimeve
autoriale ose përkthimeve duhet të
vini t'i tërhiqni pranë
Shtëpisë Botuese "Progresi"
ose pranë zyrave të përfaqësimit
në Kosovë dhe Maqedoni.



Përmbajtja









5 **Veprat janë pjesë e nënshtrimit tonë**
Nuredin Jëlldëz

10 **Mungesa e ndjeshmërisë ndaj hallallit dhe haramit**
Prof. dr. Ismail Lutfi Çakan

12 **Tamahu dhe sakrifica**
Ahmet Zijlan

16 **Të ringjallemi me Islamin**
Ali Riza Temel

18 **Kur humbësit kthehen fitimtarë**
Nuredin Nazarko

20 **Të ekzistosh apo të jetosh?**
Edison Çeraj

21 **Perceptimi i mirësisë hyjnore**
Ahmet Tashgetiren

24 **Ajaz Pasha, kryeveziri i palodhur që vdiq nga murtaja**
Dr. Ardian Muhaj



Zgjidhja për ndihmë ndaj indivitit, shoqërisë, umetit dhe njerëzisë gjendet në përshpirtje 28
M. Ali Eshmeli

Rëndësia e sunetit të të Dërguarit të Allahut (a.s.) 40
Mubarek Erkull

Koha për të jetuar esencën e Islamit 46
Rabia Brodbeck

Ti je xheneti im 48
Halime Demireshik

Fëmija i mbarë 54
Ferit Piku







Veprat janë pjesë e nënshtrimit tonë ndaj Zotit جل جلاله

Nuredin Jëlldëz

Forca që na bën të zgjohemi në momentin më të ëmbël të gjumit dhe na inkurajon për të marrë abdest, është besimi ndaj Allahut Teala dhe të vërtetës - llogarisë që do japim në Ditën e Gjykimit. Ky besim na e ndërpret gjumin dhe na shtyn që t'i hedhim fytyrës ujë, me qëllim që ta largojmë atë. Në të njëjtën mënyrë, ky besim është me ne edhe kur i japim lëmoshë ndonjë të panjohuri, ndërsa dhurojmë nga ajo që kemi fituar me mundin tonë. Edhe kur zgjedhim të provojmë urinë dhe etjen në muajin e Ramazanit, edhe pse nuk ka ndonjë kontroll evident, qëndrojmë brenda kornizës së këtij besimi. Edhe kur nxjerrim rrobat dhe veshim ihramin, përsëri jemi një me këtë besim.

E vërteta e përhershme për ne është kjo: Nëse urdhëron Zoti (xh.xh.), e bëjmë. Nëse e ndalon Zoti (xh.sh.), largohemi nga ajo që ka ndaluar. Ne nuk e konsiderojmë si të rëndë asgjë që ka urdhëruar Ai dhe as e konsiderojmë si të pashmangshme çka ai na ka ndaluar. Ne jemi robërit e Atij. Robi është nën urdhërat e Zotit të tij. Robi nuk mund të ketë ndonjë alternativë tjetër përveçse të qënit nën urdhrin e Zotit. E gjithë jeta dhe çdo element i rrjedhës së saj ndahen në dy grupe: në çka duhet të bëjmë dhe çka nuk duhet të bëjmë, për hir të Allahut Teala.

Fakti që namazi dhe agjërimi vijnë në krye të veprave që bëhen për hir të Allahut (xh.sh.), nuk do të thotë se janë të vetmet vepra që bëhen për hir të Tij. Njeriu është rob i Allahut. Jeta është mirësi që na e ka dhënë vetë Allahu Teala. Mirësitë dhe sprovat vijnë po nga Allahu. Robi i Allahut, me të njëjtin devocion që falë namazet apo agjëron, duhet të kryejë edhe veprimet e tjera, ndonëse ato nuk perceptohen si adhurime direkte, siç ndodh me namazin dhe agjërimin. Pra çdo veprim duhet të pasqyrojë bindjen e të qënit një rob i Allahut të Lartësuar. Meqë Allahu Teala do ta marrë në llogari robin e Tij për çdo minutë të jetës që i ka dhuruar dhe meqë kjo llogari nuk do të jetë e kufizuar vetëm tek namazet dhe agjërimet, besimtari i vërtetë duhet të përpiqet

që të jetë i përgatitur per këtë në çdo minutë të jetës së vet. Ne besojmë prerazi se në llogari do të përfshihet e gjithë jeta jonë. Allahu Teala është Ai që e ka krijuar të gjithë jetën, si rrjedhojë edhe llogaria do të jetë në lidhje më tërësinë e saj.

Një besimtar që e sheh si gjithëperfshirës nënshtrimin ndaj Zotit (xh.xh), namazin duhet ta konsiderojë si domosdoshmëri në kuptimin e të qenët besimtar dhe ta zbatojë siç është urdhëruar. Edhe pasi të falë namazin dhe të kalojë tek punët e tregtisë, duhet të jetë i vetëdijshëm se Zoti që e vëzhgon në namaz dëshiron që ta shikojë si besimtar edhe në tregti. Për këtë arsye duhet t'i respektojë rregullat e haramit dhe hallallit edhe aty. Sado që nuk gjendet me abdest dhe i drejtuar nga kibla, nëse përkujdeset në tregti njëlloj siç bën në namaz, ai do arrijë ta mbrojë karakterin prej besimtari dhe do të zbatojë rregullat e një tregtie të pastër nga kamata duke ruajtur kështu standardin e besimtarit, që nuk njeh hile dhe nuk përzihet me haramin. Besimtari e jep zekatin kur vjen koha për ta dhënë dhe kthehet në mbrëmje në shtëpi pasi ka fituar kënaqësinë e Allahut Teala. Ai kthehet pasi e ka arritur sevapin nga Allahu për paratë që ka fituar. Në këtë mënyrë, xhamia bashkohet me dyqanin. Namazi dhe tregtia zënë vend në të njëjtën listë. Botëkuptimi Islam që e rrethon të gjithë jetën e besimtarit kalon nga teoria në praktikë.

Kur besimtari bëhet prind, krijohet idea se po përjeton njërën prej etapave më të domosdoshme të jetës së kësaj bote, por në të vërtetë, çka ai po përjeton është një periudhë në të cilën Zoti (xh.xh.) po teston nënshtrimin ndaj Tij, njëlloj siç e teston përmes namazit dhe agjërimit. Prindërimi mund të jetë burim sevapi ose shkak për të hyrë në zjarr. Besimtari nuk mund të qëndrojë vetëm në nivelin e të parit të fëmijës si një amanet të Allahut. Me të vërtetë që ai fëmijë është një amanet, por edhe procesi i rritjes së tij duhet të perceptohet nga mendja e besimtarit si një sprovë. Besimtari duhet të synojë të mos gabojë përgjatë këtij procesi, siç përpiqet të mos gabojë përgjatë faljes së namazit. Nëse gabon, duhet t'i kërkojë falje Allahut Teala, njëlloj siç bën sexhden e harresës kur gabon përgjatë namazit. Në sajë të këtij perceptimi, vetëdija e të konsideruarit të detyrës së prindërimit si të barasvlefshme me faljen e namazit, bën që edhe nëse ky besimtar vdes, të jetë prej atyre që nuk u mbyllet libri i veprave. Kjo e mban të gjallë atë edhe në varrin e tij.

Edhe kur besimtari të bëhet bashkëshort, i qëndron me burrëri këtij niveli të nënshtrimit ndaj Zotit (xh.xh.).

Edhe kur të bëjë punën e avokatit si përfaqësues i njërës palë në ndonjë padi, atë e orienton mbikëqyrja e Allahut Teala para firmës së klientit të tij.

Ai është besimtar edhe kur ecën në rrugë, edhe kur ndan parkun me të tjerët, edhe kur përdor shkallët e pallatit, edhe kur pi çaj për qejf në ballkonin e shtëpisë. Ky perceptim buron nga vetëdija e të jetuarit sipas sheriatit të Allahut Teala, i cili dëshiron të na shohë si besimtarë në çdo vend dhe në çdo kohë. Një besimtar i tillë është një besimtar që fiton. Besimtari është ai që fiton në xhami, në dyqan, kur hipën në autobus, kur luan me fëmijën, kur bisedon me bashkëshorten dhe kur viziton të afërmit. Ky besimtar, nga njëra anë fiton kënaqësinë e Zotit (xh.xh.), ndërsa nga ana tjetër fiton këtë botë. Ai gjithmonë fiton. Pra, fiton në adhurim, në vepra, në çdo vend dhe në çdo rrethanë.

NJË LIBËR BAZË NË LIDHJE ME VEPRAT

Kitabu'l-Kesb

Ky është një libër i Imam Muhamedit, i cili ishte njëri prej tre imamëve të parë të medhhebit Hanefi. Kjo është një vepër e rëndësishme në përcaktimin e kufijve të hallallit dhe haramit në lidhje me fitimin. Kur e pyetën Imam Muhamedin se përse nuk kishte shkruar një libër në lidhje me devotshmërinë, domethënë, një libër në lidhje me kufijtë e ndjeshëm të Islamit, ai ishte përgjigjur se kishte shkruar librin me titull Kitabu'l-Kesb. Siç edhe kuptohet, rrugët e fitimit për njeriun dhe marrëdhëniet sociale, sipas këtij imami të madh, përbëjnë bazën e devotshmërisë.

Këtë libër Imam Serahsi, i cili ishte njëri prej muxhtehidëve të medhhebit Hanefi, e ka shpjeguar duke u bërë kështu shkak për arritjen e tij deri në ditët e sotme. Ky libër i bukur duhet të gjejë vend në memorien tonë si një vepër e rëndësishme në lidhje me të dhënat themelore për hallallin, haramin, pasurinë dhe mënyrat e fitimit.

E LEHTA E VËSHTIRA

Mehmet Dinç

Njeriu nuk e ka aspak të lehtë të fitojë pëlqimin e prindërve, t'i kënaqë ata, të përpiqet të bëjë çdo gjë që t'ua rifitojë zemrat nëse ua ka thyer në ndonjë mënyrë, t'ua plotësojë edhe kërkesat që i duken të pakuptimta dhe t'i durojë fjalët, qortimet dhe kritikat e thëna në momente zemërimi. Zgjidhja e lehtë është që njeriu ta vazhdojë jetën ditore, pa u shqetësuar aspak për ta, por kjo ka pasojë vështirësinë e ditëve të ardhshme kur njeriu t'i kujtojë ditët e festave që ka pas përjetuar në të kaluarën, dhe të thotë: "Ah sikur prindërit të ishin gjallë dhe të qëndroja pranë tyre pa u zemëruar aspak, edhe pse mund të thoshin ndonjë fjalë të rëndë!"

Njeriu nuk e ka aspak të lehtë që të formojë me bashkëshorten një marrëdhënie të mbështetur te dashuria, respekti dhe sakrifica. Gjithashtu, nuk e ka aspak të lehtë ruajtjen e këtyre vlerave, pa ia lëkundur themelin. Zgjidhja e lehtë është që të lësh në një qoshe mendjen e durimin, dhe të shkosh në drejtimin në të cilin të zvarrisin dëshirat vetjake. Ndërsa vështirësia vjen kur nuk ngopet dot zemra, kur detyrimisht ha ndonjë gjë krejt pa oreks në ndonjë lokal modest, në mbrëmjen e një dite të ftohtë.

Njeriu nuk e ka aspak të lehtë që të gjejë kohë për fëmijët, të përpiqet t'i kuptojë ata dhe të mundohet të gjejë pika të përbashkëta, në mënyrë që të ndajë me ta disa gjëra. Zgjidhja e lehtë është t'i lësh fëmijët në botën e tyre dhe të vazhdosh jetën në botën tënde, ndërsa e vështira është që të përpiqesh për fëmijët, në mënyrë që të ndjesh ngrohtësinë kur fëmija të përqafon dhe të thotë me gjithë zemër: "Babi!"

Njeriu nuk e ka aspak të lehtë që të jetë i informuar për hallet dhe gjendjen e miqve apo shokëve të tij, në mënyrë që të përpiqet t'ua lehtësojë hallet atyre, të mundohet t'ua plotësojë nevojat dhe të bëjë sakrifica materiale e fizike për ta, kur të jetë e nevojshme. Zgjidhja e lehtë është që njeriu t'i formojë marrëdhëniet sipas interesave, të qëndrojë pranë të fortit dhe të gjendet larg të dobëtit, ndërsa e rëndë është që njeriu të mos ketë askënd që mund ta vizitojë kur të bjerë i sëmurë në spital.

Njeriu nuk e ka aspak të lehtë që të përpiqet përgjatë gjithë jetës që t'i kënaqë njerëzit, të mundohet të bëjë mirë me të gjitha mundësitë, të mos bëjë keq nëse nuk mund të bëjë mirë, dhe të shfaqë ndjeshmërinë e kujdesin më të madh në marrëdhëniet me nënën, babanë, bashkëshorten, fëmijët, miqtë dhe të afërmit. Zgjidhja e lehtë është që njeriu ta vendosë veten në qendër dhe të formojë marrëdhënie me njerëzit vetëm për nevojën tij, ndërsa e rënda është që njeriu të mos ketë askënd që ta përcjellë dhe të derdhë lot pas tij, kur të shkojë në Botën tjetër.





Busulla e Zemrës për orientimin në vepra

Dr. Adem Ergyl

Adhurimi ndaj Allahut Teala është misioni ynë më themelor, i cili duhet të praktikohet në të gjitha fushat e jetës. Për ta kryer këtë mision në mënyrën e duhur, kërkohet të bëjmë një jetë brenda kornizës dhe kufijve që ka vendosur Zoti i Lartësuar. Për ta realizuar këtë qëllim në adhurime, në botën e besimit, në sjelljet etike dhe në marrëdhëniet ndërmjet njerëzve e gjërave që i quajmë vepra, udhëzimet e Allahut dhe të të Dërguarit të Tij pa dyshim që janë udhërrëfyesit tanë më themelorë.

Gjatë rrjedhës së jetës, përballemi me situata që ndryshojnë në varësi të kohës, vendit dhe kushteve sociale. Nganjëherë mund të përjetojmë dilema në raport me një qëndrim të caktuar që duhet të mbajmë në secilën prej këtyre situatave. Këto dilema burojnë nga fakti se, brenda dispozitave që ka caktuar Allahu Teala dhe Pejgamberi ynë i nderuar në lidhje me kornizën e jetës, disa prej tyre janë krejtësisht të qarta dhe të kuptueshme lehtësisht, e disa jo. Pra shpesh hasim edhe në çështje që mund të na detyrojnë të ndalemi që të çmojmë si duhet situatën dhe për të cilat mund të kemi vështirësi për të dhënë një vendim. I Dërguari i Allahut, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të, flet si më poshtë në lidhje me këtë çështje:

"Gjërat që janë hallall janë të qarta. Edhe gjërat që janë haram janë të qarta. Ndërmjet këtyre të dyjave ka edhe çështje të dyshimta, për të cilat shumë njerëz nuk e dinë nëse janë hallall apo haram. Ata që largohen prej çështjeve të dyshimta, e mbrojnë fenë dhe nderin e tyre. Ndërsa ata që nuk ruhen prej çështjeve të dyshimta, gradualisht zhyten në haram. Kjo është pikërisht si çështja e një bariu që e kullot kopenë e tij rreth e qark një toke që i përket dikujt tjetër. Ai gjithmonë përballet me rrezikun e hyrjes së kopesë në atë tokë.

Bëni kujdes! Çdo mbret ka një vend që është e ndaluar hyrja. Mos harroni se edhe vendi i ndaluar i Allahut janë gjërat që i ka bërë haram." (Buhari, Iman, 39, Buju', 2; Muslim, Musakat, 107.)

Pra, çdo mysliman që e merr seriozisht nënshtrimin ndaj Allahut Teala, para së gjithash ka përgjegjësinë që të njihet me gjërat hallall dhe haram, në lidhje me çdo fushë të jetës së tij. Furnizimi me një dije të tillë është obligim për çdo mysliman. Prandaj myslimanët duhet t'i mësojnë kufijtë hyjnor që lidhen me secilën fushë të jetës, duke u informuar nga njohësit e mirë të temës. Secili nga ne mund të ketë çështje të ndryshme për të cilat i nevojiten njohuri të reja. Për shembull, ata të cilët punojnë në fushën e tregtisë kanë obligim mësimin e dispozitave në lidhje me tregtinë, mjekët kanë obligim të mësojnë ligjet hyjnore në lidhje me fushën e mjekësisë. Në të njëjtën mënyrë, edhe ata që janë të martuar kanë përgjegjësinë për të pyetur dhe për të mësuar çështjet që lidhen me jetën familjare. Andaj, besimtarët janë të obliguar të mësojnë parimet hyjnore dhe profetike në lidhje me të gjitha çështjet e jetës.

Siç thuhet edhe në hadithin fisnik, nganjëherë mund të ndeshemi me disa çështje që nuk e kanë të qartë plotësisht dispozitën e tyre. Në situata të tilla, rruga që duhet të ndiqet bëhet disi e paqartë. Prandaj, në këto lloj situatash ndjejmë nevojën për

një busull që të na orientojë drejt të vërtetës. Ja pra, kjo busull është ndërgjegjja apo zemra jonë, për aq kohë sa nuk e ka humbur ndjeshmërinë dhe gjallërinë.

Vabisa ibn Ma'bedi (r.a.), tregon: "Shkova te i Dërguari i Allahut, (a.s.).

Ai më tha: *'Mos ke ardhur për të pyetur se çfarë është mirësia?'*

Unë iu përgjigja: 'Po, o i Dërguari i Allahut.'

Atëherë, hz. Pejgamberi (a.s.), më tha: *'Konsultohu me zemrën tënde! Mirësia është ajo ndjenjë, të cilën ta pranon ndërgjegjja dhe ta aprovon zemra. Ndërsa mëkat është ndjesia që ta bren shpirtin, që të bën të dyshosh dhe të hezitosh edhe pse të tjerët të japin fetva për ta bërë."* (Ahmed b. Hanbel, Musned, IV, 227-228; Darimi, Buju', 2.)

Në të vërtetë, çdo zemër që nuk e ka humbur krejt dëlirësinë dhe pastërtinë e natyrshmërisë, në një lloj mënyre e kupton të vërtetën. Ky kuptim bëhet edhe më i përpiktë me rritjen e masës së besimit dhe devotshmërisë. Kjo ndjesi mund të humbasë me kalimin e kohës për shkak të mëkateve dhe gjynaheve. Madje ajo humbet krejtësisht, kur bëhet fjalë veçanërisht për mohim, këmbëngulje në mohim dhe hipokrizi. Për shkak të këtyre ndotjeve, zëri i ndërgjegjes nuk mund të dëgjohet ndërmjet zhurmave të dëshirave të nefsit dhe pëshpëritjeve të djallit të mallkuar.

Para se njeriu të konsultohet për ndonjë çështje me zemrën vet, duhet të shkojë te dijetarët e devotshëm që e njohin mirë çështjen dhe që punojnë me dijen e tyre dhe t'i pyesë. Pastaj duhet të veprojë në bazë të përgjigjes që i jep prehje zemrës së tij. Nëse akoma ka dyshim në zemër, më mirë të mos e bëjë fare, sepse këshilla e të Dërguarit të Allahut, (a.s.), në lidhje me këtë çështje është: *"Largohu nga gjithçka që të bën të dyshosh dhe merru me atë që nuk të sjell dyshim!"* (Tirmidhi, Kijamet, 60.)

Një çështje tjetër, për të cilën njeriu duhet të ketë kujdes, është gabimi i marrjes fetva nga nefsi duke pretenduar se në pyetje po merret zemra. Shenjë e qartë e kësaj gjendjeje është neglizhimi i dispozitave, edhe kur ato janë qartësisht të përcaktuara, dhe përpjekja për të kërkuar fetva që duken më të përshtatshme ndaj interesave dhe dëshirave. Kjo gjendje është devijim në rrugë të mjegullt ndërkohë që ekziston rruga e qartë. Pas një kërkimi të tillë, vijon hapi i dytë i nefsit, që është përpjekja për ta legjitimuar rezultatin dhe për të justifikuar vendimin a veprimin. E gjithë kjo, në të vërtetë është një mashtrim i njeriut ndaj vetvetes. Kurani Fisnik, këto lloj sjelljesh dhe veprimesh shpesh herë i konsideron si gjendje hipokrizie.

Diferencimi ndërmjet zërave të ndërgjegjes apo zemrës nga pëshpëritjet që vijnë nga nefsi, ka lidhje shumë të fortë me sinqeritetin që njeriu ka kundrejt vetes dhe Zotit (xh.sh.). Me të vërtetë, Allahu Teala do t'ia tregojë rrugën atij që kërkon të vërtetën sinqerisht dhe ndoshta do ta orientojë nëpërmjet frymëzimeve. Këshillat e mëposhtme të të Dërguarit të Allahut, (a.s.), janë një udhërrëfyes orientues, për momentin në të cilin bëjmë vlerësimin në lidhje me zërat që vijnë nga brenda:

"Padyshim që engjëlli dhe shejtani kanë ndikim orientues mbi zemrën e birit të Ademit. Ndërkohë që ndikimi i shejtanit bëhet nëpërmjet premtimeve që e shtyjnë njeriut drejt ligësisë dhe që përgënjeshtrojnë të vërtetën, ndikimi i engjëllit bëhet nëpërmjet premtimeve për mirësi dhe që pohojnë të vërtetën. Ai që e ndjen në zemër ndikimin e engjëllit për mirësi, le ta dijë se vjen prej Allahut dhe ta falënderojë Atë. Ndërsa ai që ndjen një ndikim që përpiqet ta tërheqë drejt ligësisë, le t'i kërkojë mbrojtje Allahut të Madhëruar nga shejtani dhe e keqja e tij." (Tirmidhi, Tefsir, 2.)

Sipas njerëzve të ditur e të urtë, mendimet e para që vijnë në zemër, në shumicën e rasteve, janë frymëzime për mirësi dhe për të vërtetën. Andaj është e rëndësishme që njeriu ta vlerësojë këtë mundësi, sepse këto lloj ndjenjash të bukura do ta humbasin fuqinë dhe ndikimin e tyre pas një kohe të shkurtër, për shkak të sulmeve të nefsit dhe shejtanit.

Fetvatë e dhëna prej dijetarëve në lidhje me kufijtë e ligjshëm, pothuajse në çdo fushë të jetës sonë, janë të rëndësishme dhe kanë rolin e një harte që na tregon rrugën e drejtë. Por rruga më e sigurt është ajo në të cilën njeriu i drejtohet devotshmërisë duke shfaqur një ndjeshmëri gjithnjë e më të madhe, dhe nuk shkon rreth e rrotull kufijve të haramit. Pikërisht kjo rrugë është zgjedhja më e mirë në aspektin e sigurisë së tij dhe nderit e vlerës së vet tek Allahu (xh.sh.). Atijje ibn Urve es-Sa'di (r.a.), transmeton se i Dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, ka thënë:

"Një rob nuk mund të arrijë gradën e devotshmërisë, nëse nuk arrin të qëndrojë larg edhe nga gjërat që nuk kanë ndonjë problem për t'u bërë, prej frikës se mos hyn në mëkat." (Tirmidhi, Kijamet, 19.)

Së fundmi, mund të themi se, për të arritur tek veprimi i drejtë mund të duhet të gërmojmë ndër burimet e sakta të dijes e tek dijetarët e devotshëm dhe pastaj të ndjejmë prehjen dhe aprovimin e zemrës së ndjeshme dhe të gjallë. Aq sa shtohen ndjenjat e besimit dhe devotshmërisë, po aq i shtohen edhe busullës së zemrës mundësitë për të treguar të vërtetat.



MUNGESA E NDJESHMËRISË NDAJ HALLALLIT dhe HARAMIT

Prof. dr. Ismail Lutfi Çakan

Për fat të keq, e vërteta e hidhur është se po jetojmë dhe po ndajmë me të tjerët një mjedis në të cilin kufijtë hallall-haram pothuajse janë zhdukur tërësisht apo janë përzier me njëri-tjetrin, aq sa është e vështirë të ndahen. Mungesa e ndjeshmërisë ndaj hallallit dhe haramit, e cila po inkurajohet nga çmenduria e pasionit për materializmin dhe jetesës pa kufizime, gjendet në radhët e para të sëmundjeve sociale dhe etike që janë bërë serioze dhe janë përhapur në masë ditëve të sotme.

Nëse individët, familjet dhe klasat e shoqërisë do t'i rishikonin me sinqeritet njëzet e katër orët e ditës së tyre, edhe nëse nuk do ta pohojnë dot, do ta kuptojnë mungesën e ndjeshmërisë në këtë çështje. Punimet e standardit të ushqimit hallall që po diskutohen këto vitet e fundit, nga njëra anë janë pohim i qartë i mungesës së ndjeshmërisë për të cilën po flasim, në fushën e ushqimit, dhe nga ana tjetër janë përpjekje për t'i vetëdijesuar njerëzit në lidhje me këtë çështje.

Përqasja dhe sistemi sundues, që i japin drejtim jetës ditore, janë larg bazës islame. Prandaj, veçanërisht nga shkatërrimi i ndjeshmërisë ndaj hallallit dhe haramit që Islami ua jep njerëzve, ky sistem merr një kënaqësi sadiste. Metodat e punimit, në qarqet e prodhimit, nuk e ndjejnë aspak nevojën e një rregulli si ndjeshmëria ndaj hallallit dhe haramit, në asnjë fazë të prodhimit -as në zgjedhjen e përmbajtjes së produkteve që përdorin, as në paketimin e prodhimeve, as në reklamimin e tyre etj. Për fat të keq, edhe shumica dërrmuese e klientëve myslimanë, preferojnë të sillen si krijesat që kullosin dhe ecin të lira e pa kujdes në livadh. Kjo atmosferë e ngatërruar dhe e egër që me dashje apo pa dashje e pranojnë si modernizim, zhvillim dhe përparim, gradualisht po hedh rrënjë në çdo vend.

Tek individët e një shoqërie/umeti që e përjetojnë këtë mangësi të ndjeshmërisë në tregje dhe pazare, del në plan të parë një liri e plotë e ndjenjave epshore dhe seksuale që e nxit regjimi i ushqyerjes dhe ushqimet vetë. Ndërsa virtyteve si pastërtia e zemrës, mprehtësia e mendjes dhe morali i shoqërisë, po iu bie çdo dite e me shumë ndikimi dhe rëndësia.

Dëmtimi afatgjatë dhe afatshkurtër që shkaktojnë në strukturën fizike të trupit ushqimet e prishura dhe të modifikuara gjenetikisht, si dhe kalbjet apo shqetësimet që formojnë ushqimet haram në strukturën shpirtërore të trupit, e kanë vënë shoqërinë ballë për ballë me sëmundje të pashërueshme.

Mungesa e ndjeshmërisë ndaj hallallit dhe haramit vihet re deri edhe në vendet islame, të cilat janë pjesët e umetit, si dhe në marrëdhëniet e këtyre vendeve me njëra-tjetrën. Shprehitë dhe komentet

mendjelehta që fillojnë me frazën "në këtë shekull" dhe që i konsiderojnë haramet si të rënda apo si të panevojshme, po ndjehen dhe po shikohen tek individët e shtresave të ndryshme të shoqërisë, madje po trajtohen si shprehje të larta të kulturës moderne që nuk njeh kufi dhe që është përhapur nga mjetet e komunikimit social.

Paralajmërimet e pafajshme që të kujtojnë ndjeshmërinë ndaj hallallit dhe haramit shpesh herë nuk shpëtojnë dot nga ofendimet e rënda. Ata që dëshirojnë të jenë të ndjeshëm dhe të kujdesshëm kundrejt harameve, po fajësohen edhe në ditët e sotme, siç ka ndodhur në të kaluarën kur i akuzonin në formën: ***"...Ata janë njerëz që duan të rrinë të pastër."***[1]**.** Kjo është një e vërtetë mjaft e hidhur.

Shprehja "të gjithë apo shumica veprojnë kështu" po konsiderohet si justifikim ndaj mungesës së ndjeshmërisë. Kjo dëshirë për ta treguar si normale këtë rënie të shoqërisë, është edhe një gabim tjetër që aplikohet shpesh herë, apo edhe një mashtrim i shejtanit.

Ndërkohë, në hadithin fisnik thuhet: *"Gjërat që janë hallall janë të qarta. Edhe gjërat që janë haram janë të qarta. Ndërmjet këtyre të dyjave ka edhe çështje të dyshimta për të cilat shumë njerëz nuk e dinë nëse janë hallall apo haram. Ata që largohen prej çështjeve të dyshimta, e mbrojnë fenë dhe nderin e tyre. Ndërsa ata që nuk ruhen prej çështjeve të dyshimta, gradualisht zhyten në haram. Kjo është pikërisht si çështja e një bariu që e kullot kopenë e tij rreth e qark një toke, e cila i përket dikujt tjetër. Ai gjithmonë përballet me rrezikun e hyrjes së kopesë në atë tokë.*

Bëni kujdes! Çdo mbret ka një vend që është e ndaluar hyrja. Mos harroni se edhe vendi i ndaluar i Allahut janë gjërat që i ka bërë haram.

Dijeni mirë, se në trupin e njeriut gjendet një copë mishi e vogël. Nëse kjo copë mishi do të jetë mirë, i gjithë trupi bëhet mirë. Nëse ajo prishet, prishet i gjithë trupi. Ja pra, kjo copë mishi është zemra."[2]

Më sipër u trajtua mungesa e ndjeshmërisë për çështjet që janë hallall dhe haram në një formë të qartë dhe të hapur. Gjithashtu ka edhe çështje për të cilat ka dyshime apo paqartësi në të kuptuarit nëse janë hallall apo haram. Pakujdesia e shoqërisë për sa i përket kësaj teme, për fat te keq, është shumë më e madhe.

Në të vërtetë, qëndrimi larg çështjeve, të cilat nuk ndahen lehtë nëse janë hallall apo haram, përbën bazën e fetarisë. I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë: *"Një rob nuk mund të arrijë gradën e devotshmërisë derisa të mos qëndrojë larg edhe nga veprimet që nuk kanë ndonjë problem për t'u bërë, prej frikës se mos hyn në gjynah."*[3]

Abdullah ibn Omeri, Allahu qoftë i kënaqur prej tij, ka thënë: "Zemra e një robi nuk mund ta arrijë devotshmërinë e vërtetë derisa të mos e lërë një punë tek e cila dyshon."[4]

Afrimi te punët e dyshimta, siç shprehet edhe në hadithin fisnik[5], është sikur të shkosh rreth e rrotull një vendi të ndaluar. Pra, në çdo moment ekziston mundësia për të rënë në haram. Për këtë arsye, duhet të veprojmë siç shprehet edhe populli ynë: "Më mirë të rrimë zgjuar se sa të shohim ëndrra të tmerrshme!". Kjo do të thotë që duhet t'i largohemi gjërave të dyshimta dhe duhet ta mbajmë të gjallë ndjeshmërinë ndaj hallallit e haramit, në mënyrë që të shpëtojmë menjëherë nga shumë probleme.

Dyshimi e vendos njeriun ndërmjet mashtrimit e të vërtetës, ndërmjet haramit dhe hallallit. Në përgjithësi, dyshimi e afron më shumë njeriun nga mashtrimi dhe harami. Nisur nga këto që thamë, "largimi nga veprimet që të ndjellin dyshime dhe të mjaftuarit me gjithçka për të cilën nuk dyshon"[6], pra të larguarit të një rreziku që ende nuk ka lindur, edhe pse nganjëherë në aparencë duket sikur sjell humbje, në të vërtetë është një veprim i zgjuar dhe fitimprurës.

Atëherë, gjëja më e mirë që mund të bëjmë është të qëndruarit larg vendeve të rrezikshme dhe plotësimi i nevojave me hallall. Enesi (r.a.), transmeton se i Dërguari i Allahut, (a.s.), gjeti një hurmë në rrugë dhe tha: *"Po të mos shqetësohesha nga mundësia se kjo hurmë mund të jetë lëmoshë, do ta haja."*[7]

Vetëdija dhe ndjeshmëria ndaj hallallit dhe haramit mund të mbahen të gjalla me veprime të kujdesshme kundrejt gjërave të dyshimta. Qëndrimi që duhet të mbahet kundrejt situatave të dyshimta kërkon një seriozitet dhe përkushtim të jashtëzakonshëm, veçanërisht në ditët e sotme dhe në shoqërinë tonë, ku kufijtë e haramit po shkatërrohen me shpejtësi.

Të qëndruarit larg mendimit "a thua vallë", domethënë, heqja dorë nga veprimet dhe situatat e paqarta, do ta shpëtojë myslimanin nga shqetësimi shkatërrues i dyshimit të rënies në mëkat, do t'ia shtojë atij ndjeshmërinë kundrejt hallallit e haramit dhe umetit do t'i japë një strukturë të shëndetshme e të pastër.

1. A'raf, 82; Neml, 56.

2. Buhari, Iman 39, Buju' 2; Muslim, Musakat 107, 108. Vëçanërisht shik. Ebu Davud, Buju' 3; Tirmidhi, Buju' 1; Nesai, Buju' 2, Kudat 11; Ibn Maxhe, Fiten 14.

3. Tirmidhi, Kijamet, 19; Ibn Maxhe, Zuhd, 24.

4. Shik. Buhari, Iman, 1.

5. Shik. Buhari, Iman, 39, Buju', 2; Muslim, Musakat, 107-108.

6. Buhari, Buju', 3; Tirmidhi, Kijamet, 60; Nesai, Kaza, 11.

7. Buhari, Buju', 4, Lukata, 6; Muslim, Zekat, 164-166. Veçanërisht shik. Ebu Davud, Zekat, 29.



Tamahu dhe sakrifica...

Ahmet Zijlan

Paraja është edhe mirësi, edhe bela. Pasuria është edhe mirësi, edhe fatkeqësi... Këtë e shkaktojnë shumë shkaqe të ndryshme. Njëri prej këtyre shkaqeve janë njerëzit e shumtë që kanë lakmi. Me këtë po deshët nënkuptoni ata që kanë smirë e zili, apo po deshët nënkuptoni ata që me të vërtetë u nxihen sytë për shkak të nijetit të keq. Prandaj pasuria nganjëherë mund të shndërrohet edhe në fatkeqësi. Për këtë arsye, njerëzit që kanë mundësi ekonomike duhet të kenë shumë kujdes ndaj njerëzve që i rrethojnë. Ata nuk duhet ta shfaqin veten të fuqishëm. Përpjekja për t'u shfaqur më i pasur dhe më i fuqishëm seç je, mund t'i shkaktojë probleme njeriut. Por për fat të keq, njerëzve u mësohet plotësisht e kundërta e kësaj.

Në Kazakistan kam pasur një të njohur turk. Ndërsa po bisedonim një ditë, i thashë: "Paraqitja jote duket më e madhe seç je." "Për shembull?" – më pyeti. Unë iu përgjigja: "Ti je te dhjeta nga aspekti i pasurisë dhe fuqisë, por pamja jote tregon sikur je te pesëdhjeta." Ai ma ktheu: "Atëherë do të thotë se paskam mangësi! Unë duhet të shfaqem njëqind, sepse kjo kohë u jep vlerë të pasurve dhe të fuqishmëve." Por në ajetin fisnik thuhet kështu: ***"...Jini të drejtë!.."*** (Hud, 112; Shura, 15.) Pra, të jemi të devotshëm dhe të veprojmë sipas urdhrave të Zotit (xh.sh.). Të vërtetën nuk duhet ta shprehim vetëm me gjuhë, por atë duhet ta reflektojmë edhe me gjendjen tonë... A nuk do të ishte devijim nga rruga e drejtë përpjekja për t'u shfaqur i ndryshëm nga seç je? A nuk do të ishte mashtrim i njerëzve kjo gjë? Çfarë thotë Mevlana: "Ose duku siç je, ose ji siç dukesh!"

Për fat të keq, në kohën tonë po përballemi me gjëra mjaft shqetësuese. Biseda që zhvillohen me plot mendjemadhësi, shfaqjet e tepërta të mburrjes, lavdërimet duke u veshur me rroba firmato dhe shtirjet duke bërë shpenzime kolosale. Këto janë veprime që e kalojnë cakun...

Në të kaluarën nuk ka qenë kështu. Atëherë ka pasur rregulla të mrekullueshme. Për shembull: Nëse një njeri do të merrte disa kilogram mish, ato nuk i merrte prej kasapit kur aty gjendeshin edhe njerëz të tjerë, por priste derisa të largoheshin ata. Nëse blinte fruta, perime e gjëra të tjera të ngjashme me to, i fuste në shportë duke i mbuluar me ndonjë copë, në mënyrë që të mos i shikonin të tjerët. Këtë e bënte që të tjerëve të mos u ngelnin sytë te ato që kishte blerë. Kur njerëzit gatuanin në shtëpitë e tyre, nuk bënin gjellë që përhapnin aromë të këndshme. Ata bënin kujdes në këtë çështje, në mënyrë që të mos i shkonte mendja edhe fqinjit. Por edhe nëse gatuanin ushqime që përhapnin aromë të këndshme, patjetër u çonin edhe fqinjëve.

Tani le të tregojmë dy histori të përjetuara/të vërteta në lidhje me ato që mund t'i ndodhin njeriut nëse shfaqet më i madh seç është. Këto dy histori le të gdhenden mirë në mendjet tona:

Hani Shire në Gaziantep, kishte qenë në burg para viteve 80-90. Pas luftës së çlirimit, në një fshat ishte vrarë një person. Për këtë vrasje kishin kapur një burrë që s'kishte lidhje me të dhe e dënuan me burg duke i thënë: "Ti e ke vrarë atë." Edhe pse burri u kishte thënë: "Unë nuk e kam vrarë." – gjykata e kishte dhënë verdiktin e saj dhe faji i kishte ngelur atij. Pasi kishte vuajtur për vite me radhë në atë burg, ngjarja ishte zbardhur dhe ishte gjetur vrasësi i vërtetë. E nxorën nga burgu burrin që kishte me vite aty brenda. Të turpëruar e kishin pyetur:

"Ti ke qëndruar në burg për kaq shumë vite ndërkohë që ke qenë i pafajshëm. Por asnjëherë nuk të

kemi dëgjuar të bërtasësh me të madhe. Asnjëherë nuk the duke bërtitur: Unë jam i pafajshëm. Përse po më fusni në burg?" Burri e kishte ulur kokën dhe ishte përgjigjur: "Unë jam fajtor." Ata e pyetën: "Si qenke fajtor? Fajtori i vërtetë doli në pah." Burri u tha: "Unë nuk jam fajtor për ngjarjen e asaj vrasje, por jam fajtor për një vrasje tjetër!.." "Ashtu?!" – i thanë ata. Burri kishte filluar të tregonte historinë e tij të zezë:

"Kur u lirova nga ushtria dhe po kthehesha në shtëpi, në rrugë u takova me një ushtar tjetër. Edhe ai ishte liruar nga ushtria dhe po kthehej në vendlindjen e tij. Të dy bashkë morëm rrugën për një kohë të gjatë. Përgjatë gjithë rrugës më thoshte: "Atje ku shkova fitova dhe mblodha kaq para. Kur të kthehem në vendlindje, do të marr këtë e atë." Duke ecur, arritëm te një pus. Morëm ujë nga pusi, pimë, lamë duart e fytyrën dhe morëm abdest. Për shkak të atyre që më tregoi, shejtani më hyri në zemër dhe ma tërboi nefsin. Me vete thashë: "Ky duhet të ketë shumë para!" Prandaj vendosa ta vrisja dhe t'i merrja paratë.

Filluam të falnim namazin. Atë e nxora imam. Kur ra në sexhde, ia ngula thikën në kurriz. Shejtani mi pati marrë mendtë. Ai vdiq. Menjëherë i kontrollova të gjithë xhepat dhe trupin, por nuk kishte asgjë! Ai nuk kishte as para dhe as florinj! Madje, nuk kishte asnjë qindarkë. Për fat të keq, ai më ishte mburrur përgjatë gjithë rrugës. Ai ia përgatiti fundin vetes me gjuhën e tij. Unë pastaj u pendova shumë, sepse u bëra vrasës për asgjë. Atë e varrosa dhe askujt nuk i thashë gjë për të. Arrita në fshat. Askush nuk më kërkoi dhe nuk më pyeti për atë vrasje, sepse askush nuk e dinte se unë isha takuar me atë. As të afërmit e tij nuk më njihnin mua, as unë nuk i njihja të afërmit e tij. Çështja do të mbyllej dhe do të harrohej, por pa kaluar shumë kohë, në fshat u vra një burrë. Për vrasjen më akuzuan mua. Unë nuk kundërshtova ngaqë e mbaja mend krimin që kisha bërë më parë. Për këtë arsye, iu nënshtrova fatit. Unë e meritoja këtë ndëshkim."

Mesazhi që mund të nxjerrim nga historia: "Drejtësia e gjen vendin e saj!"

Pasuria, paratë... Njeriu asnjëherë nuk duhet të lavdërohet me këto. Veçanërisht duhet të dijë t'i fshehë sekretet tregtare dhe financiare. Tamahu ndaj parasë dhe pasurisë është një katastrofë në të cilën mund të bjerë njeriu. Për këtë arsye, nuk duhet të shfaqim tamah ndaj askujt. Përveç të tjerash, duhet të ruhemi nga syri i keq, smira dhe nijeti i keq...

Historia tjetër:

Dy burra endacakë po ecnin bashkë. Gjatë rrugës panë një burrë tjetër që ishte shtrirë duke fjetur nën hijen e një peme. Njëri prej këtyre endacakëve e kishte nxitur atë tjetrin duke i thënë: "Shiko, ky i paska këpucët e reja. A t'ia vjedh këpucët?" Endacaku tjetër e kishte pyetur: "Si mund t'ia marrësh? Ai i paska vënë ato nën kokë..." Ai ia ktheu: "Shiko se si do t'ia vjedh! Eja me mua!.."

Ata të dy kaluan në anën tjetër të pemës. Morën diçka në dorë dhe filluan të gërmonin dheun. Burri që po flinte u zgjua kur i dëgjoi zërat. Ai u zgjua, por ngaqë nuk i njihte se kush ishin ata dy endacakët, vazhdoi të bënte sikur po flinte. Të dy shokët endacakë hapën një gropë dhe pastaj e mbyllën. Gjithashtu bënë edhe një bisedë ndërmjet tyre si kurth për burrin që po flinte. Pastaj filluan të flisnin me zë të ulët gjoja sikur tani e panë atë që po flinte:

-Ore, ne paratë i groposëm këtu, por ky njeri qenka shtrirë e po fle pikërisht këtu. Po nëse ky njeri na ka parë apo na ka dëgjuar? Po nëse ngrihet dhe i merr paratë pasi të ikim ne?

-Jo, jo, a nuk e shikon? Ai është zhytur në një gjumë të thellë.

-Nuk i dihet. Le ta provojmë një herë dhe të shohim nëse po fle apo jo...

-Si do ta provojmë?

-Le t'ia tërheqim dalë nga dalë këpucët që i ka te koka. Nëse lëviz, do të thotë se ka qenë zgjuar. Nëse ka qenë zgjuar, duhet t'i marrim paratë. Nëse nuk bën zë, atëherë do të thotë se është në gjumë të thellë. Nëse është në gjumë, nuk ka ndonjë problem."

Burri që po bënte sikur po flinte, u mashtrua nga ky kurth. Endacakët shkuan dhe ia tërhoqën këpucët që kishte nën kokë. Burri vazhdonte të bënte sikur po flinte, sepse pandehte se do të merrte paratë që kishin groposur ata. Ai mendoi: "Çfarë problemi ka nëse ikin këpucët? Sidoqoftë do të marr gjithë ato para."

Të dy hajdutët ia morën këpucët dhe u larguan. Kur burri që po flinte u sigurua se ata u larguan, menjëherë u ngrit dhe e hapi gropën që e kishin mbuluar ata. Por sado që gërmoi, nuk gjeti asnjë gjë.

Në këtë mënyrë, të dy endacakët ia morën këpucët burrit që po flinte para syve të tij. Si arritën t'ia merrnin? Me karrem... Gjuetia në shumicën e rasteve bëhet me karrem. Në majën e grepit gjithmonë vendoset një karrem. Po të mos vendosej karremi cili peshk do të shkonte dhe ta kapte grepin me gojë? Pra, karremi është kamuflazhi i kurthit.

Edhe disa prej mashtruesve janë të tillë. Ata hedhin një karrem që njeriu mund ta lakmojë shumë. Në këtë mënyrë, ndërkohë që njeriu mendon se do të vendos një dhe do të fitojë tre, humbet edhe atë që ka.

A të gjithë njerëzit janë të këqij? Le të mos biem në pesimizëm, por asnjëherë të mos e harrojmë edhe ekzistencën e të keqes dhe të keqit. Sugjerimi



ynë nuk është që të fshihemi apo ngujohemi, por të mos mburremi dhe të mos lavdërohemi, sepse shfaqjet e tilla tërheqin vëmendjen e njerëzve.

Njerëzit në përgjithësi përpiqen të matin fuqinë e njëri-tjetrit, sepse, është e lehtë që t'ia marrësh më lirë mallin dikujt që ka rënë në gjendje të vështirë. Për këtë arsye, njeriu nuk duhet ta shfaqë vështirësinë ekonomike nëse ka rënë në një gjendje të tillë. Edhe kjo histori është një shembull domethënës për këtë:

Një gjykatësi i kishin sjellë një çështje gjyqësore. Një djalë i ri kishte marrë vajzën e një burri pa dëshirën e këtij të fundit. Më së fundi e kishin kapur të riun dhe e kishin sjellë. Babai i vajzës ishte i nxehur dhe thoshte: "E akuzoj atë për grabitjen e vajzës sime. E akuzoj."

Gjykatësi ishte kthyer nga djali i ri dhe e kishte pyetur: "Përse e more vajzën ti?" I riu ia ktheu: "Ia kërkova dorën e vajzës, por ai nuk ma dha. Unë e desha atë vajzë, prandaj edhe e mora." Pastaj gjykatësi ishte kthyer nga babai i vajzës dhe i kishte thënë: "Mirë, po ti përse nuk e dhe vajzën?" Babai i vajzës ishte përgjigjur: "Pa shikoje një herë gjendjen e tij! Për çfarë t'ia jap vajzën atij? Ai nuk ka as rroba për të veshur. Nuk ka as shpi e as katandi. Ai nuk mund të ngopë me bukë as veten. Atëherë si mund të përkujdeset për bashkëshorten?"

Gjykatësi në ato momente kishte bërë një manovër. Ishte kthyer nga djali, kishte bërë sikur i ishte nxehur dhe i kishte thënë: "Bir, përse nuk i ke thënë babait të vajzës se ti ke njëqind dele dhe dy lopë ndërmjet kafshëve tona?.." Babait të vajzës i ishin hapur sytë dhe kishte pyetur: "Me të vërtetë ky djalë i ri ka njëqind dele dhe dy lopë?" Gjykatësi i ishte përgjigjur: "Po, i ka..." Në ato momente, babai i zemëruar ishte shndërruar në një engjëll dhe ishte shprehur: "Përse nuk më ke thënë more bir? Meqë qenka kështu..." Gjykatësi menjëherë kishte thënë:

"Atëherë nuk ngeli më gjë për t'u sqaruar. Puthe bir dorën e babait!.." Gjykatësi e kishte rregulluar këtë çështje duke dhënë pak prej pasurisë së tij. Pasuria i pajton njerëzit. Edhe neve na ka ndodhur që të bëjmë pajtime të tilla:

Kemi pasur një të afërmin tonë. Kjo ka ndodhur para shumë vitesh. Një ditë shkova për ta vizituar. Kur e pyeta për gjendjen, ma ktheu: "Po vdesim dhe po ngjallemi përsëri." Unë e pyeta: "Çfarë do të thotë kjo?" Ai mu përgjigj: "Bijtë e mi patën punuar si dy vëllezër ortakë. Pastaj u ndanë. Kur u ndanë, lindën kontradikta ndërmjet tyre. Njëri thotë: 'Unë kam tetë milion për të marrë prej teje.' Tjetri i thotë: 'Nuk ke asgjë për të marrë prej meje!' Vëllai i vogël i thotë se ka një dokument që e vërteton se ka për të marrë tetë milion nga vëllai më i madh. Ai tjetri i thotë se nuk ka asgjë për të marrë prej tij.

Ndërkohë që grindeshin për çështjen e parave, arritën deri në atë gjendje saqë djali i madh në praninë tonë mori hanxharin në dorë dhe deshi ta vriste vëllain e vogël. E ndoqi nga pas duke i rënë katër herë rreth e rrotull oborrit. Po ta kishte zënë, do ta kishte vrarë. Ata nuk dëgjojnë as fjalën e këshillën e nënës së tyre, as timen. Njëri prej tyre iku dhe u largua. Ata do ta gjejnë përsëri njëri-tjetrin dhe do të zihen. Nëse do të zihen përsëri, do ta vrasin njëri-tjetrin. Si mund ta durojë prindi këtë situatë! Nuk dimë çfarë të bëjmë. Bir, të lutem na ndihmo! Gjeji ata dhe këshilloji! Bëj ndonjë gjë dhe gjeje një rrugëzgjidhje!"

Pa mendoni: Edhe ai që ikte, edhe ai që e ndiqte me hanxhar ishin bijtë e tij! Pa mendoni për vuajtjen dhe dëshpërimin e atij. Njeriu tmerrohet nga kjo gjendje.

Njërin prej vëllezërve e gjeta dhe i thashë: “A nuk ju erdhi turp të ziheni para prindërve tuaj për para? A nuk e keni frikë Allahun?” Ai mu përgjigj: “Unë nuk jam zënë. Unë thjeshtë kam kërkuar të drejtën time. I thashë që kam edhe dokument që e vërteton të drejtën time. Prandaj do t’i marr ato para. Përse të mos i marr në fund të fundit? Edhe më nxjerrin jashtë, edhe nuk ma japin hakun tim.” Pasi u shpreh me këto fjalë, unë i thashë:

“Lëreni zënkën! Hiq dorë nga ato para! Të paktën hiq dorë nga gjysma e tyre! Gjeni një pikë të mesme dhe pajtohuni!” Ai ma ktheu: “Nuk bën aspak! Unë do t’i marr paratë e mia.” Pastaj shkova te vëlla i më i madh dhe i thashë: “Ju qenkeni zënë në prani të prindërve tuaj. A aspak nuk keni frikë nga Allahu? Përse i mërzisni ata? Le të gjejmë një pikë të mesme! T’i jepi gjysmat e parave, pastaj ai të heqë dorë nga gjysma tjetër e tyre! Në këtë mënyrë le të marrë fund kjo çështje. Si thua?” Ai mu përgjigj:

“Unë kam të drejtë. Madje jam viktimë e kësaj çështjeje. Edhe nëse vdes, nuk i jap gjysmat e atyre parave. Madje, as pesë qindarka nuk i jap. Ai po më bën padrejtësi. Ndërsa ju e mbroni atë!”

Pra, njëri thoshte se kishte dokument që mund t’ia jepte gjykatës dhe ta merrte hakun e tij, ndërsa tjetri thoshte se nuk jap as pesë qindarka edhe nëse vdes. Që të dy ishin të vendosur në këmbënguljen dhe lla nuk u inatin e tyre. Këshibënte dobi asnjërit prej të dy vëllezërve. Shkaku i kësaj ishte edhe varfëria… Të urtët kanë thënë: “Pasuria të pajton, varfëria të fut në grindje, ndërsa sakrifica të qetëson.”



Ata kishin edhe një vëlla tjetër në Stamboll. Ai nuk e kishte gjendjen e keqe. Vëllezërve të zemëruar u thashë: “Me sa duket ju nuk do të hiqni dorë nga inati juaj. Prandaj këto para do t’i marr nga vëllai juaj në Stamboll. Ato para do t’ia jap atij që i kërkon. Ndërsa ai që nuk i jep, nuk do të paguajë gjë prej xhepit të tij. Të paktën këtë mos e kundërshtoni, në mënyrë që të marrë fund kjo zënkë.”

Pastaj veprova ashtu siç u thashë vëllezërve të zemëruar. Shkova te vëllai i tyre në Stamboll dhe bisedova me të. Atij i thashë: “Gjendja është kështu e kështu… Që të dy i ke vëllezër. Ata i kanë hipur kalit të shejtanit. Nëse ti i jep paratë për zgjidhjen e kësaj çështjeje, ai që i kërkon do t’i marrë paratë e tij dhe ai që nuk pranon, nuk do të paguajë gjë nga xhepi i vet. Në këtë mënyrë, do të zgjidhet çështja dhe do të marrin fund vuajtjet e prindërve tuaj.”

Ai ma ktheu: “A për ata i kam fituar paratë unë!.. Le të bëjnë çfarë të duan!..” Me sa kuptova, kjo çështje nuk do të zgjidhej. Për këtë arsye, i thashë: “Nëse ti e pranon këtë propozim, gjysmën e parave do ta jap unë. Atyre nuk do t’u tregoj se e kam dhënë unë gjysmën e parave. Nëse u tregoj, nuk do të pranojnë. Ndërsa ti je vëllai i tyre. Nëse i jep ti, ata do të pranojnë. Prandaj, paratë do t’ua japësh ti atyre. Ndërsa për mua nuk do të dinë asgjë.” Vëllai i tyre u mendua dhe mu përgjigj: “Në rregull atëherë!” Ne vepruam siç vendosëm dhe çështja u mbyll. Paraja nuk njeh as vëlla, as të afërm. Paraja është edhe mik, edhe armik.

Siç shohim dhe zemëndërra çdo ditë, ka zënka rime të panumërta mjet vëllezërve e motve, ortakëve, të afërmve, fqinjëve dhe së fundi ndërmjet besimtarëve… Një pjesë e tyre buron nga trashëgimia, një pjesë nga inati dhe një pjesë nga përçarja. Ndërkohë që themi: “Unë e di! Unë kam të drejtë!”, na nxisin edhe nefsi e shejtani dhe dalin në pah këto grindje e zënka të padëshiruara. Të gjithë do të shpërngulemi nga kjo botë e përkohshme. Prandaj, a ia vlejnë këto grindje? Po të sakrifikojmë pak, çdo gjë rregullohet. Së fundi, gjithmonë fiton ai që sakrifikon.

Sido që ta quajmë pasurinë, para, pronë, mall apo diçka tjetër, ajo është një sprovë e madhe. Nëse atë nuk e mbajmë si mjet, menjëherë fillon dhe na fut në përçarje. Si rezultat dalin zënkat “unë kam të drejtë, ti ke të drejtë”. Në këtë mënyrë, nuk na ngelet as ëmbëlsi në gojë dhe as prehje në shpirt.

Ata që e dinë se pasuria është mjet i përkohshëm për sprovën në këtë botë dhe që pranojnë të heqin dorë prej saj apo ta sakrifikojnë, do të gjejnë prehje në të dy botët. Allahu i Lartësuar na ruajt nga e keqja e shejtanit, nga e keqja e nefsit, nga e keqja e përçarjes së hipokritit, nga e keqja e armikut, nga e keqja e pasurisë dhe varfërisë dhe nga e keqja e epshit!

Amin!..

TË RINGJALLEMI *me Islamin*

Ali Riza Temel

Besimi është jetë. Islami është një thirrje për ringjallërim, së cilës Allahu i Lartësuar urdhëron që t'i përgjigjemi: ***"O ju që keni besuar! Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit kur ju thërret drejt asaj që ju jep jetë!.."*** (Enfal, 24)

Ne jetojmë me frymën e Islamit. Të mos marrësh frymë, do të thotë të vdesësh. Shpallja hyjnore është frymë dhe jetë. Kjo frymë, që është fryrë nëpërmjet të Dërguarit të Allahut, (a.s.), i dha jetë të gjithë botës dhe mundësoi lindjen e një civilizimi të mbështetur tek mirësitë dhe vlerat e vërteta humane.

Termi "jetë", që cilësohet në ajetin fisnik të mësipërm, nënkupton një stil jetese që e kthen qenien njerëzore në njeri, që e lartëson atë në gradën e mëkëmbesit të Allahut (xh.xh.), dhe që e bën krijesën më sublime. Pra, në këtë ajet nuk flitet për jetën biologjike, e cila është gjendja fiziologjike e të gjitha gjallesave. Gjithsesi nuk duhet anashkaluar fakti se të jetuarit në përputhje me thirrjen hyjnore është e dobishme dhe e nevojshme edhe nga aspekti biologjik, sepse largimi nga gjërat që Islami ka ndaluar, është domosdoshmëri për shëndetin e mendjes, shpirtit dhe trupit.

Zbatimi i Islamit është pranverë, ndërsa refuzimi është dimër. Bahçja islame në pranverë i mundëson të gjithë njerëzimit lule të shumëllojshme, ngjyra marramendëse, erëra magjepsëse dhe tablo të pashoqe e të mrekullueshme. Por kur rojet e kësaj bahçeje zhyten në gjumë, ajo sulmohet dhe plaçkitet nga kopetë e derrave, ujqërve, hienave, dhelprave, çakejve dhe sorrave. Pavarësisht shkatërrimit dhe plaçkitjes, toka e kësaj bahçeje ka aftësinë për të çelur lule dhe për të dhënë fruta, përsëri. Kjo bahçe e shndërruar në shkretëtirë prej erërave helmuese që fryjnë nga perëndimi, mund të shpërthejë përsëri dhe të arrijë madhështinë që ka pasur në të kaluarën, me diellin e qiellit dhe shirat e reve të saj.

Kjo bahçe që gjallërohet me shirat e Shpalljes Hyjnore dhe diellin e besimit, edhe më parë ka qenë e shkretë dhe jopjellore. Ky fllad i këndshëm që fryu mbi rërat përvëluese të gadishullit Arabik dhe shkretëtirat në të cilat nuk mbinte as bari, i shndërroi ato në kopshte të pashoqe. Kjo frymë që iu dha beduinëve dhe skllevërve agresorë që jetonin në këto shkretëtira, përgjatë një kohe dhjetë- vjeçare, i bëri njerëz shembullorë dhe personalitete model në këtë botë. Kjo frymë mundësoi që disa fise të dobëta e të varfra, të mposhtnin dy perandoritë më të mëdha të asaj periudhe, që ishin perandoria Bizantine dhe perandorie Perse. Kjo frymë bëri që këto fise t'i shpëtonin masat e gjera të popujve në lindje dhe perëndim, nga padrejtësia e perandorëve, mbretërve, klerikëve zoroastrianë, priftërinjve, feudalëve dhe agallarëve.

Kjo reformë, që u realizua nëpërmjet të Dërguarit të Allahut, alejhi's-selam, është reforma më madhështore e historisë. Muhamedi (a.s.), i cili ishte predikuesi dhe zbatuesi i Shpalljes Hyjnore, edukoi burra shumë të mëdhenj. Po të vinin një mijë filozofë në shkretëtirën e Arabisë, nuk do ta edukonin dot një burrë si Omeri (r.a.), sepse është e pamundur të arrihet jeta dhe iluminimi i vërtetë, pa frymën gjallëruese dhe dritën e shpalljes hyjnore që ndriçon zemrat. Burimi i vetëm, që i jep kuptim dhe i vendos synim jetës dhe kësaj bote, është Shpallja Hyjnore, pra, Islami i vërtetë dhe gjithëpërfshirës.

Islami është fe e natyrshmërisë. Ajo që është e përshtatshme me Islamin është një jetë normale dhe e natyrshme. Të jetuarit larg Islamit është shmangie nga rregulli dhe natyrshmëria. Allahu (xh.xh.), thotë në Kuranit Fisnik:

"Drejtohu me përkushtim në fenë e pastër monoteiste, natyrën fillestare, në të cilën Allahu i ka krijuar njerëzit. S'ka ndryshim të krijimit të Allahut. Kjo është feja e drejtë, por shumica e njerëzve nuk e dinë." (Rum, 30)

Jeta që bëhet në përputhje me natyrshmërinë, është jetë organike; ndërsa ajo që bëhet në kundërshtim me natyrshmërinë është një jetë artificiale. Ajo që është hyjnore, është e natyrshme. Pikërisht natyrshmëria është ajo që kërkohet dhe për të cilën kemi nevojë.

Të bëhesh mysliman do të thotë të integrohesh

në hierarkinë e gjithësisë dhe t'i dorëzohesh vullnetit hyjnor, sepse përveç njeriut, çdo gjë tjetër vepron në përputhje me sistemin hyjnor me një nënshtrim të plotë. Harmonia dhe sistemi në gjithësi, janë shprehitë më të qenësishme të këtij nënshtrimi. Kusht themelor i ekzistencës është pikërisht ky nënshtrim. Allahu Teala shprehet në ajetin fisnik:

"A mos kërkojnë ata diçka tjetër përveç fesë së Allahut, ndërkohë që Atij i përulen të gjithë ata që gjenden në qiej dhe në Tokë, me hir a me pahir dhe tek Ai do të kthehen të gjithë?!" (Al 'Imran, 83.)

Njeriut i është mundësuar vullneti, ngaqë është në sprovë. Ai është lënë i lirë për sa i përket çështjes së besimit dhe nënshtrimit ndaj Zotit (xh.xh.). Ndjekja e sistemit hyjnor dhe nënshtrimi ndaj Krijuesit, siç veprojnë edhe krijesat e tjera, mundëson përfshirjen në sistem; ndërsa largimi çon në ngeljen jashtë tij. Ky është terrori më i madh që mund të ekzistojë.

Të gjithë të dërguarit e Zotit (xh.xh.), i kanë thirrur dhe ftuar njerëzit te Allahu dhe te rruga e Tij. Edhe thirrja e fundit është e njëjtë: ***"Thuaj*** (o Muhamed)***: "Ne besojmë Allahun, atë që na është shpallur neve, atë që i është shpallur Ibrahimit, Ismailit, Is'hakut, Jakubit, Esbatëve*** (12 bijve të tij) ***dhe në atë që i është dhënë Musait, Isait dhe profetëve nga Zoti i tyre. Ne nuk bëjmë asnjë dallim midis tyre dhe Ne vetëm Atij*** (Allahut) ***i përulemi."*** (Al 'Imran, 84.)

Këtë thirrje për ringjallje, pas pejgamberëve e kanë vazhduar ata që kanë ndjekur rrugën e profetëve dhe dijetarët e prijësit që kanë marrë prej moralit të të dërguarve. Thirrja e tyre ngjan me Surin e Israfilit (briri që do t'i fryjë ky engjëll). Këto thirrje duhet të vazhdojnë pareshtur, në mënyrë që gjithmonë të jemi vigjilentë. Thirrësit për tek rruga e Allahut janë udhërrëfyesit dhe dritat e kësaj rruge, ndërsa ata që ftojnë në rrugë të devijuara janë përfaqësuesit e shejtanëve. Rruga e parë të shpie në Xhenet, ndërsa e dyta të shpie në Xhehenem.

Përgjatë gjithë historisë, kanë dalë thirrës dhe heronj që i kanë ftuar njerëzit për rigjallërim. Thirrja e tyre ka vijuar përgjatë gjithë shekujve. Zëri i burrave të mëdhenj si Gazaliu, Mevlana dhe Junusi, jehon nëpër zemra dhe qiej. Edhe në historinë tonë të afërt kanë dalë shumë trima dhe heronj, që kanë flijuar çdo gjë të tyre dhe kanë bërtitur me të gjithë fuqinë që kishin, me qëllim që t'i zgjonin myslimanët që flinin prej narkozës së kolonialistëve. Pra, dolën burra të mëdhenj si Muhamed Ikbali, Mehmet Akif Ersoji dhe Bediuzzamani, Nexhip Fazëlli dhe shumë burra të mëdhenj si ai, kanë shprehur hallet e umetit, dhe në një lloj mënyre, kanë kryer detyrën e Surit të Israfilit për t'i paralajmëruar dhe zgjuar të tjerët. Në të vërtetë, detyra e paralajmërimit dhe thirrjes është detyrë e çdo myslimani, veçanërisht e çdo intelektuali. Kjo është një përgjegjësi e pashmangshme.

Të jetuarit në një gjendje pasive, duke qëndruar i tërhequr në një qoshe dhe duke mos u interesuar për hallet e njerëzve, të largon nga shoqëria. Ky largim është mëkat. Intelektual është ai njeri që e flijon jetën e tij private për individin, shoqërinë dhe për përpjekjen/luftën mentale.

Thirrja për ringjallje është thirrja për t'i vënë në funksion të gjitha zemrat, ndërgjegjet, mendjet dhe burimet materiale e shpirtërore. Islami është dinamikë. Shehadeti, siç ka thënë edhe Muhamed Ikbali[1], më shumë se një fjalë, është një reformë dhe një pikë fillimi apo nisjeje për ristrukturim. Kurani Fisnik nuk është vëllim, letër, bojë dhe emër. Kurani Famëlartë është jetë, hakikat, mendim, vepër, përgjegjësi dhe xhihad. Puthja e Kuranit Fisnik, mbajtja e Mus'hafit në një vend të lartë, bërja e letrës së tij me shkëlqim, organizimi i garave për leximin e bukur të Kuranit dhe gjëra të tjera të ngjashme me këto, nuk shprehin respektin e vërtetë ndaj Librit të Zotit (xh.xh.). Respekti dhe besnikëria e vërtetë ndaj Kuranit Fisnik, është përsosja e moralit me moralin e tij dhe zbatimi i rregullave të tij që janë burimi i jetës. Ajeti që e kemi përmendur në fillim, shpreh plotësisht këtë që sapo thamë.

Myslimanët, që në ditët e sotme e kanë humbur identitetin dhe personalitetin, duhet t'i përgjigjen Kuranit Fisnik, i cili i fton për ringjallje, dhe duhet t'ia vënë veshin të dashuruarit pas Kuranit.

Ikbali në lidhje me këtë thotë: "Fisnikëria e lindjes dhe perëndimit është në dorën tënde. Merre parasysh shekullin në të cilin jeton, ringjalle shpirtin e Omerit, kaloje shkretëtirën, qytetin e malin, dhe ngrije çadrën në ekzistencën/veten tënde. Mprehe veten si shpatë, pastaj vërja veshin kaderit, madje nënshtrohu ndaj kaderit, sepse xhevahiri yt nuk është i keq. Ky i varfër që e ka sfiduar shoqërinë, nuk ka pasur asgjë përveç këtyre dy fjalëve: "La ilahe il-lall-llah, Muhammedun Resulull-llah."

1. Ikbali ishte burrë i fesë dhe i kësaj bote, i besimit dhe shkencës, i mendjes dhe i ndjenjës, i filozofisë dhe letërsisë, i urtësisë dhe politikës, i Allahut dhe i popullit, i ibadetit dhe xhihadit, i besimit dhe kulturës... Ai ishte burri i të kaluarës dhe të së ardhmes. Ai ishte sulltani i natës dhe luani i ditës.



KUR HUMBËSIT KTHEHEN FITIMTARË

Nuredin Nazarko

I humbur! I fituar! Shpesh e më shpesh vërtiten diskutimet mbi këto dy gjendje. Njeriu e ka të vështirë të pranojë humbjen. Në çdo situatë kujton se ka fituar. Është një ecejake mes të qënit i humbur dhe i fituar.

I humbur! I fituar! Po çfarë na thonë njerëzit për atë që është i humbur apo i fituar? Nuk është e thënë që të ketë unanimitet. Do t'i referohemi ashtu siç e shpreh një pjesë e mirë e njerëzve perceptimin mbi të qënit i humbur apo i fituar. Çdo mosarritje është një humbje.

Mospasurimi. Nuk ke arritur të kesh një shtëpi të bollshme, moderne, të arreduar sipas shijeve më të fundit.

Je rrëzuar në provime.

Nuk i ke nxjerrë të gjitha notat dhjeta.

Nuk ia ke dalë të fitosh intervistë pune.

Nuk je renditur i pari në konkurs apo në garë.

Nuk ke dalë i pari klasës, shkollës.

Nëse ke patur pozicion të mirë pune dhe nuk ke ngjyer duart, je humbameno që nuk bën dot prokopi.

Nuk ia ke hedhur klientëve në peshë dhe në masë, nëse je tregëtar.

Të gjithë zunë nga një qoshe dhe u sistemuan, ti ende vërtitesh pa gjë nëpër duar.

Sa mirë janë rregulluar ata që ikën jashtë vendit. Po bëjnë prokopi. Para. Punë. Shtëpi. Jetojnë si mos më mirë. Janë shumë mirë atje ku janë. Ju mbetët këtu. Vuani tani se nuk patët kokë.

Po nuk ndryshuat e të veproni si të gjithë nuk kini të ardhme.

Këta dhe plot përcaktime të tjera janë tregues i perceptimit të shumë syresh mbi: I humbur! I fituar! Për njerëzit thelbi që ndan këto dy gjendje është zotërimi material. Nuk zotëron – je i humbur. Zotëron – je i fituar. Dy përcaktime krejt të ngurta, para të cilave përcaktuesit nuk lëshojnë pe.

Përcaktimi i rezultatit final, i humbur – i fituar, ka detyruar shumë syresh që jetët e tyre t'ia nënshtrojnë pikërisht këtyre përcaktimeve. Kjo ndodh sepse për këtë pjesë opinioni i njerëzve është shumë i rëndësishëm. Ka një varësi të theksuar nga mendimi i të tjerëve. Çfarë do të thonë ata për ne? Si do të na përcaktojnë? Në cilën kategori do të na vendosin?

Shqetësimi i madh se si ne do të përcaktohemi shtrydh energjitë tona në diskutime, debate, të cilat përveç shtrydhjes së energjisë pa bereqet nuk nxjerrin asgjë në dritë. Debate, diskutime të panevojshme për opinionin e shumicës që ndryshon bashkë më shpejtësinë e lëvizjes së ajrit. E nëse

opinioni nuk mbështetet në asnjë parim të mirfillltë moral, a ka ende vend që ne të lëshohemi në shtrydhje energjie?

Ndërkohë që tendenca në rritje e mënyrës së të jetuarit nën diktatin e zotërimit material po arrin nivele shqetësuese në dëm të mënyrës së të jetuarit nën hijen e parimeve dhe shkakësive parake, shumica vazhdon të ngrejë në nivele të reja trysninë ndaj të jetuarit ndryshe. Pakica që ka si qëllim një jetë ndryshe, shndërrohet në tabelë qitje. Kur themi jetë ndryshe nuk lidhet aspak me detajet e parëndësishme të një mënyre jetese. Të jetuarit ndryshe nuk lidhet as me grupe shoqërore minorancash. Nuk lidhet as me ndryshime të elementëve sipërfaqësorë të të jetuarit. Veprimet jetësore janë të njëjta. Punë. Lodhje. Të ardhura. Shpenzime. Mbijetesë. Po çfarë e bën të ndryshme jetesën e pakicës?

Ata që jetojnë ndryshe, janë ata që frymojnë ndryshe. Nëse punojnë, përpiqen të jenë të përgjegjshëm dhe profesionistë.

Në çdo lloj profesioni që ushtrojnë përpiqen të jenë korrektë, të drejtë, dhe afër shqetësimeve njerëzore, duke i udhëzuar ata që janë nën pergjegjësinë e tyre udhës që duhet të shkojnë, për jetë të virtytshme.

Janë ata që më shembullin personal, edhe pse në periudhë të vështirë, na tregojnë se të jetosh virtytshëm, nuk është e pamundur.

Janë ata që më sakrificën e tyre i thonë të kundërtën atyre që e konsiderojnë humbje jetesën e drejtë, të ndershme dhe pa përdredhje gjarpërore.

Janë ata që edhe pse të varfër nuk e shtrijnë dorën e lypjes dhe as nuk merren me tregëti trupash për pesë aspra.

Janë ata që edhe pse me kufizime të caktuara nuk reshtin së përpjekuri për të qenë të virtytshëm në sigurimin e jetesës, pa iu bërë kujt barrë në emër të kufizimit që kanë.

Janë ata që edhe kur janë në pozita të vështira gjejnë kurajo të përçojnë besim dhe shpresë për kalimin e vështirësive.

Janë ata që edhe kur retë ngjishen në grinë e tyre të errët dijnë të gjejnë rrugën për tek dielli.

Janë pikërisht këta që vendosen në kategorinë i humbur, nga shumica që e vendos veten në kategorinë, i fituar. Pse kjo? Sepse i fituari nuk mund të besojë që i humburi ka fituar në një tjetër dimension. Nuk e njeh këtë dimension. Njeh vetëm dimensionin e zotërimit material. Për shumicën, nëse nuk je rritur në nivelet e zotërimit je i humbur. Nëse je i humbur, je i shpërfillur. I parëndësishëm. I vakët. Njeri për të ardhur gjynah. Pa prestigj. I rëndomtë. I pamësuar me lajelujet e sërës që i shkëlqen gëzofi apo peliçja dhe që nuk harron të grijë ndonjëherë thonjtë me dhëmbë. As gëzofi e as peliçja nuk mundën t'ia shqitnin këtë zakon njerëzish të rëndomtë. Të rëndomtë sipas tarafit të sërës së ngritur mbi pirgjet e zotërimit material. Këta janë "fisnikët" që përçmojnë njerëzoren, vetëm sepse nuk i përshtatet shijeve të tyre.

ATËHERË ME SIGURI DO TË DËGJOJMË FITUESIT TË THONË: - A KËTA ISHIN ATA ME TË CILËT TALLESHIM E I VINIM NË LOJË? ÇFARË KA NDODHUR QË SOT QËNDROJNË NË PIEDESTAL NDËRSA NE ME KOKË PËRMBYS DHE ZEMRA TË NGUSHTA SIKUR TË NGJITESHIM NË QIELL?

Nëse jeta e virtytshme konsiderohet humbje nga shumica, mos vallë do të thotë që sasia numerike është kriter i së vërtetës? Kur është parë dhe dëgjuar që shumica të jetë ndonjëherë në anën e virtyteve? Historia njerëzore gjithmonë i ka patur të pakët të virtytshmit. Tash a do të ketë ndryshim? Nuk kanë rëndësi perceptimet e shumicës. Fjalët e tyre. Sulmet. Shpifjet. Fyerjet. Tek e fundit veprojnë atë që dijnë të kryejnë më mirë. Për ta mjafton të kesh xhepat plot dhe je padroni ndaj të cilit duhet të nënshtrohesh. Por jo me të gjithë ndodh kjo që presin të ndodhë. Ka syresh që edhe pse vendosen në kategorinë, i humbur, nuk demoralizohen. Nuk jepen. Nuk përkulen. Nuk i largohen skrupujve. Nuk merakosen për fshikullimet. Durojnë, sepse jeta e virtytshme nuk mund të jetë e tillë nëse nënshtrohesh ndaj të vetshpallurve fitues.

Koha i jep hakun çdokujt. Rrjedhja e saj është rruga ku ecin, i humburi dhe i fituari. Ndoshta nuk dallojnë shumë, por në çastin e duhur secili do të kuptojë kujt kategorie i përket.

Atëherë me siguri do të dëgjojmë fituesit të thonë: - a këta ishin ata me të cilët talleshim e i vinim në lojë? Çfarë ka ndodhur që sot qëndrojnë në piedestal ndërsa ne me kokë përmbys dhe zemra të ngushta sikur të ngjiteshim në qiell?

Ky është çasti kur humbësit janë kthyer fitues. Paskëndaj nuk ka më zhbërje. Secila palë shijon frytet e fitores.



Të ekzistosh apo të jetosh?

Edison Çeraj

Shumë njerëz e ngatërrojnë të qenurit kontradiktor me hipokrizinë. E para, sipas çdo gjase, është pjesë e natyrës njerëzore (në jetën e kafshëve nuk ka kontradikta, as në atë të alienëve); ndërsa e dyta, jo se nuk është, por nuk duhet të jetë.

Një njeri që nuk ndryshon asnjëherë, që noton gjithnjë në të njëtët ujëra, që bën një jetë të ashquajtur lineare, që është i sigurt dhe i qartë për çdo gjë, që karakerizohet nga një gjendje pothuajse e njëjtë emocionale rezulton të ketë bërë vetëvrasje shpirtërore, pasi në një mënyrë apo në një tjetër ka flijuar botën e tij të brendshme.

Krahasimi i personazheve të Dostojevskit me tipat psikologjikë të Jung-t na tregon shumë në këtë drejtim: të parët janë të veçantë, të papritur, spontanë, dramatikë, me dilema, pasionantë e kështu me radhë; ndërsa të dytët janë të gjithë një prerje, të ftohtë, sikur janë bërë në laborator. Dallimi është themelor, po aq dhe paralajmërues.

Dostojevski na kumton se natyra njerezore është e paparashikueshme, dhe çdo përpjekje apo ambicie për ta parashikuar dhe përkufizuar është hapi i parë drejt dhunimit të lirisë.

Në fakt, te shumë shkrimtarë pas Dostojevskit, si Kafka, Joyce, Beckett-i, Camus, Zamjatin, Huxley, Orwell, Kavabata etj., një vend qendror në veprën e tyre zë pikërisht rrjedhoja e dhunimit të kësaj lirie përmes pushtetit të dijes racionale apo shkencore (në dhjetëra disiplina) për t'i vënë një emër të dytë njeriut, pra, për ta përkufizuar, për t'i treguar rrugën, për t'i dhënë një manual përdorimi të vetes.

Nëse romani i shekullit XIX, ndër të tjera na paralajmëronte se çfarë mund të bëjë një person që është i sigurt në vetvete, që nuk ka asnjë mëdyshje, që ndihet superior ndaj të tjerëve, që beson pa kushte në idhuj abstraktë si progresi[1], romani i shekullit pasardhës, ndër të tjera, u fokusua edhe te pasojat e mosmarrjes parasysh të këtij paralajmërimi.

Kështu, romani na ndihmoi dy herë: njëherë duke na paralajmëruar, herën tjetër duke na treguar se çfarë ndodhi me ne, meqë nuk e morëm seriozisht herën e parë.

Trashëgimia e dishepujve të progresit sot është rënia e vazhdueshme e diversitetit gjithandej dhe një botë gjithnjë e më e zbrazur nga qëllimi, dhe për pasojë gjithnjë e më e përqendruar te funksioni. Natyrisht, njeriut po synohet t'i hiqet qoftë dhe funksioni, pasi në skenë kanë filluar të zënë vend me ngulm robotët e zgjuar, kopjet e menjëhershme të njeriut, që në një fazë më të zhvilluar do të arrijnë të shkruajnë edhe poezi (pa poezi), ashtu siç po bëjnë kafe pa kafeinë.

Kopjet e menjëhershme të njeriut do arrijnë të përmbushin çdo funksion, derisa njeriu ta ketë të gjithë kohën e lume në dispozicion për të bërë asgjënë e përsosur, për t'u çliruar më në fund një herë e mirë nga çdo orvatje për kuptim, pasi kjo asgjë e përsosur do të jetë në gjendje të përpijë çdo kuptim si të ishte një vrimë e zezë.

Një botë që funksionon vetvetiu, pa patur nevojë për një qëllim, pra pa ne.

Në një mbretëri të tillë librat e shenjtë, letërsia dhe arti nuk do të kenë se çfarë të thonë, dhe misioni i tyre do të konsiderohet i mbyllur. Do të jetë si të jetosh pa pasqyrë, domethënë pa ndërgjegje. E mira dhe e keqja do të zënë vend nëpër muzetë e së ardhmes, si në librat distopikë, dhe ndër të tjera do të jenë stimuj me orar për të qeshurën, natyrisht nëse do të ekzistojë e qeshura.[2]

Duke perifrazuar Wilde-n, njerëzit nuk do të jenë në gjendje të jetojnë (personazhet e Dostojevskit), por vetëm të ekzistojnë (tipat psikologjikë të Jung-ut). Ajo që shumë vetëm e etiketojnë sot si "mirëqenie"[3], nuk është gjë tjetër vetëm se një *work in progress* që po na imponohet (ngaqë vetë po e kërkojmë) për të kapur stadin e atyre që ekzistojnë, pa qenë në gjendje të jetojnë.

Ata që vetëm ekzistojnë nuk i durojnë dot ata që jetojnë.

1. Mjafton të kujtojmë romane si *Të mjerët*, *Perënditë kanë etje*, *Vëllezërit Karamazov*, *Djajtë*, *Karriera e Rugonëve* etj..

2. Nuk është fjala për rastin kur nxirret një zë i ndërprerë, duke e lëshuar pjesë-pjesë ajrin nga gryka dhe duke lëvizur gojën e muskujt e fytyrës, siç e shpjegon fjalori.

3. Paradhoma e lumturisë, sipas tyre.

Ahmet Tashgetiren

Perceptimi i mirësisë hyjnore


Ai që e ka zgjedhur si të "Dërguar" birin e Abdullahut, Muhamedin (a.s.), dhe që ia ka dërguar njerëzimit, është Krijuesi i botëve, Allahu (xh.xh.). Një mysliman, para së gjithash duhet ta vërejë këtë fakt, dhe pastaj ta fusë brenda "Amentusë" së tij. Faza e dytë është që myslimani ta dijë që Krijuesi i Madhëruar ka dërguar një libër së bashku me Pejgamberin. Prandaj, edhe besimin ndaj atij Libri duhet ta fusë brenda "Amentusë" së tij. Emri i këtij libri të shenjtë është Kurani Fisnik.

Cilido që nuk beson se Muhamedi (a.s.), është zgjedhur si "i Dërguar" nga Allahu Teala dhe se Kurani është dërguar bashkë me të, nuk bëhet fjalë që të përfshihet brenda kornizës së Islamit.

Faza e tretë është hulumtimi i tablosë së të Dërguarit në Kuran, pra në fjalën e Allahut, dhe i mënyrës se si janë caktuar ligjet e tij, nga Vullneti që e ka dërguar atë. Myslimanizëm do të thotë pikërisht vendosje e kornizave të mendimit dhe jetës sonë, sipas rregullave që ka caktuar Allahu Teala.

A ka rregulla në Kuranin Fisnik në lidhje me detyrimet e myslimanit kundrejt Pejgamberit (a.s.)? Po, ka. Këtu mund të parashtrohet edhe një pyetje tjetër: A janë të vlefshme edhe në ditët e sotme ajetet e Kuranit që bëjnë fjalë për të Dërguarin e Allahut, (a.s.)? Kjo pyetje domosdoshmërisht sjell edhe pyetjen tjetër: "Cilat ajete të Kuranit janë të vlefshme dhe cilat jo, në ditët e sotme?" Për sa i përket një çështjeje të tillë, vendimin nuk mund ta japë asnjë përveç Allahut (xh.xh.). Përpjekja për të dhënë vendim në këtë mesele, është në kundërshtim me natyrshmërinë e kësaj çështjeje. Nëse besohet se dikush tjetër përveç Allahut ka autoritet për të ndryshuar fjalët e Zotit (xh.xh.), duket qartazi se në pah nuk do të ngelte më Kuran. Për këtë arsye, thënia: "Dispozita e këtij ajeti ka qenë për të kaluarën.", është tentativë për ta shkatërruar Kuranin Fisnik. E njëjta gjë është e vlefshme edhe për ajetet që flasim për të Dërguarin e Allahut, (a.s.). Prandaj, ajo që i takon myslimanit, është përpjekja për ta kuptuar librin e Allahut dhe për të formësuar një disiplinë jete sipas dispozitave të tij.

Atëherë, e gjithë çështja është që myslimanët t'i mësojnë këto rregulla, ta perceptojnë sa më mirë secilin prej tyre dhe të formojnë një kornizë jete, siç





*Allahu Teala thotë për të Dërguarin e Tij: "**Të kemi dërguar si mëshirë për botët."** (Enbija, 107.), dhe nuk bën ndonjë kufizim në lidhje me kohën, vendin, racën dhe ngjyrën, atëherë do të thotë se të gjithë njerëzit, me në krye besimtarët, duhet të përpiqen ta bëjnë të Dërguarin e Allahut, (a.s.), mëshirë për veten e tyre. Domethënë, një mendim i formës: "I Dërguari i Allahut ka qenë mëshirë vetëm në kohën kur është zbritur Kurani.", nuk është gjë tjetër përveçse një mendim totalisht i gabuar.*

është e nevojshme që ato të reflektojnë në jetë.

Allahu i Madhëruar thotë në Kuranin Fisnik, madje duke u betuar: "(Betohem se) ***Allahu u ka dhënë besimtarëve dhuratë të madhe, kur u solli një të dërguar nga gjiri i tyre...***" (Al 'Imran, 164.) Atëherë duhet t'i vëmë në veprim të gjitha aftësitë mendore, për ta perceptuar si duhet këtë ajet. Ky ajet së pari u drejtohet "besimtarëve", sepse secili nga ne duhet ta shohë Resulullahun (a.s.), si një mirësi të Allahut (xh.xh.). Pastaj duhet ta kuptojmë se çfarë do të thotë mirësi nga aspekti i jetës sonë. Ajeti i plotë është si më poshtë:

"(Betohem se) ***Allahu u ka dhënë besimtarëve dhuratë të madhe, kur u solli një të dërguar nga gjiri i tyre, i cili ua lexon shpalljet e Tij, i pastron nga gjynahet dhe u mëson Librin*** (Kuranin) ***e urtësinë*** (diturinë e thellë fetare)***, edhe pse më parë, me të vërtetë, ata ishin në rrugë krejt të gabuar."***

Çfarë kuptojmë nga ky ajet? I Dërguari i Allahut, (a.s.), është ai që e largon njeriun nga devijimi, që i pastron besimtarët dhe ua mëson atyre Kuranin dhe urtësinë.

Domethënë se ne duhet të kapemi fort pas të Dërguarit të Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të, në mënyrë që të mos shkojmë drejt devijimit. Ne duhet të kapemi fort pas të Dërguarit të Allahut, (a.s.), për t'u pastruar, për të mësuar Librin dhe për të arritur urtësinë. Prandaj, nën përkufizimin e "mirësisë" që përmendet në ajet, le të lexojmë edhe shumë ajete të tjera që flasin për të Dërguarin e Allahut, (a.s.).

Nëse Allahu Teala thotë për të Dërguarin e Tij: ***"Të kemi dërguar si mëshirë për botët."*** (Enbija, 107.), dhe nuk bën ndonjë kufizim në lidhje me kohën, vendin, racën dhe ngjyrën, atëherë do të thotë se të gjithë njerëzit, me në krye besimtarët, duhet të përpiqen ta bëjnë të Dërguarin e Allahut, (a.s.), mëshirë për veten e tyre. Domethënë, një mendim i formës: "I Dërguari i Allahut ka qenë mëshirë vetëm në kohën kur është zbritur Kurani.", nuk është gjë tjetër përveçse një mendim totalisht i gabuar. Nga mund ta nxjerrim një përfundim të tillë?! Si mund ta ndërpresim kështu mëshirën e Allahut?!

Nëse Zoti (xh.xh.), i thotë të Dërguarit të Tij në Kuranin Fisnik: ***"Me të vërtetë, ti ke një moral të lartë."*** (Kalem, 4.), atëherë, detyra që u takon të gjithë atyre që e besojnë Kuranin si libër të Allahut, është që ta mësojnë moralin e të Dërguarit të Allahut, (a.s.), dhe të pajisen me moralin e tij. Këtë duhet ta bëjnë me dëshirën e zjarrtë për të fituar "mirësinë hyjnore".

Zoti (xh.xh.), thotë në Kuran: ***"Në të Dërguarin e Allahut ka një shembull të mrekullueshëm për atë, që shpreson tek Allahu dhe Dita e Fundit dhe e përmend shumë Allahun."*** (Ahzab, 21.) Atëherë, në lidhje më këtë qëndrim, çfarë detyrash i takojnë besimtarit? Së pari i takon të kuptojë se i Dërguari i Allahut, (a.s.), është përkufizuar nga Zoti (xh.xh.), si shembull i mrekullueshëm. Pastaj duhet të ketë parasysh se këtë perceptim, Allahu Teala ua jep atyre "që shpresojnë te Allahu dhe Dita e Fundit dhe që e përmendin Allahun shumë." Për këtë arsye, duhet të përpiqet ta sjellë zemrën në këtë pozitë, në mënyrë që t'i dhurohet ky perceptim. Pas kësaj etape, duhet të përvetësojë me të gjitha bukuritë e tij, "shembullin e mrekullueshëm", dhe të përpiqet ta ndërtojë personalitetin e vet duke u lyer me "bojën" e tij.

Myslimani duhet të mendojë se kur Zoti (xh.sh.), përdor termin "shembull i mrekullueshëm", do të thotë se këtu bëhet fjalë për një jetë të mrekullueshme që duhet të merret për shembull. Zoti i madhëruar thotë "Usvetun Hasene". Pra, nuk vë ndonjë kufizim në lidhje me ndonjë fushë të jetës.

Prandaj, nëse duhet të marrim dikë për shembull, le të marrim të Dërguarin e Allahut, (a.s.), sepse të gjitha bukuritë dhe cilësitë njerëzore kanë qenë të mbledhura te ai. Nëse do ta pasojmë atë, atëherë mirësia hyjnore do të mbartet edhe në jetën tonë.

Bazuar në këto që thamë më sipër, tentativa për

ta kufizuar marrëdhënien e të Dërguarit të Allahut, (a.s.), me myslimanët, nuk është gjë tjetër përveçse devijim. Çfarë po përpiqen të bëjnë njerëzit sot? Po përpiqen të kufizojnë Kuranin Fisnik. Si rezultat, po përpiqen të kufizojnë vullnetin e Allahut Teala. Si mund të quhet kjo gjendje e mjerueshme?

Tashmë le t'i lexojmë këto ajete që Zoti (xh.xh.), i ka zbritur për të drejtat e të Dërguarit të Tij, (a.s.), dhe t'i bëjmë ato parim të jetës sonë:

"Ata që të janë betuar për besnikëri, në të vërtetë, i janë betuar për besnikëri Allahut. Dora e Allahut është mbi duart e tyre!.."(Fet'h, 10)

"Tashmë ju ka ardhur një i Dërguar nga gjiri juaj. Atij i vjen rëndë për gjynahet që bëni ju, jua dëshiron të mirën me gjithë zemër që ju të shkoni rrugës së drejtë dhe është i butë e i mëshirshëm me besimtarët." (Teube, 128)

"O Profet! Ne të kemi dërguar ty si dëshmitar, sjellës të lajmit të mirë dhe paralajmërues, njëkohësisht (të kemi çuar) si thirrës, që i fton njerëzit në rrugën e Allahut me urdhrin e Tij dhe si pishtar ndriçues." (Ahzab, 45-46)

"...Çfarëdo që t'ju japë i Dërguari, merreni atë, e çfarëdo që t'ju ndalojë, hiqni dorë prej saj..." (Hashr, 7)

"...Shkoni pas Tij, që të jeni në rrugën e drejtë!.." (A'raf, 158)

"Falni namazin, jepni zeqatin dhe bindjuni të Dërguarit, për të fituar mëshirën e Allahut!" (Nur, 56)

"...Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit të Tij, nëse jeni besimtarë të vërtetë." (Enfal, 1)

"Kush i bindet të Dërguarit, i është bindur Allahut..." (Nisa, 80)

Çfarë kuptojmë nga këto ajete?

Ata që i binden të Dërguarit të Allahut, (a.s.), i binden Allahut Teala. Atëherë, ajo që na takon të bëjmë është të mësojmë se si mund t'i bindemi të Dërguarit të Allahut, (a.s.), dhe pastaj të veprojmë sipas informacionit që marrim.


I Dërguari i Allahut, (a.s.), është cilësuar si një "njeri nga gjiri ynë", si një njeri që ndjen keqardhje kur besimtarët bien në vështirësi, si një njeri i butë, i mëshirshëm, dëshmitar, përgëzues, paralajmërues, thirrës për te Allahu dhe një kandil që përhap dritë prej Zotit (xh.xh.).

Allahu i Lartësuar kërkon që t'i bindemi atij. Ai na njofton se bindja ndaj të Dërguarit, është bindje ndaj Tij. Gjithashtu na tregon se rruga e drejtë është vetëm rruga e Resulullahut, (a.s.). Pastaj në fund, Zoti i Madhëruar na e shpjegon qartë se arritja e mëshirës është e lidhur me bindjen ndaj të Dërguarit të Tij.

Atëherë, ajo që na takon të bëjmë, është të mësojmë se çfarë është bindja ndaj Pejgamberit tonë të nderuar.

Zoti (xh.xh.), kërkon prej nesh që të marrim çfarëdo që na jep Pejgamberi, dhe të largohemi prej çdo gjëje që ai ka ndaluar. Atëherë, neve na takon që të mësojmë saktësisht gjithçka që na jep Resulullahu, (a.s.), çdo gjë prej të cilave dëshiron që ne të largohemi, dhe ta sistemojmë jetën sipas tyre.

Ai që i kthen sytë drejt Kuranit Fisnik, që ia vë veshin Librit të Zotit (xh.sh.), dhe që e konsideron si parim të jetës thirrjen e Allahut Fuqiplotë, i respekton ligjet e të Dërguarit të Allahut, (a.s.). Çdo gjë tjetër përveç kësaj, është fjalë boshe dhe devijim, pra kërkim i një rruge tjetër përveç rrugës së të Dërguarit të Zotit. Pra, është kërkim i diçkaje tjetër prej Islamit.



Së fundi, le ta lexojmë edhe këtë ajet fisnik, që i bashkon ligjet e Allahut (xh.xh.), me ligjet e të Dërguarit të Allahut, (a.s.):

"O ju që keni besuar! Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit kur ju thërret drejt asaj që ju jep jetë! Dhe ta dini se Allahu ndërhyn midis njeriut dhe zemrës së tij dhe se tek Ai do të mblidheni të gjithë!" (Enfal, 24)

Çfarë na takon të bëjmë kur ta lexojmë këtë ajet fisnik? Neve na takon të kuptojmë se rregullat që do të na japin jetë, janë rregullat te të cilat na fton Allahu dhe i Dërguari i Tij. Pastaj duhet ta sistemojmë jetën sipas këtyre rregullave.

Si thotë profesor Nexhip Fazëlli:

"I nderuar, përgëzues, shpëtimtar dhe Pejgamberi im!

Një rregull që nuk përputhet me ty, do ta refuzoja edhe nëse do të bëhej fjalë për vetë jetën."

Çfarë mund të thuhet tjetër?! Allahu na dhëntë mend të gjithëve dhe mos na largoftë nga rruga e drejtë!

AJAS PASHA KRYEVEZIRI I PALODHUR

QË VDIQ NGA MURTAJA

Dr. Ardian Muhaj

Ajaz Pasha (Ayas Mehmed Pasha, 1483–1539) me sa duket ishte i biri i një shkodrani të martuar me një delvinjote dhe i lindur në Vlorë. Një raport i vitit 1531 i një agjenti në shërbim të spanjollëve që ia dërgonte Alfonso Kastriotit në Kalabri, pohonte se Ajaz Pasha që në atë kohë ishte vezir i dytë pas Ibrahim Pashës, ishte nga zona e Vlorës dhe se sanxhakbeu i Vlorës ishte i vëllai i Ajazit.[1] U bë kryeministër në 14 mars 1536 pas ekzekutimit të Pargali Ibrahim Pashës dhe e mbajti këtë detyrë deri sa vdiq në vitin 1539.[2]

Mori pjesë në fushatën e Selimit I kundër sefevidëve më 1514 në betejën e Kaldiranit si Aga i Jeniçerëve. Po ashtu ishte një nga figurat kryesore të fushatës së luftës mes osmanëve dhe memlukëve të Egjiptit në vitet 1516-1517. Një raport i kohës pohon se në dorën e tij u dorëzua mbreti i fundit memluk i Egjiptit, Tumanbej. Në vitet 1520-1521 u ngrit në rangun e qeveritarit të Damaskut dhe të bejlerbeut të Anadollit. Më pas mori pjesë në luftën për marrjen e ishullit me rëndësi të Rodit në Egje, duke drejtuar krahun e djathtë të flotës osmane. Pas ndryshimeve të vitit 1523 që sollën si sadrazam Ibrahim Pashën u ngrit në rangun e vezirit. Ishte po ashtu figurë me rëndësi në betejën e Mohaçit më 1526 që përfundoi me fitoren vendimtare osmane kundër hungarezëve si edhe në rrethimin e parë të Vjenës më 1529.[3] Rolin më të rëndësishëm e pati në luftën e Irakut në vitet 1534-1535, duke qenë drejtues i fushatës ushtarake. Siç pohonte bailiu venedikas në Stamboll, portugezët tashmë po merren në konsideratë nga Sulltani, qoftë për shkak të pranisë së tyre në Oqeanin Indian ashtu edhe për ndihmën që mund t'u jepnin sefevidëvë.[4] Në këtë këndvështrim pushtimi osman i Irakut që përfundoi në 1534 i forcoi pozitat e tyre në Oqeanin Indian. Pak muaj pas hyrjes triumfale të Sulejmanit I në Bagdad, në shoqërinë e Ibrahim Pashës, Sulejman Pashës dhe shqiptarit tjetër Ajas Pashës, sundimtarë të tjerë nxituan të afrohen me osmanët. Mes tyre ishin emiri Rashid i Basrës, emiri i Bahrejnit dhe ai i Katifit, duke siguruar kështu kufirin detar me portugezët në zonën e Gjirit Persik.[5]

Duke qenë vezir për rreth 13 vite, pas ekzekutimit të Ibrahim Pashës u bë kryeministër.[6] Edhe pse ishte nga kontingjentet e devshirmesë, pra i larguar për arsim ushtarak që në fëmijëri i mbajti lidhjet me Shqipërinë dhe vendlindjen gjithnjë. Sipas bailiut venedikas në Stamboll Piero Bragadin, ai kishte edhe dy vëllezër të tjerë, ndërkohë që e ëma ishte akoma e krishterë.[7] Të ëmës ai dërgonte çdo muaj 100 dukatë.[8] Lidhjet e pashkëputura të tij me vendlindjen i dëshmon një farefis i tij. Në vitin 1535 një person që në dokumentacionin spanjoll paraqitej me emrin Dionisio della Vechia, i propozoi perandorit Karli V një projekt jorealist që pretendonte marr-

1. "El secundo bascia se chiama Ayas nato in le ville intorno a la Velona et ha un fratello lo quale e sanjacho nel predetto loco. AGS Estado, legajo 635, doc. 108, 29 gusht 1531, fl.4

2. ismail Hâmi Danismend, *Osmanlı Devlet Erkânı*, Türkiye Yayınevi, istanbul, 1971, f. 15; Ömer Mahir Alper, "Ayas Mehmed Pasa" *Yasamları ve Yapıtlarıyla Osmanlılar Ansiklopedisi*, İstanbul, 1999, vëll.1 f. 272; Cavid Baysun, "Ayas Pasa", *iA*, vëll. II, f.43-47; Bekir Kütükoglu, "Ayas Pasa", *DiA*, vëll. IV, f. 202-203.

3. Robert Elsie, *A Biographical Dictionary of Albanian History,* I. B. Tauris, 2012, f.21.

4. *"Il re di Portogallo viene in considerazione del Signor Turco… per [le cose] dell'Indie, si per l'aiuto che ditto re potesse fare dare al Sofi per quella via, come per l'impresa che potesse il Signor Turco fare a distruzione della navigazione di Portogallo in quelle parti ."* Alberi, *Relazioni*, 3: 22.

5. S. Özbaran, "Ottoman Turks," f. 55; Floor, *Persian Gulf* , f. 156.

6. Danismend, *Kronoloji*, V: f. 16-17; Vernon J. Parry, "Ayas Pasha," *EI, Second Edition* (Leiden: Brill, 1960- 2004).

7. «Il terzo bassà, nome Aias di nazion albanese, nato appresso la Zimera, mostra esser uomo di guerra et aver animo di far guerra et gran cose…sono tre fratelli. Ha la sua madré Cristiana". Bragadino shkruante në 1526, kur edhe thotë se ishte 44 vjeç.

8. Hammer gabimisht pohon se ai kishte tre vëllezër murgj. Ndërkohë mbishkrimi në gurvarrin e tij shkruan Ayas b. Mehmed, çka nënkupton se i ati ishte mysliman ose ishte bërë mysliman. V. J Parry, "Ayas Pasha", *Encyclopaedia of Islam, Second Edition*, Edited by: P. Bearman, Th. Bianquis, C.E. Bosworth, E. van Donzel, W.P. Heinrichs.



jen e Shkodrës e madje përzënien e osmanëve prej krejt Shqipërisë. Sipas fjalëve të tij ai bashkë me vëllanë, që në dokument shkruhet si Joan de la Vecchia, u ofronte spanjollëve dorëzimin e kështjellës së Shkodrës përmes një komploti, duke pohuar se ishin farefis të kryeministrit perandorak, shqiptarit Ajas Pasha. Njëri prej tyre madje kishte banuar në shtëpinë e tij në Stamboll për një farë kohe. Nga ana e tij vetë kryeministri Ajaz Pasha kishte urdhëruar qeveritarin e sapoemëruar të sanxhakut të Shkodrës që të mbështesë dhe privilegjojë axhën e tij Dionisin.[9] Natyrisht që kryeministri nuk ishte në dijeni të pretendimeve të Dionizit për të shfrytëzuar farefisninë me të për të paraqitur projekte pa asnjë mundësi realizimi në oborrin spanjoll. Ajo që del nga ky raport e përforcon mendimin se ai kishte farefis si në zonën e Sanxhakut të Vlorës nga ishte e ëma, ashtu edhe nga Sanxhaku i Shkodrës, prej nga kishte të atin. Në vakëfnamen e tij del se ka lënë vepra bamirësie në shërbim publik përveç se në vendet e shërbimit në administratë, si Stamboll, Edirne, edhe në vendlindje, si në Berat, Vlorë, Gjirokastër, Delvinë, Janinë.[10]

Nën kryeveziratin e tij osmanët ndërmorën fushatën e vitit 1537 me qendër në Vlorë dhe që fillimisht synonte që në bashkëpunim me francezët të merrnin Italinë e Jugut nga spanjollët. Sulejmani i Madhërishëm kur mbërriti në Vlorë përmes Elbasanit e gjeti tashmë flotën osmane të grumbulluar në portin e Vlorës, por jo atë franceze. Për shkak të koordinimit të pamjaftueshëm mes tyre, objektivi i fushatës ndryshoi dhe forcat osmane në praninë e Sulltan Sulejmanit I iu drejtuan Korfuzit venecian. Megjithë përpjekjet e Ajas Pashës për të shmangur përfshirjen e Venedikut në luftë kundër osmanëve, Senati venedikas vendosi të shpallë luftën. Kjo edhe përkundër faktit që mes dy shteteve marrëdhëniet kishin qenë paqësore që prej fillimit, dhe kishte 35 vite që mes tyre kishte pasur një paqe të qëndrueshme, shumë e rrallë kjo në Europën e kohës. Përmes bailiut dhe ambasadorëve Ajas Pasha u përpoq të hapte një kanal komunikimi përpara se të ishte vonë dhe të zgjidheshin mosmarrëveshjet me bisedime. Pjesë e tensioneve ishte edhe një shumë prej tetë mijë dukatesh ari që një tregtar italian i kishte borxh vetë kryevezirit Ajas Pasha.[11] Sipas kronistit osman Haxhi Halife, vendimi për ndërmarrjen e kësaj fushate ishte ndikuar nga kryeministri Ajas Pasha, që ishte vetë nga kjo krahinë. Këtu kishte edhe prona siç dëshmohet jo vetëm nga vakëfnamja e tij, por edhe nga fakti që në 1524-1525 ambasadori venedikas në Stamboll i pagoi Ajas Pashës 150 dukatë për vreshat që ia kishte marrë me qera në kazanë e Argosit në Peloponez.

Në këtë fushatë që u mbyll me fitoren osmane në betejën detare të Prevezës të vitit 1538, në krye të flotës osmane ishte Lufti Pasha edhe ky shqiptar nga kjo zonë. Ishte flota më e madhe që osmanët kishin mobilizuar ndonjëherë prej 280 anijesh. Për t'u theksuar është se edhe pse Hajredin Barbarosa ishte edhe ai i pranishëm në krye të 130 anijesh, në këtë rast drejtimi i flotës i besohet vendaliut Lutfi Pasha.[12] Edhe gjatë rrethimit të Korfuzit, Hajredin Barbarosa ishte nën komandën e Lutfi Pashës. Të dy këta në fakt nuk ishin dakord me vendimin e Sulltan Sulejmanit dhe kryevezirit Ajas Pasha për të hequr rrethimin dhe për t'u tërhequr. Megjithëse ushtria tokësore u tërhoq Lutfi Pasha dhe vartësi i tij Hajredin Barbarosa ndërmorën një sulm mbi Qefaloninë duke marrë plaçkë të madhe lufte.[13] Me këtë rast u ndërtua kalaja e Vlorës, e cila ishte një nga kështjellat më të forta të ndërtuara nga osmanët në Ballkan. Po ashtu me këtë rast u krijua Sanxhaku i Delvinës, që u nda nga ai i Vlorës, në të cilin përfshihej deri atëherë.

Ajas Pasha e mbajti detyrën e kryeministrit pa ndërprerje deri sa vdiq në Stamboll nga epidemia e murtajës në 13 korrik të vitit 1539. U varros në xhaminë Sulltan Ejup të Stambollit. Pas Ajas Pashës që vdiq nga epidemia e murtajës erdhi në krye të qeverisë osmane shqiptari tjetër Lutfi Pasha, kontingjent i devshirmesë, ka të ngjarë nga zona e Vlorës. Sipas kronistit Mustafa Ali, Ajaz Pasha pati një jetë familjare shumë aktive. Thuhej madje se la pas vetes njëzet fëmijë. [14]

9. AGS, *E* 1310, fols. 76 (29 nëntor 1533) dhe 195-197; *E* 1312, fols. 121-122 (11 Maj 1536). AGS, *E* 1312, fol. 161 (8 Shtator 1536) Gürkan, "Espionage in the 16th Century Mediterranean, f. 174.

10. H. Ahmet Arslantürk, "Sadrazam Ayas Pasa'nın Vakfiyeleri ve Bir Sınırnâmesi", *Osmanlı Arastırmaları / The Journal of Ottoman Studies,* XXXVII (2011), f. 165-180.

11. Kenneth Meyer Setton, *The Papacy and the Levant (1204-1571), Volume III. the Sixteenth Century*, 1976, f. 407-408.

12. *The History of the Maritime Wars of the Turcs*. Translated from the Turkish of Haji Khalifeh by James Mitchell, London, 1831, f. 55.

13. Haji Khalifeh, *The History of the Maritime Wars*, f. 58.

14. Leslie P. Peirce, *The Imperial Harem: Women and Sovereignty in the Ottoman Empire*, Oxford University Press, 1993, f. 304.



TË KUPTUARIT E SURES HUXHURAT

Xhafer Durmush

Në ajetet e para të sures Huxhurat thuhet: ***"O ju që keni besuar! Mos nxitoni para*** (urdhrit të) ***Allahut dhe të Dërguarit të Tij dhe kijeni frikë Allahun! Vërtet, Allahu dëgjon gjithçka dhe është i Gjithëdijshëm. O ju që keni besuar! Mos e ngrini zërin tuaj mbi zërin e Profetit dhe mos i flisni atij me zë të lartë, siç bëni me njëri-tjetrin, në mënyrë që të mos ju humbin veprat tuaja pa e ndier ju fare."*** (Huxhurat, 1-2)

Kur marrim Kuranin në dorë dhe lexojmë suren Huxhurat, shohim se në këtë sure është vendosur struktura e shoqërisë model për njerëzimin. Kjo strukturë përbëhet nga tri relata kryesore:

E para: Detyrat që kemi kundrejt Allahut (xh.xh.), dhe të Dërguarit të Allahut, (a.s.). Besimtarët duhet t'u besojnë dhe nënshtrohen krejtësisht urdhrave dhe ndalesave që janë dhënë në Kuranin Fisnik dhe Sunetin e Pejgamberit (a.s.). Ata nuk duhet të kalojnë para Allahut dhe të Dërguarit të Tij, në asnjë çështje. Siç e kanë vazhduar sahabët e nderuar respektin dhe besnikërinë ndaj të Dërguarit të Allahut, (a.s.), deri te rregulli për të ulur tonin e zërit, edhe ne sot jemi të obliguar që të kemi respekt për personalitetin e tij shpirtëror dhe Sunetin.

Gjithçka që urdhërohet në dy ajetet e para të sures fisnike, në të njëjtën kohë përbën edhe themelin e shoqërisë islame, sepse Islam do të thotë paqe dhe nënshtrim. Virtytet si bindja dhe respekti ndaj të mëdhenjve, në një shoqëri, forcojnë bashkimin dhe unitetin. Këto të fundit nxjerrin në pah fuqinë e kësaj shoqërie. Ndërsa mosbindja shkakton trazira dhe përçarje, të cilat bëhen shkak që shoqëria ta humbasë fuqinë e saj. Për këtë arsye, së pari në këtë sure fisnike është urdhëruar që të mos kalojmë në asnjë çështje para Allahut dhe të Dërguarit të Tij. Ndërsa në ajetet që vijojnë, lajmërohen ata që ulin zërin në audiencën e të Dërguarit të Allahut, (a.s.): ***"Vërtet, ata që ulin zërin në prani të të Dërguarit të Allahut janë njerëzit, zemrat e të cilëve Allahu i ka kalitur për besim e përkushtim. Për ata ka falje dhe shpërblim të madh."*** (Huxhurat, 3) Sakaq, për ata që nuk e shfaqin këtë ndjeshmëri, thuhet: ***"Vërtet, ata që të thërrasin ty (o Muhamed) me zë të lartë nga jashtë dhomave të tua, shumica e tyre nuk marrin vesh."*** (Huxhurat, 4)

E dyta: Marrëdhëniet njerëzore ndërmjet besimtarëve.

Këtu është urdhëruar largimi nga sjelljet dhe veprimet që cënojnë të drejtat e vëllazërisë, të cilat mund t'i radhisim si më poshtë:

Ne nuk duhet të marrim vendime duke i besuar lajmit që sjell një njeri i devijuar, por patjetër duhet të hulumtojmë për vërtetësinë e fjalëve të tij dhe të sigurohemi për të. Në të kundërt, pa e ditur mund t'i shkaktojmë dëm shoqërisë, ose mund të bëjmë veprime për të cilat do të pendohemi më vonë. Tashmë, në këtë kohë kur të vërtetat shndërrohen në të pavërteta me metoda që as nuk mund t'i imagjinojmë, mund të themi se një masë e tillë paraprake është shumë e rëndësishme.

Nëse dy popuj prej besimtarëve vendosen ballë për ballë me njëri-tjetrin dhe fillojnë të luftojnë, ne duhet t'i pajtojmë. Kjo është e detyrueshme për besimtarët. Nëse njëra palë e kalon cakun dhe e sulmon tjetrën, pala sulmuese duhet të luftohet derisa të kthehet te urdhri i Allahut (xh.xh.). Mbi të gjitha, duhet të veprojmë me drejtësi, sepse mbrojtja

e vëllazërisë fillon me mbajtjen e drejtësisë ndërmjet vëllezërve.

Qofshin gra apo burra, besimtarët nuk mund ta tallin njëri-tjetrin. Përçmimi i bashkëbiseduesit apo neglizhimi i tij, janë prej gjërave që lëndojnë më fort vëllain në fe.

Ne nuk duhet ta përçmojmë veten dhe nuk duhet ta thërrasim njëri-tjetrin me llagape të këqija. Nisur nga kjo, myslimani duhet të jetë modest, por veten nuk duhet ta përçmojë. Dinjitetin e të tjerëve duhet ta konsiderojë njësoj si dinjitetin e vet. Prandaj, askënd nuk duhet ta thërrasë me llagape negative.

Ne nuk duhet të krijojmë mendime të caktuara, me paragjykim, pa pasur informacionin e duhur në lidhje me çdo lloj çështjeje, sepse kjo mund të shkaktojë dëme të konsiderueshme që janë të vështira për t'i rregulluar, siç shkakton dëme edhe dhënia e vendimit duke u mbështetur te lajmi që e sjell një njeri i devijuar.

Ndalimi i racizmit. Racizmi është ai që shkakton më së shumti dëme ndaj bashkimit dhe unitetit ndërmjet besimtarëve. Racizëm do të thotë ndezje e zjarrit të përçarjes, që nuk mund të shuhet lehtësisht. Këtu, duke iu bërë e qartë njeriut se është krijuar nga Ademi dhe Havaja, i kërkohet që t'i ndjejë e t'i kuptojë urtësitë e ndarjes në popuj dhe fise. Gjithashtu theksohet se epërsia e vetme qëndron tek devotshmëria.

E treta: Marrëdhëniet e besimtarëve me njerëzit e tjerë.

"Të gjithëve duhet t'u japim vlerën e të qenit njerëz. Ne duhet të përpiqemi me mish e me shpirt për udhëzimin e tyre. Besimtarët duhet t'i sqarojnë çdo njeriu me të cilin bisedojnë, se mirësia më e madhe është nderimi me Islam dhe se kjo nuk mund të krahasohet me asgjë."[1] Në ajetin e katërmbëdhjetë, thuhet se kjo duhet të bëhet në përputhje me nivelin e njerëzve.

Ndërmjet parimeve që gjenden në suren Huxhurat, është edhe paralajmërimi që besimtarët nuk duhet të shfaqin sjellje apo veprime që i lëkundin ndjenjat e vëllazërisë dhe bashkimit, sepse vëllazëria fetare është një strukturë gjithëpërfshirëse që duhet të mbrohet me përpikëri. Vëllazëria fetare është një mirësi e madhe. Ndërsa mbajtja në jetë e këtyre strukturave domosdoshmërisht kërkon që njeriu t'ua dijë vlerën.

Kjo sure e begatë na njofton se ne mund të jetojmë vëllazërisht, me bindje dhe respekt, së pari ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij, dhe pastaj ndaj të mëdhenjve tanë. Ajo na mëson se duhet të kemi kujdes nga veprimet që e dëmtojnë vëllazërinë. Ja pra, kjo është rruga e të qenit një ummet që i ka hije të Dërguarit të Allahut, (a.s.).

1. Hakk'in Daveti Kuran-i Kerim Meali ve Tefsiri, Prof. Dr. Omer Çelik, Botimet Erkam, Stamboll, 2013, vëll. 4, fq. 589.

LEXO MENDO

DASHURIA NDAJ PEJGAMBERIT

Në suren Teube thuhet:

"Tashmë ju ka ardhur një i Dërguar nga gjiri juaj. Atij i vjen rëndë për gjynahet që bëni ju, jua dëshiron të mirën me gjithë zemër që ju të shkoni rrugës së drejtë dhe është i butë e i mëshirshëm me besimtarët." (Teube, 128.)

Dashuria gjithëpërfshirëse që i Dërguari i Allahut, (a.s.), kishte ndaj ummetit, shprehet me termin "haris". Ndërsa dhembshuria dhe mëshira e tij, shprehen me cilësimet "rauf" dhe "rahim", të cilat nuk janë përdorur për asnjë pejgamber tjetër.

Ne e dimë se i Dërguari i Allahut, (a.s.), na donte. Ai ka predikuar thirrjen e Zotit (xh.xh.), e cila na fton në Xhenetin e përhershëm. Ai na i ka hapur krahët, duke thënë që përtej dhjetëra shekujsh: "Vëllezërit e mi!" Pejgamberi ynë i nderuar e vazhdon këtë thirrje çdo ditë, me hadithet që kanë mbushur vëllime të tëra, dhe përpiqet të na mbrojë që të mos biem në zjarr. Siç shprehet edhe në Mevludin e Sulejman Çelebiut: Pejgamberi natë e ditë i përgjërohet Zotit duke thënë: "Ummeti im! Ummeti im!"

Ne gjithashtu e dimë se duhet t'i përgjigjemi me respekt dashurisë që zbret me dhembshuri nga të mëdhenjtë. Atëherë, le të shohim se çfarë kemi bërë për ta merituar dashurinë e të Dërguarit të Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të. Allahu i Lartësuar e ka urdhëruar Pejgamberin që të thotë: ***"Nëse e doni Allahun, më pasoni mua, në mënyrë që Allahu t'ju dojë dhe t'jua falë mëkatet."*** (Al 'Imran, 31.) Atëherë, sa u rrimë besnikë Kuranit Fisnik dhe Sunetit në jetën tonë të përditshme? Sa përpiqemi që të fitojmë kënaqësinë e Zotit Mëshirëplotë dhe pëlqimin e të Dërguarit të Allahut, (a.s.), jo vetëm në kohë të caktuara, por përgjatë gjithë kohës? Sa shqetësohemi për ta mbartur shoqërinë në breza që edukohen me dashurinë e Pejgamberit (a.s.)?

Shpërthimi i filizave të farave të dashurisë nëpër zemrat tona, mund të bëhet duke i shumuar këto pyetje.

Zgjidhja për ndihmë ndaj individit, shoqërisë, umetit dhe njerëzisë gjendet në përshpirtje

M. Ali Eshmeli

Kurdo që njerëzimi është bërë pre e interesave dhe e dëshirave të nefsit, atëherë është bërë edhe agresive dhe barbare. Ajo kështu ka ndarë të njëjtin rol me shejtanin e mallkuar. Madje, e ka tepruar edhe më shumë. Si rezultat, doli Nemrudi dhe tha: *"...*(Edhe unë jam zot.) ***Edhe unë mund të jap jetë e të shkaktoj vdekje..."*** (Bakara, 258) Doli Faraoni dhe i: ***"Tuboi njerëzit e u deklaroi: "Unë jam zoti juaj më i lartë!"*** (Naziat, 23-24) Doli Karuni dhe tha: ***"...Kjo më është dhënë vetëm prej diturisë sime..."*** (Kasas, 78)

Çfarë nuk kanë bërë dhe çfarë nuk kanë thënë. Edhe pse një fjalë e urtë thotë: "Ha kafshatë të madhe, por mos fol me fjalë të mëdha!" – ata që nuk dëgjojnë dhe nuk marrin mësim nga e kaluara, vazhduan të bëheshin hallka të reja të të njëjtit gabim. Ata formuan rrugë të ndryshme dhe guxuan të bënin punë çnjerëzore për t'i arritur qëllimet e tyre. Ata u bënë mosmirënjohës e mashtrues dhe u zhytën në ligësi. U bënë dinakë dhe e shndërruan në profesion dinakërinë e mashtrimin. Gjithmonë shkaktuan luftëra, i vranë dhe i prenë njerëzit vetëm e vetëm për të qëndruar në pushtet. Ata dhanë çdo gjë të tyre për këtë. Pastaj e tepruan aq shumë saqë deklaruan se ishin zota. Gjithashtu pohuan se ishin edhe pejgamberë. Kur nuk i arritën dot ato që dëshironin, u tërbuan. Pastaj u mburrën, u hoqën si të mëdhenj dhe krenarë me ato që bënë. Ata bënë çdo lloj agresiviteti dhe barbarizmi në këtë rrugë. Allahu Teala thotë për këta në Kuranin Fisnik:

"Pikërisht këta janë ata që kanë këmbyer udhëzimin me humbjen, kështu që tregtia atyre nuk u solli kurrfarë dobie dhe as nuk ishin të udhëzuar në rrugën e drejtë." (Bakara, 16)

Sytë e tyre u verbëruan kundrejt dritës që do t'ju bënte dobi. Ndërsa veshët iu shurdhuan kundrejt fjalës hyjnore. Secili prej tyre u bë prej të poshtëruarve. Të gjithë u rrëzuan dhe u kapluan nga dobësia më e madhe. Njëri prej tyre u mposht nga një mushkonjë topalle, dikush u përpi nga dheu dhe dikush tjetër u mbyt në ujë.

Ata jetuan larg dhe të shkujdesur ndaj Zotit dhe përshpirtjes. Kjo u bë shkak për shkatërrimin e tyre në këtë botë dhe në botën tjetër. Ata që ia vunë veshin thirrjes hyjnore, morën mësim. Ndërsa ata



që i mbyllën sytë ndaj mesazhit hyjnor dhe e lanë në harresë, përsëritën të njëjtat gabime. Tani edhe bota që po globalizohet po shfaq përsëri të njëjtat gabime dhe injorancë. Siç kanë qenë të djeshmit fatzinj, ashtu janë edhe të sotmit. Ata qëndruan larg Rrahmanit dhe afër shejtanit. Qëndruan larg drejtësisë e mëshirës dhe pranë zullumit e poshtërsisë. Qëndruan larg përshpirtjes e njerëzillëkut dhe ia dedikuan jetën e tyre adhurimit të interesave dhe barbarizmit. Qëndruan larg shpëtimit e prehjes shpirtërore dhe merituan humbjen e ndëshkimin.

Kur njeriu privohet nga cilësitë e virtytshme dhe edukimi shpirtëror, për fat të keq, kërkon vetëm shkatërrimin e vet. Vetëm për shkak të kësaj gjithmonë ka ngjarje tragjike dhe të tmerrshme ndërmjet individëve, familjeve, shoqërive dhe popujve. Në dorën e kujtdo që të jetë fuqia, klithmat dhe britmat që i shkakton mendimi se i forti është në të drejtë po dëgjohen në çdo vend të botës. Çfarë nuk shkatërrojnë sulmet, urrejtjet e pafundme, barbarizmat dhe padrejtësitë e atyre që janë tepër të pasur dhe që janë të privuar nga aspekti shpirtëror? Ja pra, u bënë dy shekuj që në gjeografinë islame po shkatërrohet historia, civilizimi, bibliotekat, po shemben monumentet, po vriten foshnjat, po vriten nënat, po prishen vatrat dhe po shkatërrohet çdo gjë prej qafirëve dhe një dore shkatërrimtare. Të gjithë njerëzit po përjetojnë tmerr. E gjitha kjo sepse njeriu ka nevojë për edukim.

Kur njeriu privohet nga cilësitë e virtytshme dhe edukimi shpirtëror, për fat të keq, kërkon vetëm shkatërrimin e vet. Vetëm për shkak të kësaj gjithmonë ka ngjarje tragjike dhe të tmerrshme ndërmjet individëve, familjeve, shoqërive dhe popujve. Në dorën e kujtdo që të jetë fuqia, klithmat dhe britmat që i shkakton mendimi se i forti është në të drejtë po dëgjohen në çdo vend të botës.


Njeriu ka nevojë për edukim shpirtëror, jo për edukim djallëzor. Ai ka nevojë për një edukim shpirtëror që do ta bëjë të jetojë sipas rregullave në dobi të njerëzimit. Ky edukim është disiplina, mësimi dhe kalitja shpirtërore. Pra, është edukimi mistik Islam, sepse ky lloj edukimi i ka gjunjëzuar në derën e të vërtetës edhe mbretërit më të fuqishëm të botës dhe i ka bërë ata jo tiranë kundrejt popujve të tyre, por monumente mëshire dhe veçanërisht personalitete të larta. Në sajë të këtyre, bota dëshmoi për shekuj me radhë mëshirë, drejtësi dhe prehje shpirtërore. Ligësitë u mposhtën. Për këtë arsye, ato nuk mundën t'i shkatërronin muret e mirësisë dhe mëshirës. Por siç e sulmojnë shëndetin mikrobet sapo të gjejnë mjedisin e përshtatshëm, edhe ata që përbëjnë palën negative, si domosdoshmëri e sprovës hyjnore mbi sipërfaqen e tokës, gjithmonë janë përpjekur ta prishin njerëzimin sapo u është dhënë shansi i parë. Format më të tmerrshme të këtyre aksioneve me mikrobe janë qasjet që shfaqen sikur të jenë me të vërtetën, por që në realitet përpiqen t'ia shkatërrojnë aspektin shpirtëror njeriut dhe ta shndërrojnë atë plotësisht në një krijesë materialiste.

Veçanërisht këtu dëshirojmë të theksojmë edhe armiqësinë ndaj përshpirtjes. Kur këtë e bëjnë jobesimtarët, është normale, por kur të diturit e shkujdesur zënë vend në të njëjtin rresht me jobesimtarët kundër përshpirtjes, atëherë kjo është një humbje e madhe dhe e dhimbshme. Edhe përdorimi i materialeve fetare për t'ia tharë dhe shkatërruar njeriut aspektin shpirtëror, është diçka mjaft e çuditshme. Pra, është diçka dredharake sikur dëshiron ta bësh njeriun ateist duke i thënë: Ky është besimi më i drejtë! Prandaj duhet të pyesim:

Përpjekja për ta shkatërruar devotshmërinë, edukatën, urtësinë dhe përshpirtjen që Islami dëshiron t'i ndërtojë te njeriu, mos vallë është një miqësi me zemër të hapur apo një armiqësi e fshehtë me zemërngurtësi? Mos vallë është një punim akademik i pranueshëm apo aktivitet i një injorance dinake dhe disfatizëm? Mos vallë është edukim shkatërrimi i ndërtesës së paqëndrueshme të besimit të nxënësve me dinamitin e dyshimit krejt pa vend dhe pa e ndjerë ata? Mos vallë nxjerrja e të vërtetës në pah, njohja e së drejtës dhe përfaqësimi i saj është veprimtaria për ta këputur si me sëpatë këtë lidhje të dobët të brezit të sotshëm që ka me Allahun dhe Pejgamberin për shkak të atyre që kanë bërë jobesimtarët? Çfarë shpreh mendimi për ta thyer timonin për shkak të shoferit të dobët, apo mendimi për t'i shkatërruar mihrabet për shkak të një imami që gabon, apo mendimi për t'i thyer lapsat dhe grisur letrat për shkak të një pikture të shëmtuar? Qëllimi nga kjo është mjaft i qartë. Për këtë arsye, sot ndjehet nevoja për përshpirtje më shumë se kurrë. Veçanërisht devotshmëria, siç ka qenë gjithmonë, edhe në ditët e sotme është shumë e domosdoshme. Mbi të gjitha është e domosdoshme për botën e dijes/shkencës. Përndryshe njeriu largohet nga Allahu Teala. Ai largohet nga Zoti (xh.xh.), sado i ditur që të jetë. Pra, largohet nga Allahu i

Lartësuar siç është larguar shejtani i mallkuar. Ndërsa shkaku i vetëm i këtij largimi është egoizmi... Pra, kanceri shpirtëror që është kusht për t'u hequr nga njeriu. Për këtë arsye, kjo çështje në mistikën islame është njëra prej temave bazë të edukimit të njeriut, sepse egoizmi është një çengel i shejtanit që e pengon robin për t'iu afruar Allahut Teala. Ja pra, edhe shejtanin, krahas gjithë asaj dijeje që kishte, mikrobi i egoizmit e shkatërroi. Për këtë arsye, edukimi shpirtëror është një urdhër hyjnor i ardhur pikërisht nga Allahu, xhel-le xhelaluhu, për të nxjerrë nga zemra dhe jeta çdo lloj të egoizmit negativ dhe të gjitha ndikimet e tij.

Njeriu ka nevojë për edukim shpirtëror, jo për edukim djallëzor. Ai ka nevojë për një edukim shpirtëror që do ta bëjë të jetojë sipas rregullave në dobi të njerëzimit. Ky edukim është disiplina, mësimi dhe kalitja shpirtërore.



Praktika më e qartë e kësaj është kurbani, sepse kurbani nuk është vetëm çështje e therjes së kafshës. Kurbani, para therjes së kafshës, ka anën e edukimit hyjnor që përjetohet nga besimtari. Ky edukim formohet në formën: Flijim i egoizmit, nefsi, pasuria, shpirti dhe fëmijët të mos zënë vendin e Zotit (xh.sh.), në zemër dhe të gjitha këto t'i bëhen kurban/t'i dorëzohen Allahut Teala. Ato duhet të bëhen kurban për Allahun Teala në thellësitë e zemrës dhe asnjëherë nuk duhet të shndërrohen në idhuj, sepse kurbani çdo gjë që nuk mund të bëhet kurban, domethënë, çdo gjë që nuk mund t'i dorëzohet Poseduesit të saj të vërtetë, do të thotë se është shndërruar në idhull për zemrën. Ky rregull është i vlefshëm për dijen, për fëmijët, për pasurinë, për jetën etj. Për këtë arsye, Allahu i Lartësuar e ka hedhur edhe në praktikë amanetin që në të vërtetë duhet të bëhet kurban shpirtërisht, në mënyrë që ta kuptojë e gjithë njerëzimi.

A e urdhëron Allahu njeriun që të therë fëmijën e tij? A mund ta zbatojë njeriu këtë urdhër? Nëse Allahu është Ai që e urdhëron këtë, sigurisht që mund ta zbatojë, sepse Allahu Teala urdhrin e Tij në fakt e bën që të zbatohet, por rezultatin e realizon sipas vullnetit të tij të lartë dhe jo siç shikohet dhe pritet nga njerëzit. Ja pra, me këtë vetëdije Ibrahimi, alejhi's-selam, e çoi birin e tij, Hazreti Ismailin në vendin ku do ta bënte kurban. Sipas transmetimeve Ismaili (a.s.), më së shumti ishte trembëdhjetë vjeç. Babai i tij e shtriu atë përtokë me dhembshuri, ia vuri thikën në fyt dhe e tërhoqi, por në ato momente Allahu Teala e urdhëroi thikën të mos priste. Për këtë arsye, ajo nuk e preu Ismailin (a.s.). Domethënë, Allahu i Madhëruar e urdhëroi Ibrahimin (a.s.): "There birin tënd për ta bërë kurban për Mua!" Ndërsa thikën e urdhëroi: "Ndërsa ti mos e prit!" Në këtë mënyrë, vepra e therjes u realizua vetëm në botën e brendshme të Ibrahimit (a.s.) dhe të Ismailit (a.s.).

Ndërsa baba e bir ishin të habitur nga kjo që ndodhi, në ato momente erdhi Xhebraili (a.s.). Pranë kishte një dash që e kishte sjellë nga Xheneti. Ai u dha sihariq atyre për mirësinë e Allahut Teala. Ata thanë tekbire dhe e therën dashin. Allahu i Madhëruar ka thënë kështu për Ibrahimin, alejhi's-selam, në Kuranin Fisnik:

"Ibrahimi, i cili ishte shumë besnik..." (Nexhm,

37) Krahas lavdërimit që i bëri, i dha edhe vlerësimin hyjnor duke u shprehur: ***"Ne e zëvendësuam atë*** *(Ismailin)* ***me një kurban të madh dhe i lamë atij*** *(Ibrahimit)* ***kujtim të mirë në brezat e mëvonshëm. "Paqja qoftë mbi Ibrahimin!" Ja, kështu, Ne i shpërblejmë punëmirët. Ai ka qenë vërtet një nga robërit Tanë besimtarë."*** (Saffat, 107-111)

Domethënë se qëllimi i Allahut Teala kur e urdhëroi Hazreti Ibrahimin për ta therë birin e tij, Ismailin, alejhi's-selam, nuk ishte që ta bënte një baba të therte birin e tij, por ishte që ta bënte një baba t'i ekzekutonte të gjitha dashuritë e përkohshme përveç dashurisë së Allahut në zemrën e vet. Pra, edhe nëse bëhet fjalë për dashurinë ndaj fëmijës. Ndërsa qëllimi që e urdhëroi Ismailin ta pranonte këtë flijim, nuk ishte për ta therë atë në qafë, por për ta bërë atë ta kuptonte se diçka që i përket Allahut nuk mund të bëhet e askujt. Madje, këtë ia aprovoi me babain e tij.

E gjithë çështja është që të mos biem në një gjendje që nuk dëshirojmë t'i kthejmë pas amanetet që ka dhënë Allahu Teala dhe të mos i shndërrojmë ato në idhuj. Pra, të mos e shndërrojmë në idhull as shpirtin, as pasurinë dhe as fëmijët dhe të përjetojmë besnikërinë e dashurinë për t'ia dhënë çdo amanet Poseduesit të vërtetë.

Allahu i Lartësuar kërkon vetëm këtë gjendje dashurie. Përndryshe, qëllimi i Tij nuk është që ta bëjë robin të therë birin e tij. Siç ka thënë edhe Mevlana, Xhelaleddin Rumiu: "Nëse dikush e zgjat qafën dhe përgatitet për t'u bërë kurban për Allahun si Hazreti Ismaili, Allahu nuk lejon që t'i pritet qafa."

Siç është kusht të jesh mysliman për të therë kurban, po ashtu, edhe për t'u bërë kurban është kusht një nënshtrim në shkallën e dashurisë. Gjithashtu, siç është kusht që të jesh i lirë për të therë kurban, edhe për t'u bërë kurban është kusht një vullnet dhe dëshirë që buron nga brenda dhe pa pasur asnjë lloj imponimi. Siç është kusht për të qenë një njeri i mençur që e ka arritur pubertetin për të bërë kurban, edhe për t'u bërë kurban është kusht që të jesh një njeri me mendje të shëndosh dhe i pjekur shpirtërisht. Siç është kusht pasuria për të therë kurban, është kusht është për t'u bërë kurban. Në çfarëdo çështjeje që do të bëhemi kurban, mendja dhe zemra duhet të jenë të pasura në lidhje me atë çështje. Nëse do të bëhemi kurban për besimin, patjetër duhet të jemi të pasur në besim. Në të njëjtën mënyrë, duhet të jemi të pasur në dashuri, në dije etj., sepse dikush që është i varfër në dashuri, nuk mund të bëhet kurban. Ai që është i varfër në besim, nuk mund të bëhet kurban. Të bërët kurban është shenjë e pasurisë. Gjithashtu është edhe shenjë e besnikërisë dhe lidhjes së fortë shpirtërore. Nisur nga kuptimi dhe natyra sublime e kurbanit, i Dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, ka thënë:

"Namazi është kurbani i çdo njeriu të devotshëm." (Kuzai, Musned, I, 181.)

Nisur nga ky aspekt, e vërteta më e qartë e kurbanit është që ai të bëhet për hir të Allahut Teala. Thuhet se në umetet e kaluara kishin qenë dy besimtarë. Në vendin ku jetonin, politeistët i kishin imponuar për të therë kurban për një idhull që e kishin bërë vetë. Ata të dy rezistuan dhe e refuzuan këtë duke thënë: "Kurbani theret vetëm për Allahun." Këtë herë politeistët i kërcënuan duke u thënë: "Atëherë përgatituni për vdekje! Ose do të therni kurban për idhullin tonë, ose do t'ju vrasim!" Por politeistët nuk e arritën dot atë që dëshironin. Për këtë arsye, atyre zullumqarëve dhe fatzinjve iu shtuan edhe më shumë zemërimi e hidhërimi. Më pas, këtë çështje e kthyen në çështje inati. Ata patjetër dëshironin t'ua bënin atë që u thoshin. Por sidoqoftë, gjoja e lehtësuan pak propozimin duke u thënë: "Të paktën therni një mizë dhe shpëtoni nga vdekja!"

Njëri prej këtyre dy besimtarëve e pa të zakonshëm dhe jo të dëmshëm me një shikim sipërfaqësor këtë propozim. Pastaj bëri një vlerësim të verbër dhe mendoi: "Ajo është thjeshtë një mizë! Çfarë të keqeje ka nëse e ther atë? Në vend se të vdes, më e logjikshme do të ishte që ta therja këtë mizë..." Nisur nga ky mendim, ai e pranoi këtë propozim të politeistëve. Menjëherë pasi e pranoi, bëri kurban një mizë për idhullin që i treguan ata. Pastaj politeistët e lanë të lirë atë. Po kështu edhe besimtarit tjetër thanë:

"Hajt, there edhe ti një mizë!" Por besimtari tjetër nuk e pranoi këtë propozim. Përsëri ua ktheu: "Sido që të jetë, kurbani theret vetëm për Allahun!" Nisur nga ky refuzim, politeistët u zemëruan shumë dhe e martirizuan këtë besimtar të begatë duke i thënë: "Sa njeri i pamend paske qenë!" Në këtë mënyrë, ky besimtar e dha shpirtin, por nuk e dha besimin. Për këtë arsye, u bë prej banorëve të Xhenetit. Ndërsa besimtari që bëri kurban një mizë për idhullin e politeistëve dhe që mendoi se shpëtoi, ndërroi jetë pa e shpëtuar dot besimin e tij kur i erdhi exheli. Për shkak të kësaj, ra në humbjen e përhershme.

Ja dy pikëkthesa/qëndrime për shkak të kurbanit! Që të dyja janë jetike. Që të dyja janë shumë të

rëndësishme nisur nga destinacionet. Që të dyja shumë të rralla nisur nga mësimi që japin. Mesazhi që jepet është mjaft i qartë: Dashuria, besimi dhe afrimiteti ynë është vetëm sa sakrifikojmë, sepse jeta është e ndërtuar mbi themelin e sakrificës. Edhe feja është sakrificë, edhe dashuria...

Kjo është sakrifica që e bëri Ibrahimin "Halil/mik të Zotit", Ismailin "Delil/argument" dhe Jusufin "Xhemil/të bukur". E vërteta e jetës nga fillimi e deri në fund:

Çfarë pret një foshnje e dobët e sapolindur? Çfarë pret një nënë dhe baba që dridhen nën kthetrat e pleqërisë? Çfarë pret një i sëmurë që përpëlitet në dhimbje? Çfarë presin të dëmtuarit nga tërmetet që u janë shembur shtëpitë të cilat janë strehimi i jetës së tyre? Çfarë presin rënkimet e shkreta që kërkojnë shpresë jete ndërmjet gërmadhave dhe nën bombardime? Çfarë presin milingonat që kanë rënë robër të flakëve dhe po digjen të gjalla? Çfarë kërkojnë të dëshpëruarit që presin në gojën e krokodilit të zisë pa asnjë shpresë për jetën? Çfarë presin fëmijët e vegjël që nuk dinë të notojnë në dallgët e cunameve të mëdha që kanë shpërthyer në shpirtrat dhe moralin e njerëzve? Çfarë pret historia e baltosur në faqet fisnike të saj? Vetëm një gjë: Sakrificën...

Çdo gjë po pret sakrificën. Pra, një sakrificë që do të shndërrohet në festë. Një sakrificë që e shndërron zemrën, në të cilën pikon, në një zemër monument mëshire dhe dhembshurie.

Siç dihet, kjo botë që kur është krijuar e deri më tani gjithmonë ka përjetuar vullkane, tërmete, furtuna, mungesë të ushqimit, sëmundje, fatkeqësi, vuajtje, luftëra... Për këtë arsye, të gjitha rrugëzgjidhjet janë mbledhur në një fjalë të vetme: Sakrificë...

Hazreti Ibrahimi u hodh në zjarr me katapultë nga ana e Nemrudit dhe e fitoi sprovën e sakrificës me jetën e tij. Zjarri jo që nuk e dogji Ibrahimin, alejhi's-selam, por u shndërrua edhe në kopsht trëndafilash për të. Pejgamberi i begatë në këtë mënyrë fitoi cilësinë "el-Halil / mik i Zotit".

Edhe i Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të, ka shfaqur të njëjtën sakrificë. Madje, ai arriti pikën kulmore në shfaqjen e sakrificave. Në këtë mënyrë, fitoi cilësinë "el-Habib / i dashuri i Zotit". Edhe sakrifikuesit në kohën e tij që i thanë me gjithë zemër: "Të qoftë falë dhe t'u bëfshin kurban nëna, babai dhe pasuria ime, o i Dërguari i Allahut!" – në audiencën e tij për çdo urdhër, dëshirë, shenjë, frymë, hap, fjalë dhe të vërtete që shprehte, arritën nderin për t'u bërë sahabë të tij. Ndërsa ata që u bënë shembuj të kësaj sakrifice pa e parë të Dërguarin e Allahut (a.s.), fituan pozitën për t'u bërë vëllezërit e Hazreti Pejgamberit (a.s.). Ai që e sakrifikoi veten për një përgëzim të tillë, u bë Fatih dhe Akshemseddin. Ata që shfaqën sakrifica të panumërta, gjithmonë u lartësuan dhe u bënë Mevlana, Junus, Edebali, Nakshibend dhe Hydaji. Të gjithë këta arritën gjendje sublime.

Në të vërtetë, a nuk është sakrifica e fshehta e festave të vërteta? Sigurisht! Ai që e bën veten kurban, ka festë. Ai që e bën pasurinë kurban, ka festë. Ata që ia dorëzojnë në kohë fëmijët Zotit (xh. xh.), kanë festë, sepse Allahu i Madhëruar thotë në Kuranin Fisnik:

"Tek Allahu nuk arrin as mishi, as gjaku i tyre, por arrin përkushtimi juaj. Kështu, Ai i ka vënë ato në shërbimin tuaj që ju ta madhëroni Allahun sepse ju ka udhëzuar. Dhe, jepu lajmin e mirë, punëdrejtëve!" (Haxh, 37) Domethënë, qëllimi nga kurbani është që ta mbrujmë gjendjen tonë shpirtërore me devotshmëri. Domethënë, afrim te Allahu Teala. Pra, afrim me sinqeritet ndaj Tij. Afrim me gjithë shpirt dhe nën orientimin e Islamit. Afrim me dashuri. Afrim në një mënyrë shumë të pastër. Për këtë arsye, asnjëherë nuk duhet të harrojmë se kurbani gjithmonë e afron njeriun te ai për të cilin e ka therë kurbanin. Nëse njeriu ther kurban për një gur, atëherë edhe njeriu ngurtësohet. Nëse ther kurban për dhe e pluhur, atëherë edhe shpirti zhytet në baltë. Nëse njeriu ther kurban për Allahun e Lartësuar, atëherë zemrat bëhen udhëtare të miraxhit.

Për këdo që të bëhet therja e kurbanit, andej anon edhe qendra e besimit. Pastaj fillon një lidhje e fortë ndërmjet atij për të cilin është therë kurbani dhe atij që e ka therë kurbanin. Për këtë arsye, personin prej atyre dy besimtarëve që folëm më sipër në të vërtetë nuk e shkatërroi therja e kurbanit, por afrimi me idhujt për shkak të nijetit për kurbanin. Sikundër kësaj, besimtari tjetër u lartësua dhe e arriti lumturinë e përhershme me nënshtrimin dhe kurbanin që bëri për Allahun e Madhëruar, sepse me kurbanin, i cili është afrim i zemrës me atë për të cilin bëhet kurbani, qoftë pozitiv apo qoftë negativ, përjetohen ndryshime dhe transformime të mëdha. Prandaj, edukimi i njeriut në lidhje me kurbanin mbart një rëndësi shumë të veçantë, sepse, nisur nga natyrshmëria e tij, nëse njeriu jepet pas krijesave të përkohshme, domethënë, nëse kaplohet nga paraja, objektet e çdo gjë tjetër, duke u bërë kurban për to, atëherë largimi prej tyre bëhet i vështirë e në disa raste edhe i pamundur. Të njëjtën gjë mund ta themi edhe për të kundërtën e kësaj gjendjeje. Kushdo që e flijon veten e tij për dashurinë subli-

me dhe Krijuesin e Lartë, do të thotë se zemra e tij tashmë është e lidhur me lidhje të pakëputshme. Në të vërtetë, e gjitha që synohet nga këto që thamë është arritja e kësaj pjekurie në rrugën e nënshtrimit ndaj Allahut (xh.sh.).

Dashuritë e vërteta gjithmonë i kanë lidhur zemrat me njëra-tjetrën nëpërmjet kodit të kurbanit. Kurbani gjithmonë ka qenë shenja më e rëndësishme dhe e vetme e dashurisë së vërtetë. Të gjithë poetët e dashuruar i kanë shprehur poezitë e tyre në horizontin e flijimit për Allahun Teala. Ja Junus Emreja! Jetën e tij e pranon si flijim/kurban, sepse sipas tij ky është rregulli i përparimit në rrugën e drejtë të Zotit (xh.xh.).

"Junusi është i varfër dhe i shkretë,

Ai e bën kurban çdo gjë që të ketë,

Prandaj te Subhani eja, strehohu ti vetë,

Eja ti zemër në rrugën e drejtë!.."

Junus Emre e shpreh me emocion dhe me një gjuhë flijimi edhe përmallimin që ndjen ndaj të Dërguarit të Allahut (s.a.s.):

"Jeta ime i qoftë kurban rrugës tënde,

Emrin e ke të bukur, vetë je i bukur, Muhamed..."

Të flijohesh për atë është nderi më i madh. A mund të ketë ndonjë mirësi më të madhe se kjo për njeriun? Kurrë. Në të vërtetë:

"Gjembi (i ndarë nga trendafili) meriton vetëm zjarrin,

Por kur ai gjendet pranë trëndafilit meriton xhenetin..." (Sejri)

Ja, kjo zemër për të cilën folëm është trëndafili. Pra, zemra e të urtëve. Zemra e miqve të Allahut Teala. Zemra e personaliteteve monumentale. Domethënë, zemrat që nuk kanë largësi me Zotin (xh. sh.).

Lum për besimtarët që e kalojnë të gjithë jetën e tyre bashkë me ata!

Ndërkohë mjerë për ata që nuk e konceptojnë dot këtë të vërtetë!


Mjerë për ata!

Mjerë për ata që u bëhen kurban nefsit, shejtanit dhe armiqve të tyre në vend që t'i bëhen Allahut Teala! Mjerë edhe për të diturit që ia bëjnë të vërtetat kurban injorancës! Mjerë edhe për të shkujdesurit që ua bëjnë kurban mizat moderne idhujve modernë të kohës së fundit! Një mijë herë mjerë edhe për ata që ia kushtojnë veten padrejtësisë dhe barbarizmit në vend që t'ia kushtojnë drejtësisë dhe mëshirës!

Krahas këtyre,

Lum për ata që kapen pas përshpirtjes pa e prishur aspak qëndrimin e tyre të drejtë krahas materializmit, barbarizmave dhe padrejtësive!

Në veçanti lum për ata fatlumët që e kanë arritur lumturinë e përhershme ngaqë u janë nënshtruar dhe e kanë flijuar veten e tyre për Sulltanin e pejgamberëve, për rrugën e tij të ndritur dhe për miqtë e Zotit (xh.sh.)!



NJERËZIA KA NEVOJË PËR MORALIN DHE CIVILIZIMIN MADHËSHTOR

Morali të cilin e lavdëron Kurani

Allahu i Lartësuar thotë:

"(O i dashuri im!) ***Me të vërtetë, ti je me virtyte madhore."*** (Kalem, 4)

I vetmi mësues dhe edukator i të Dërguarit të Allahut (a.s.), është Allahu i Madhëruar. Atë e ka edukuar Zoti (xh.sh.). Morali i tij i pashoq është shëmbëlltyrë për njerëzimin, është shembulli më ideal dhe kriter real...

Allahu i Madhëruar thotë:

"Në të Dërguarin e Allahut ka një shembull të mrekullueshëm për atë, që shpreson tek Allahu dhe Dita e Fundit dhe e përmend shumë Allahun." (Ahzab, 21)

Ai morali madhështor është busulla e udhëzimit që të shpie te pëlqimi i Allahut Tealа...

Ai morali madhështor është çelësi i paqes e i lumturisë në këtë botë dhe i shpëtimit e i xhenetit në botën tjetër...

Ai moral madhështor është një llambë ndriçuese që e largon çdo lloj errësire dhe një kandil udhëzimi që shkëlqen...

Ne kemi nevojë për atë moral. Ne duhet t'ia reflektojmë edhe njerëzimit atë moral madhështor në formë pasqyrash të pastra duke e përjetuar vetë dhe duke i bërë edhe të tjerët ta përjetojnë... Sepse:

NJERËZIMI KA NEVOJË PËR ATË

Meqë gjendemi në atmosferën e qetë të përkujtimit të ditëlindjes së të Dërguarit të Allahut (a.s.), do të ishte me vend t'i përmendnim disa shembuj nga madhështia e moralit të tij dhe ta kontrollonim jetën tonë duke e peshuar me moralin e Pejgamberit.

Por jemi të detyruar që ta shprehim se gjuha jonë është e paaftë për ta përkufizuar plotësuesin e moralit të lartë, domethënë, përfaqësuesin më të shkëlqyer të moralit të lartë, burimin e krenarisë së krijesave, atë që ishte dritë nga koka deri te këmbët, të Dërguarin e Allahut (a.s.). Ajo që mund të bëjmë është që t'i hedhim disa pika uji fytyrës sonë të etur nga deti i mëshirës së pafundme dhe në këtë mënyrë, të përpiqemi t'i qetësojmë zemrat tona sado pak qoftë.



MORALI I TIJ ISHTE KURANI

Kurani Fisnik është arti më kulminant i Allahut të Madhëruar në fjalën e Tij.

Edhe i Dërguari i Allahut (a.s.), është arti më kulminant i Zotit (xh.sh.), në krijimin e njeriut. Këto dy pasqyra prej drite / fjala dhe krijimi i Zotit (xh.sh.), reflektojnë njëratjetrën.

Allahu i Madhëruar thotë:

"O ju që keni besuar! Mos nxitoni (me fjalët dhe veprat tuaja) ***para*** (urdhrit të) ***Allahut dhe të Dërguarit të Tij*** (pranojeni si kufi të pacenueshëm urdhrin e Allahut dhe Sunetin e të Dërguarit të Allahut) ***dhe kijeni frikë Allahun! Vërtet, Allahu dëgjon gjithçka dhe është i Gjithëdijshëm."*** (Huxhurat, 1)

Ndërsa ky hadith fisnik bën komentimin e ajetit të mësipërm:

"Fjala më e bukur është libri i Allahut. Rruga më e drejtë është rruga e Muhamedit." (Buhari, I'tisam, 2.)

Domethënë se krahas librit të Allahut, edhe Suneti dhe morali i lartë i të Dërguarit të Allahut (a.s.), i japin drejtim jetës sonë dhe janë kriteret për të njohur kufijtë.



Jeta e të Dërguarit të Allahut (a.s.), e cila është shembull për çdo besimtar deri në ditën e Kiametit, gjithmonë ishte mesatare. Ajo ishte larg ifratit dhe tefritit.

Ai, me jetën e ibadetit që e kryente me delikatesë, na ka treguar përsosmërinë e nënshtrimit ndaj Allahut Teala. Jo vetëm me jetën e ibadetit, por edhe me sjelljen shembullore prej kryefamiljari dhe administruesi, me sjelljen në fushën e punës dhe atë sociale, shkurtimisht të gjitha aspektet e jetës i ndriçoi me dritën e tij.

Ja një shembull i vogël nga ajo dritë:

MË MADHËSHTORI NË BUJARI

Krenaria e Gjithësisë, i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë në një hadith fisnik të tij:

"Te një besimtar i vërtetë nuk mund të gjenden:

Koprracia dhe morali i ulët!" (Tirmidhi, Birr, 41/1962.)

I Dërguari i Allahut (a.s.), ishte më bujar se erërat. Edhe kur ishte në vështirësi, edhe kur e kishte gjendjen mirë, gjithmonë jepte për hir të Allahut Teala. Në Medine, e cila ishte qendra e shtetit Islam, kishte raste që vinin plaçkat e luftës, por i Dërguari i Allahut (a.s.), ua shpërndante ato të varfërve pa e arritur mëngjesin.

Grada më e lartë e bujarisë është dhënia e përparësisë ndaj të tjerëve ndërkohë që ke nevojë vetë, familja dhe fëmijët. I Dërguari i Allahut (a.s.), përjetonte kulmin e altruizmit. Nevojave të as'habu's-suffas, domethënë, të nxënësve të Kuranit u jepte përparësi ndaj nevojave të vajzës dhe familjes së tij.

Po të dëshironte, mund t'i jepte Ehli Bejtit aq sa t'ua plotësonte të gjitha nevojat, sepse nganjëherë mrekullitë e duarve të tij të bekuara që i mbulonin me mirëqenie dhe begati

të gjithë, nganjëherë plaçkat e luftës që vinin me bollëk dhe nganjëherë mundësitë e pafundme që silleshin rreth e rrotull tij, ishin të mjaftueshme, madje tepronin për t'u dhënë pjesëtarëve të familjes së tij një jetë pa asnjë vështirësi. Por ai, ngaqë i jepte përparësi lumturisë së ahiretit, e cila është jeta e vërtetë, jepte aq shumë për hir të Allahut saqë shpesh herë nuk ngelte asgjë edhe për të.

Hazreti Aishja thotë:

"Familja e Muhamedit (a.s.), deri në momentin kur Ai ka ndërruar jetë, nuk e ka ngopur barkun me bukë elbi dy ditë radhazi." (Buhari, Ejman, 22; Muslim, Zuhd, 22; Ibn Maxhe, Et'ime, 48.)

Sepse mundësitë materiale ishin vetëm një mjet për t'i mëshiruar krijesat, për ta lartësuar fenë e Allahut dhe për t'i bërë ato shkak për udhëzimin e të tjerëve.

Safuan bin Umejje, i cili ishte njëri prej të mëdhenjve të politeistëve kurejsh, u gjend pranë të Dërguarit të Allahut (a.s.), në luftën e Hunejnit dhe të Taifit edhe pse nuk ishte bërë mysliman.

Ndërkohë që i Dërguari i Allahut (a.s.), po shikonte plaçkat e luftës që ishin mbledhur në Xhirane, vuri re se Safuani po e shikonte me mahnitje të madhe një pjesë prej tyre. Andaj e pyeti:

"A të pëlqeu shumë?"

Ai iu përgjigj: "Po." Nisur nga kjo, i tha:

"Merre, le të jetë e gjitha e jotja!"

Nisur nga kjo mirësi, Safuani nuk e mbajti dot veten dhe tha:

"Asnjë zemër nuk mund të jetë kaq bujare përveçse zemra e Pejgamberit." Pastaj tha shehadetin dhe u bë mysliman.

Ndërsa kur u kthye te fisi i tij, tha:

"O populli im! (Nxitoni dhe) bëhuni myslimanë, sepse Muhamedi po jep dhe po bën shumë mirësi pa ndjerë frikë nga varfëria dhe nevoja." (Muslim, Fedail, 57-58; Ahmed, III, 107.)

MEDOSTIA MË E SINQERTË

I Dërguari i Allahut (a.s.), edhe pse ishte më i nderuari dhe më i larti i krijesave si "rob dhe i dërguar", jetonte me një modesti mjaft të sinqertë. Edhe kur ishte i detyruar për t'i shprehur cilësitë e tij të larta, thoshte duke e theksuar:

"Nuk ka lavdërim. Këto nuk i them për t'u lavdëruar."

Në sajë të modestisë dhe mëshirës së gjerë, i çliroi zemrat e njerëzve nga çdo lloj shtrese e shoqërisë. Shumica e myslimanëve të parë që i besuan atij ishin të dobët, të varfër dhe robër. Një fshatar beduin i ardhur nga shkretëtira apo një rob që i ishte falur liria, sipas këndvështrimit të tij ndaj njerëzimit nuk kishte asnjë ndryshim nga njerëzit e pasur dhe prijësit. Ai i jepte përparësi vetëm pjekjes shpirtërore, domethënë, devotshmërisë.

I Dërguari i Allahut (a.s.), në një kohë paraditeje kur edhe sahabët e nderuar ishin pranë tij, u ul në gjunjë te sofra që ishte përgatitur. Një beduin që e pa këtë sjellje, u habit nga ajo ulje e kulturuar dhe tha i çuditur:

"Ç'është kjo ulje kështu?"

I Dërguari i Allahut (a.s.), tha:

"Allahu Teala më ka krijuar si një rob të ndershëm, jo si një inatçi dhe shtypës!" (Ebu Davud, Et'ime, 17/3773.)

Ai, si falënderim për moralin madhështor që ia dhuroi Allahu i Lartësuar, së pari e përhapi atë moral të lartë në një mënyrë që i la të mahnitur edhe armiqtë e tij dhe gjithmonë jetoi në një gjendje adhurimi dhe nënshtrimi ndaj Zotit (xh.sh.).

Shembujt më të bukur të modestisë së të Dërguarit të Allahut (a.s.), gjenden në kohët kur ishte më i fuqishmi dhe njeriu më me pushtet.

Kur i Dërguari i Allahut (a.s.), ishte në kulmin e fuqisë dhe pushtetit material, çliroi Mekketu'l-Mukerreme me një ushtri të përbërë nga dhjetë mijë sahabë të tij. Atë ditë, një bashkëqytetari të tij që i tha i frikësuar, i emocionuar dhe duke i kërcitur dhëmbët nga të dridhurat:

"O i Dërguari i Allahut! Ma mëso Islamin!, iu përgjigj me butësi duke i kujtuar këtë she-

mbull nga koha kur mundësitë i pati më të pakta dhe duke synuar nënën e tij:

"Qetësohu vëllai im! Unë nuk jam mbret apo sundimtar. Unë jam jetimi i fqinjës tënde të vjetër prej kurejshve që hante mish të tharë në diell!.."

Modestinë e tij e ndiqte falja dhe mëshira.

FALJA MË SUBLIME

Ai ishte Pejgamberi i mëshirës. Andaj i fali ata që i patën gjuajtur me gurë. I fali edhe ata që patën vrarë Hazreti Zejneben. I fali edhe ata që e torturuan xhaxhain e tij, sepse ai ishte i ngarkuar me detyrë që ta bënte njerëzimin të meritonte faljen e Allahut Teala. Ai ishte një njeri që e donte faljen dhe që posedonte një moral të dhuruar nga Allahu i Madhëruar.



Ditën e çlirimit të Mekës, politeistët kurejshë nuk arritën të shfaqnin as rezistencë kundrejt ushtrisë madhështore të Islamit. Për shkak se nuk kishin asnjë rrugëzgjidhje, u futën në Mesxhidu'l-Haram dhe po prisnin të shqetësuar ndëshkimin e atyre padrejtësive që patën bërë përgjatë 20 viteve.

I Dërguari i Allahut (a.s.), i pyeti:

"O populli Kurejsh! O mekas! Çfarë thoni? Çfarë pandehni se do të bëj me ju tani?"

Kurejshët i thanë:

"Ne mendojmë se do shfaqësh mirësi dhe do të na trajtosh me mirësi dhe themi: "Ti do të sillesh me mirësi ndaj nesh." Ti je një vëlla i nderuar dhe bamirës! Ti je biri i një vëllai të nderuar dhe bamirës! Tashmë ke arritur fuqinë dhe pushtetin. Kështu që na trajto me mirësi!"

Nisur nga kjo, i Dërguari i Allahut (a.s.), u tha:

"Gjendja ime me gjendjen tuaj do të jetë si gjendja e Jusufit me gjendjen e vëllezërve të tij. Unë po ju them siç u tha Jusufi vëllezërve të vet:

"Sot s'ka qortim për ju; Allahu do t'ju falë. Ai është më i mëshirshmi i mëshiruesve!" (Jusuf, 92) (Ibn Hisham, Siret, IV, 32; Vakidi, Megazi, II, 835; Ibn Sa'd, Tabakat, II, 142-143.)

Pejgamberi i mëshirës u dërgua në mesin e njerëzve që jetonin në errësirën e xhahilijetit dhe në një shoqëri agresive e injorante. Përgjatë gjithë jetës si profet, u dhunua dhe u ofendua pa mbarim. Por ai duroi, toleroi dhe shfaqi butësi.

DURIMI DHE BUTËSIA E PAFUNDME

I Dërguari i Allahut (a.s.), shpesh merrte borxh për të plotësuar nevojat e nevojtarëve prej umetit. Hazreti Bilali (r.a.), e tregon kështu sakrificën dhe bujarinë e të Dërguarit të Allahut (a.s.), të cilat kishin arritur pikën më të lartë të altruizmit:

"Që nga dita kur është dërguar si profet nga Allahu Teala e deri në ditën që ka ndërruar jetë, shumë punë të të Dërguarit te Allahut (a.s.), i kam kryer unë për të. Për shembull, kur i vinte ndonjë mysliman dhe e shikonte se ishte i varfër, më urdhëronte mua që të shkoja dhe të merrja borxh. Pastaj unë shkoja dhe merrja rroba e ushqime për atë..." (Ebu Davud, Haraxh, 33-35/3055; Ibn Hibban, Sahih, XIV, 262-264.)

Marrja borxh e të Dërguarit të Allahut (a.s.), për t'u dhënë të tjerëve, shfaq virtytin e tij për t'u dalë zot nevojtarëve edhe pse nuk kishte vetë dhe përbën një moral madhështor e dispozitë në çështjen e marrjes së borxhit.

Ebu Saidi'l-Hudri (r.a.), tregon:

"Një beduin erdhi te i Dërguari i Allahut

(a.s.) dhe i kërkoi borxhin që kishte për të marrë, por kur e bëri këtë, shfaqi një sjellje agresive. Madje i tha:

"Derisa të ma paguash borxhin, do vazhdoj të të shqetësoj."

Sahabët e nderuar e qortuan beduinin dhe i thanë:

"Turp të të vijë! Mesa duket, ti nuk e di se me kë po flet!"

Beduini tha:

"Unë po kërkoj hakun tim."

I Dërguari i Allahut (a.s.), u tha sahabëve:

"Përse nuk mbani anën e atij që ka për të marrë të drejtën e tij?" Pastaj dërgoi dikë te Havle binti Kajs dhe i tha:

"Nëse ke hurma të thata, ma paguaj këtë borxh! Kur të na vijnë hurmat, do të ta kthej borxhin."

Havle tha:

"Patjetër! Babai im të qoftë falë, o i Dërguari i Allahut!"

I Dërguari i Allahut (a.s.), ia pagoi borxhin beduinit dhe mbi të gjitha, i dha edhe ushqim për të ngrënë. Beduini, i cili u gëzua nga kjo sjellje, e shprehu lumturinë e tij duke thënë: "Borxhin e pagove në mënyrën më të mirë. Edhe Allahu ta dhëntë shpërblimin e plotë për këtë!"

Nisur nga kjo, i Dërguari i Allahut (a.s.), tha:

"Ja, këta (që e paguajnë borxhin e tyre ashtu siç duhet), *janë njerëzit më të mirë. Një shoqëri, në të cilën të dobëtit nuk mund t'i marrin të drejtat e tyre pa u lënduar, nuk mund të shpëtojë..."* (Ibn Maxhe, Sadakat, 17.)

Ja një shembull i pashoq i drejtësisë dhe butësisë së të Dërguarit të Allahut (a.s.)...

Ai i shikonte mëkatarët dhe njerëzit e pasjellshëm si zogj të plagosur. Kështu që nuk prekej kurrë prej tyre. Ai përpiqej me butësi për ta larguar umetin nga zjarri i xhehenemit dhe për ta shpëtuar nga injoranca, sepse ndërgjegjja e tij ishte e mbushur plot me ndjenjën e përgjegjësisë.

VETËDIJA E PASHOQE PËR PËRGJEGJËSINË

I Dërguari i Allahut (a.s.), e shikonte veten përgjegjës për të gjithë shoqërinë.

> *"Shtëpia më e mirë ndërmjet myslimanëve është ajo shtëpi në të cilën trajtohet mirë jetimi. Shtëpia më e keqe ndërmjet myslimanëve është ajo shtëpi në të cilën keqtrajtohet jetimi."*
>
> *(Ibn Maxhe, Edeb, 6.)*

Sa dëshmitarë fisnikë janë këto shprehje të tij për butësinë dhe ndjenjën e përgjegjësisë që kishte ai:

"Unë jam më afër ndaj çdo besimtari se vetja e tij. Nëse dikush lë pasuri kur të ndërrojë jetë, ajo pasuri u përket të afërmve të tij. Por nëse lë borxhe apo jetimë, ai borxh më përket mua. Edhe përkujdesja ndaj jetimëve është detyrë e imja." (Muslim, Xhuma, 43; Ibn Maxhe, Mukaddime, 7.)

I Dërguari i Allahut (a.s.), e ka inkurajuar edhe umetin që të preokupohet me të dobëtit në shoqëri duke thënë:

"Shtëpia më e mirë ndërmjet myslimanëve është ajo shtëpi në të cilën trajtohet mirë jetimi. Shtëpia më e keqe ndërmjet myslimanëve është ajo shtëpi në të cilën keqtrajtohet jetimi." (Ibn Maxhe, Edeb, 6.)

Andaj, a janë të mëshirshme zemrat tona si zemra e Atij?

A përhapin gjuhët tona erë trëndafili si gjuha e Atij?

Sepse sot është harruar veçanërisht hijeshia e të Dërguarit të Allahut (a.s.).

MË DELIKAT SE TRËNDAFILAT, MË ORATOR SE BILBILAT

I Dërguari i Allahut (a.s.), ishte një njeri i mbushur me hijeshi, delikatesë dhe butësi. Bukuria, madhështia, shkëlqimi dhe delikatesa e tij ishin aq të larta saqë nuk kishte nevojë për ndonjë mrekulli, argument dhe shenjë të veçantë se ai ishte Pejgamberi i Allahut Teala.

Në fytyrë kishte bukuri vezulluese, në fjalë kishte oratori, në sjellje kishte hijeshi, në gjuhë kishte gojëtari, në fjalë kishte rrjedhshmëri dhe në biseda kishte elokuencë. Ai asnjëherë nuk thoshte fjalë të padobishme. Kështu që çdo fjalë e tij ishte urtësi dhe këshillë. Në fjalët e tij asnjëherë nuk kishte thashetheme dhe gjëra të pavlera. Gjithmonë fliste sipas aftësisë së perceptimit të të gjithëve. Ishte i butë dhe modest. Asnjëherë nuk qeshte me të madhe duke e tepruar. Gjithmonë buzëqeshte. Ai që e shihte atë befasisht, kaplohej nga frika. Ai që takohej dhe bisedonte me të, ndjente dashuri për të.

Të folurit me këshilla të bukura, me fjalë të urta dhe me shembuj për t'i ftuar njerëzit në mirësi dhe për t'ua predikuar atyre Islamin, ishte metoda e të Dërguarit të Allahut (a.s.). Me mëshirën e gjerë të tij që i përfshinte të gjithë njerëzit dhe për hir të mirësisë, udhëzimit, shpëtimit, virtytit dhe humanizmit, i gjallëronte zemrat si shiu i begatshëm që bie ëmbël-ëmbël. Kur fliste me dikë, nuk kthehej nga ai vetëm me kokën, por me të gjithë trupin e tij.

Ai ishte njeriu që fliste më me oratori, më me koncizitet dhe më me urtësi prej njerëzve. Ai fliste në mënyrën më përmbledhëse dhe e shprehte në formën më të saktë qëllimin e tij.

Fjalët mbarojnë dhe boja thahet, por cilësitë e Atij Deti të Mëshirës nuk mbarojnë. Rruga më e vyer për t'ua dhënë njerëzve moralin madhështor të atij është përpjekja për ta përjetuar vetë atë moral të lartë. Për të marrë pjesë nga përshpirtshmëria e tij, duhet ta përjetojmë atë emocion.

Dy veta i dhanë selam Hazreti Selmanit dhe e pyetën:

"A je sahab i të Dërguarit të Allahut (a.s.)?" Ai iu përgjigj:

"Nuk e di." Të ardhurit dyshuan në mos kishin shkuar te ndonjë njeri i gabuar. Selmani (r.a.), e vazhdoi kështu fjalën e tij:

"Unë e kam parë të Dërguarin e Allahut (a.s.) dhe kam marrë pjesë në kuvendet e tij. Por sahab i vërtetë i të Dërguarit të Allahut (a.s.), është ai njeri që mund të hyjë në xhenet bashkë me të." (Hejsemi, VIII, 40-41; Dhehebi, Sijer, I, 549.)

Ndërsa hyrja bashkë me Atë në xhenet është e lidhur me bashkimin e mënyrës së jetesës sonë me jetesën e Atij në besim, ibadet, moral dhe vepra. Nëse sot mund ta perceptojmë dhe gjallërojmë me një vetëdije të tillë ditëlindjen e të Dërguarit të Allahut (a.s.) dhe shumë ditëlindje të tjera të tij, atëherë do të thotë se kemi përfituar siç duhet nga epoka e lumturisë.

Domethënë, ne mund të përfitojmë nga ai duke marrë pjesë nga përshpirtshmëria e tij dhe duke e përjetuar me devotshmëri këtë pjesë...

Allahu i Lartësuar e ka nderuar njeriun. Robi nderohet duke kaluar etapa në drejtimin e adhurimit, moralit dhe veprave të mira që gjenden në rrugën e drejtë të të Dërguarit të Allahut (a.s.) dhe në këtë mënyrë arrin gjendjen e kërkuar dhe sublime për të hyrë në xhenetin e mrekullueshëm.

Allahu Teala na bëftë prej atyre që jetojnë me këtë përshpirtshmëri!..

Zoti (xh.sh.), na bëftë prej robërve që marrin pjesë nga morali i të Dërguarit të Allahut (a.s.)! Gjithashtu na e mundësoftë dhe lehtësoftë për t'u bërë prej vëllezërve të tij që i merr malli dhe që dëshirojnë ta shohin atë!..

Amin!..



Rëndësia e Sunetit
TË TË DËRGUARIT TË ALLAHUT, (A.S.)

Mubarek Erkull

Ebu Rafi (r.a.), transmeton se i Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë: *"Kur të njoftoheni për një çështje që ua kam urdhëruar apo ua kam ndaluar, të mos gjej ndonjë prej jush që thotë duke u mbështetur në kolltuk: "Ne nuk i dimë këto. Ne pasojmë çfarëdo që gjejmë në librin e Allahut."*[1]

Suneti i të Dërguarit të Allahut, (a.s.), ngaqë është gjendja në praktikë e Kuranit Fisnik, përbën burimin e dytë bazë të Islamit, krahas Kuranit. Libri i Allahut Teala dhe Suneti i të Dërguarit të Allahut, (a.s.), si dy burime të pandashme, kanë mundësuar edhe formimin e strukturës shoqërore islame, por edhe vazhdimësinë e kësaj shoqëria, pa i humbur cilësitë.

Sipas dijetarëve të hadithit, Suneti është çdo gjë që na është transmetuar nga Muhamedi (a.s.).[2] Shkurtimisht, Suneti është jeta e Pejgamberit, e cila në Kuranin Fisnik paraqitet si "Usvetun Hasene" dhe morali i Pejgamberit, për të cilin Aishja (r.anha), shprehet: "Morali i tij ishte Kurani".[3]

Nisur nga ky kontekst, i Dërguari i Allahut, (a.s.), është një njeri i pashoq, nëpërmjet personalitetit të të cilit Shpallja Hyjnore është vënë në jetë. Pra, Kurani Fisnik te Resulullahu, (a.s.), ka dalë nga të qenit fjalë dhe është shndërruar në jetë. Për ata që dëshirojnë të hyjnë në edukimin e Shpalljes Hyjnore, këshillohet që të ecin në gjurmët e Pejgamberit tonë të nderuar dhe ta marrin si shembull atë. Shpallja e të Dërguarit të Allahut, (a.s.), nga vetë Allahu, si "shembull i shkëlqyer" për njerëzit, është bërë duke e përforcuar me betim në ajetin: **"**(Betohem se) ***në të Dërguarin e Allahut ka një shembull të mrekullueshëm për atë, që shpreson tek Allahu dhe Dita e Fundit dhe e përmend shumë Allahun."***[4]

Marrja për shembull e të Dërguarit të Allahut, (a.s.), para së gjithash do të thotë kuptim, përjetim dhe përhapje e fesë. Në këtë kontekst, Suneti është bazë e fesë dhe absolutisht nuk mund të ndahet nga Kurani Fisnik.

Hadithi që dhamë më lart dhe që njihet si "Hadithi Erike" ndërmjet dijetarëve, gjendet me transmetime të ndryshme në literaturën islame. Për shembull, ndërkohë që në një transmetim gjendet shprehja "i mbështetur në kolltuk", në një transmetim tjetër gjendet në formën "një burrë me bark të ngopur dhe i mbështetur në kolltuk". Por sidoqoftë, çështja e cila theksohet në të gjitha transmetimet është e njëjtë. Ky hadith fisnik njofton se me kalimin e kohës disa njerëz do të përpiqen ta ndajnë Allahun me të Dërguarin e Tij, apo thënë me një shprehje tjetër, ta ndajnë Kuranin me Sunetin duke përdorur konceptet, shprehjet dhe parullat klishe si: "mjaftimi me Kuran", "të vepruarit sipas Kuranit", "përqasje sipas Kuranit" dhe "Islami i Kuranit".

1. Ebu Davud, Sunet, 5; Tirmidhi, Ilm, 10; Ibn Maxhe, Mukaddime, 2; Darimi, Sunen, Mukaddime, 49; Bejhaki, Delail, 1/24; (Tirmidhiu thotë se ky hadith është "Hasen".)


2. Ismail Lutfi Çakan, Sunet, rreth Sunetit, Sunenit të Ebu Davudit dhe disa termave të hadithit, Mukaddime, fq. 14.

3. Shik. Ahmed b. Hanbel VI, 188 (Ismail Lutfi Çakan, vepra e lar - përmendur.).

4. Ahzab, 33/21.

"Ja pra, hadithi fisnik na ndihmon pikërisht në këtë pikë, me dritën e vërtetimeve dhe paralajmërimeve profetike. Në këtë mënyrë, ua ekspozon besimtarëve lojën që po bëhet, me të gjitha dimensionet e saj të vërteta. Pejgamberi ynë i dashur, me këtë hadith na ka njoftuar se një ditë do të dalin disa fatzinj që nuk do ta njohin autoritetin e tij për të vendosur dispozita, dhe që nuk do t'i japin rëndësi komentimit universal që sjell Suneti, dhe do të thonë që mjaftohen me Kuranin. Pastaj shprehet se nuk dëshiron ta shohë ndonjë nga sahabët apo nga ummeti i tij, tek shfaq një pohim dhe veprim të tillë. Në këtë mënyrë, ai ka sqaruar mjaft bukur dhe qartazi pretendimet për një Islam pa Sunet, dhe i ka paraprirë dhe ekspozuar ata që marrim guximin të bëjnë diçka të tillë." (Ismail Lutfi Çakan, Të vërteta me hadithe, 2, fq. 138.)

Padyshim se aktivitetet kundër Sunetit nuk janë



bërë vetëm në ditët e sotme. Këto lloje aktivitetesh dhe mendimesh mund t'i shohim në çdo periudhë të historisë islame. Këto lloje prirjesh, që kanë filluar të pushtojmë rendin ditor të ummetit, veçanërisht pas periudhës së Tabiinëve, gjithmonë kanë mbetur pakicë, pikërisht siç kanë qenë edhe në periudhën kur janë shfaqur. Ato vazhdimisht janë përvetësuar, mbrojtur dhe nxjerrë në pah nga grupe margjinale. Kjo prirje, për të cilën na ka paralajmëruar i Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të, në hadithin fisnik, ka dalë në pah shumë pak kohë pas vdekjes së tij. Lufta e atyre që e mbrojnë Sunetin me ata që e mohojnë, e ka shfaqur veten e saj në skenën e historisë duke filluar që nga periudha pas Tabiinëve.

Ngjarja e mëposhtme është mjaft interesante si shembull për këtë çështje: Hasan el-Basriu transmeton se një herë kur Imran ibn Husejni po fliste në lidhje me Sunetin e të Dërguarit të Allahut, (a.s.), një burrë i tha: "O Ebu Nuxhej! Na fol për Kuranin!" Nisur nga këto fjalë, Imran ibn Husejni i tha: "Ti dhe shokët e tu e lexoni Kuranin. A mund të më flasësh për namazin, për gjërat brenda namazit dhe për kufijtë e tij? A mund të më flasësh për zekatin e floririt, deveve, lopëve dhe të pasurive të tjera? Por kur nuk ishe ti, unë i shpjegova këto." Pastaj (Imrani) e vazhdoi fjalën: "I Dërguari i Allahut, (a.s.), na ka obliguar kështu në çështjen e zekatit." Atëherë burri i tha: "Ma shpjegove shumë qartë! Allahu të ruajt!" Hasan el-Basriu, i cili e tregon këtë ngjarje, ka thënë: "Ky burrë më në fund u bë prej fakihëve të myslimanëve." (Abdullah Ajdënllë, Përkthimi i Sunenu Darimi, Mukaddime fq. 47.)

Në shekullin e dytë hixhri, disa njerëz, edhe pse të paktë në numër, e mohuan Sunetin si argument dhe funksionin e tij juridik. Pas shekullit të dytë hixhri iu dha fund kësaj përçarjeje. Ndërsa tashmë po përballemi përsëri me të njëjtën fitne. Pra, e njëjta fitne është ringjallur me influencën e kolonializmit të Perëndimit. Në vendet islame, duke filluar që nga India, edhe pse me përmasa jo serioze, po rastisim në mentalitetin që synon nxjerrjen jashtë funksioni të Sunetit të të Dërguarit të Allahut, (a.s.). Ndërsa në vendin tonë, krahas kundërshtarëve të pjesshëm të Sunetit, gjenden edhe njerëz që e mohojnë plotësisht traditën profetike.[5] Ndërkohë Suneti i të Dërguarit të Allahut, (a.s.), teorikisht është shpjegim i Kuranit dhe praktikisht është zbatimi i këtij të fundit.[6]

5. Argumentet dhe debatet në lidhje me çështjen, Dr. Muhamed Mustafa el-A'zami. Ky shkrim është përkthyer nga Prof. Dr. Abdullah Ajdënllë dhe është marrë nga vepra me titull "Dirasat fi'l-hadithi'n-nebevi". Të njëjtën vepër e ka përkthyer edhe Dr. Nuri Topallogllu. Përveç të tjerash, në lidhje me rrjedhshmërinë historike të debateve për Sunetin, shik. Ebubekir Sifil, Kritika e mendimit Islam Modern, I, fq. 524-550.

6. Jusuf Kardavi, Metoda për ta kuptuar Sunetin, fq. 61.


Nisur nga këta që thamë, ne jemi të obliguar ta ndjekim Sunetin, i cili është komentimi universal i Kuranit Fisnik, dhe të veprojmë me dispozitat e sugjerimet që ka sjellë ai.

Përgjigjja e Kuranit Fisnik është shumë e qartë për këta njerëz dashakeqës që thonë, siç shprehet edhe hadithi: "Ne pasojmë vetëm atë që gjejmë në librin e Allahut", e që me këtë dëshirojnë të shkëpusin Allahun me të Dërguarin e tij: ***"Vërtet, ata që mohojnë Allahun dhe të dërguarit e Tij dhe dëshirojnë të ndajnë Allahun nga të dërguarit e Tij, duke thënë: "Ne disa i besojmë e disa nuk i besojmë" dhe duke dashur që kështu të zgjedhin një rrugë të ndërmjetme, pikërisht ata janë mohuesit e vërtetë. Ne kemi përgatitur dënim poshtërues për mohuesit."***[7]

Nga ana tjetër, bindja ndaj Allahut dhe bindja ndaj të Dërguarit të Tij, janë përmendur bashkë në Kuranin Fisnik: ***"Thuaju: "Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit!" Në qoftë se kthejnë shpinën,*** (dijeni se) ***Allahu, me të vërtetë, nuk i do jobesimtarët."***[8] Por, nëse dikush shprehet se i bindet Allahut Teala, por nuk i bindet Resulullahut, (a.s.), ajeti shprehet se ky veprim është qartazi kufër. Edhe në këto ajete Allahu Teala e ka përmendur veten bashkë me Pejgamberin, për sa i përket çështjes së bindjes: ***"Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit, për të shpresuar mëshirën*** (e Allahut)***."***[9] Allahu i lartësuar e ka konsideruar bindjen ndaj Pejgamberit (a.s.), si bindje ndaj Tij: ***"Kush i bindet të Dërguarit, i është bindur Allahut..."***[10]

Allahu Teala e ka konsideruar frytin e bindjes ndaj të Dërguarit të Allahut, (a.s.), si udhëzim, duke u shprehur: ***"Thuaj: "Bindjuni Allahut dhe bindjuni të Dërguarit!" Nëse shmangeni,*** (ta dini se) ***ai është përgjegjës për detyrën e tij, ndërsa ju për atë që jeni ngarkuar. E, nëse i bindeni atij, do të jeni në rrugën e drejtë, kurse i Dërguari është i detyruar vetëm që të përcjellë qartë*** (Mesazhin Hyjnor)***."***[11]

Zoti (xh.xh.), përsëri shprehet në lidhje me pasimin e të Dërguarit të Tij: ***"...Shkoni pas Tij, që të jeni në rrugën e drejtë!"***[12] Në të njëjtën mënyrë, Allahu i Madhëruar e ka konsideruar pasimin e Pejgamberit si kushtin për ta dashur



Suneti i të Dërguarit të Allahut, (a.s.), ngaqë është gjendja në praktikë e Kuranit Fisnik, përbën burimin e dytë bazë të Islamit, krahas Kuranit. Libri i Allahut Teala dhe Suneti i të Dërguarit të Allahut, (a.s.), si dy burime të pandashme, kanë mundësuar edhe formimin e strukturës shoqërore islame, por edhe vazhdimësinë e kësaj shoqëria, pa i humbur cilësitë.

Zotin dhe për të fituar faljen e Tij: ***"Thuaju*** (o Muhamed)***: "Nëse ju e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua, që Allahu do t'ju dojë dhe t'jua falë gjynahet! Allahu është Falës i Madh dhe Mëshirëplotë."***[13]

Allahu i Lartësuar i ka urdhëruar myslimanët që ta ndjekin të Dërguarin e Tij edhe në çështjet që ka urdhëruar dhe ndaluar Pejgamberi: ***"...Çfarëdo që t'ju japë i Dërguari, merreni atë, e çfarëdo që t'ju ndalojë, hiqni dorë prej saj. Frikësojuni Allahut, sepse Allahu, dënon vërtet ashpër."***[14] Pastaj na ka pafraljmaëruar që të mos e kundërshtojmë Pejgamberin, duke u shprehur: ***"Le të frikësohen ata që kundërshtojnë urdhrin e tij, që të mos i arrijë ndonjë sprovë ose që të mos i godasë një dënim i dhembshëm."***[15]

Përsëri Allahu Teala në Kuranin Fisnik i ka urdhëruar besimtarët që t'i përgjigjen thirrjes së të Dërguarit të Tij dhe çështjen në të cilën thërret i Dërguari e ka quajtur "jetë".[16] Përveç të tjerash, Kurani Famëlartë ka shprehur me fjalë të qarta se myslimanët duhet t'i drejtohen të Dërguarit të Allahut, (a.s.), kur të kenë mosmarrëveshje ndërmjet tyre[17], se asnjë besimtari burrë apo grua qoftë, nuk i është dhënë e drejta për të zgjedhur nëse dëshiron apo jo që ta pranojë gjykimin e Pejgamberit (a.s.)[18], se nuk mund të jetë besimtar ai që nuk e pranon të Dërguarin e Allahut, (a.s.),

7. Nisa, 4/150-151.
8. Al Imran, 3/32.
9. Al Imran, 3/132; Nisa, 4/13; Nur, 24/51.
10. Nisa, 4/80.
11. Nur, 24/54.
12. A'raf, 7/158.
13. Al Imran, 3/31.
14. Hashr, 59/7.
15. Nur, 24/63.
16. Enfal, 8/24.
17. Nisa, 4/59.
18. Ahzab, 33/36.



si gjykues, apo që nuk e pranon me nënshtrim gjykimin e tij[19], dhe se pranimi apo kundërshtimi i gjykimit të të Dërguarit të Allahut, (a.s.), është guri i kufirit që ndan besimin nga hipokrizia[20].

Ndërkohë që e vërteta është e tillë, edhe në ditët e sotme, si në çdo periudhë tjetër, kanë dalë disa njerëz që e refuzojnë Sunetin me komentime të pabaza, duke mos u dhënë rëndësi këtyre ajeteve dhe shumë ajeteve të tjera të ngjashme me to.[21] Ky hadith fisnik, që shpjeguesi i Tirmidhiut, Mubarekfuri, e ka cilësuar si "Delailu'n-Nubuvvet"[22], këtë çështje e ka shpjeguar në një mënyrë shumë ndikuese dhe të qartë, duke i urdhëruar besimtarët që të mos kaplohen nga këto devijime djallëzore që janë pjesë e sprovës, dhe ta sistemojnë jetën e tyre sipas Sunetit të të Dërguarit të Allahut, (a.s.). Mbi të gjitha, hadithi e shpreh qartë se në themelin e daljes kundër Sunetit gjenden vrazhdësia, ashpërsia, pasimi i nefsit, pëlqimi i vetes dhe ndjenja e të mos pasurit nevojë për Zotin. Ndërsa me shprehjen "i mbështetur në kolltuk", hadithi nënkupton se ky veprim është i pahijshëm dhe larg edukatës së myslimanit[23], dhe është një shenjë e qartë që tregon se këto lloj veprimesh mund të bëhen vetëm nga njerëz që kanë mirëqenie të lartë. Edhe ajeti fisnik i Allahut Teala, në lidhje me këtë çështje, është shumë domethënës: ***"Por vërtet që njeriu shkel çdo cak kur mendon se është i vetëmjaftueshëm."***[24] Gjithashtu, shprehja mund të tregojë se këta njerëz do ta sulmojnë Sunetin duke u mbështetur te forca dhe fuqia e pushtetit.

Njerëzit që dëshirojnë të përfitojnë sa më shumë nga klasa sunduese/udhëheqëse, duke e sulmuar Islamin, ndërkohë që shfaqen sikur janë pro Kuranit Fisnik, duhet të njoftohen në lidhje me këto paralajmërime hyjnore: ***"O ju që keni besuar! Mos nxitoni para (urdhrit të) Allahut dhe të Dërguarit të Tij dhe kijeni frikë Allahun! Vërtet, Allahu dëgjon gjithçka dhe është i Gjithëdijshëm."***[25] Dhe: ***"O ju që keni besuar! Mos e ngrini zërin tuaj mbi zërin e Profetit dhe mos i flisni atij me zë të lartë, siç bëni me njëritjetrin, në mënyrë që të mos ju humbin veprat tuaja pa e ndier ju fare."***[26]

Përveç të tjerash, shprehja "i mbështetur në kolltuk" mund të nënkuptojë edhe një njeri, të cilit nuk i ka mbetur fuqi të merret me punë të dobishme, dhe për këtë arsye merret me punë boshe. Kjo mund të jetë një shprehje plot urtësi që tregon se veprime të tilla janë krejt të pakuptimta.

Thënia: "Ne marrim çfarëdo që gjejmë në Kuran. Përveç tij nuk pranojmë gjë tjetër.", është veçse një sjellje e gabuar, që e kanë pranuar ata që ndjekin dëshirat vetjake dhe që dëshirojnë të fitojnë vlerësimin e personave të cilëve u shërbejnë, duke e lënë mënjanë personin që është vërtet autoriteti i cili mund ta shpjegojë Kuranin, pra, të Dërguarin e Allahut, (a.s.). Për këtë arsye, nefset e tërbuara të këtyre njerëzve do arrijnë nivelet e nefseve të politeistët të Mekës, që talleshin duke thënë: "Le të na vijë shpallja edhe neve!" Kështu që kuptohet qartë se ata dëshirojnë të thonë: "Tashmë e kemi radhën ne.", sikur Suneti i të Dërguarit të Allahut të ishte i kufizuar në kohë. Poshtërsia e të gjitha këtyre veprimeve dhe mendimeve, është parashikuar krejt qartë nga goja e bekuar e të Dërguarit Allahut, (a.s.). Prandaj, absolutisht nuk mund të mendohet një Islam pa Sunet.

Shkrimin tonë le ta përfundojmë me këtë fjalë kuptimplotë të Omerit (r.a.): "Ne jemi të kënaqur që Allahu është Zoti ynë, Islami është feja jonë dhe Muhamedi (a.s.) është Pejgamberi ynë."[27]

19. Nisa, 4/65.
20. Nur, 24/47,48,51.
21. Xhanan Ibrahim, Kutubu's-Sitteh, vëllimi i 16-të, fq. 461.
22. Tuhfetu'l-Ahvezi, VII, 425.
23. Ismail Lutfi Çakan, Të vërteta me hadithe, 2, fq. 138.
24. Alak, 96/6-7.
25. Huxhurat, 49/1.
26. Huxhurat, 49/2.
27. Nisa, 4/65; Nur, 24/47-50; Buhari, Ilm, 26; Deavat, 34; Fiten, 15; I'tisim, 3; Muslim, Iman, 56; Tirmidhi, Ilm, 10.

AKUMULIMI I SEVAPEVE
nga e sotmja për të nesërmen

Raif Koçak



Njeriu i shekullit tonë tashmë nuk hedh asnjë hap pa marrë shpërblim për të. Sado e vogël të jetë ajo që mund të japë, patjetër kërkon ta shndërrojë në interes dhe fitim. Mendimet moderne e kanë drejtuar njeriun deri në gjendjen që të zvarritet në batakun e kamatës, e cila është e ndaluar në fe, për të plotësuar nevojat, ngaqë nuk mund të marrë ndihmë materiale nga të afërmit, nëse e kërkon.

Ajo që nuk mundet ta pranojë në asnjë mënyrë mendja e njeriut modern, është dhënia apo dhurimi, pa pritur shpërblim. Sipas mendjes moderne, nëse investoni njëqind mijë lekë diku, patjetër duhet të fitoni dyqind mijë lekë nga ky investim. Nëse jepni ndonjë gjë pa pritur shpërblim apo pa siguruar ndonjë interes material, konsideroheni budalla sipas shoqërisë moderne.



Gjërat për të cilat folëm janë produkt i një botëkuptimi, i cili asnjëherë nuk mund të përputhet me mendimet tona. Feja islame, në të cilën mendohet vëllai para vetes dhe ndihma reciproke e solidariteti konsiderohen ibadet, përbën një institucion krejt të ndryshëm nga ai "moderni" që sqaruam më lart. Ky është institucioni i "infakut" që do të thotë: "Të harxhosh në rrugë të Allahut (xh.xh.), të ushqesh dikë dhe t'i japësh diçka për të vazhduar jetesën."

Sipas Islamit, e gjithë pasuria që gjendet në këtë botë, i përket Allahut (xh.sh.). Njeriu jeton në këtë botë, i përdor këto pasuri, i harxhon ato për të jetuar dhe pasi t'i mbarojë jeta kalon në botën e përtejme, duke ia lënë radhën në përdorim dikujt tjetër. Disa prej njerëzve iu është dhënë pasuri, disa janë lënë në varfëri, disa janë krijuar të shëndetshëm dhe disa të tjerë janë të sëmurë apo me të meta. Domethënë, njerëzit si domosdoshmëri e natyrshmërisë së tyre, janë krijuar nevojtarë për njëri-tjetrin.

Njerëzit sprovohen me dije, shëndet, pasuri, mundësi të mëdha, fëmijë dhe familje. Njeriu që është bekuar me pasuri, është ballë për ballë me sprovën e ndarjes së saj me të tjerët. Ndërsa njeriu që nuk është begatuar me të, është ballë për ballë me sprovën për të siguruar jetesën duke punuar dhe duruar. Allahu Teala na urdhëron që këto mirësi t'i ndajmë me nevojtarët dhe ata që kemi nën përkujdesje, duke u shprehur:

"O ju që keni besuar! Jepni pa u kursyer nga të mirat që ju kemi dhënë Ne, para se të vijë Dita (e Gjykimit) në të cilën nuk ka shit-blerje, as miqësi, as ndërmjetësi!.." (Bakara, 254.)

"O ju që keni besuar! Jepni pa u kursyer nga të mirat që keni fituar dhe nga ato që jua kemi nxjerrë Ne nga frytet e tokës. Mos dhuroni nga ato gjëra të pavlefshme të pasurisë suaj e të cilat ju nuk do t'i pranonit ndryshe veçse symbyllur. Ta dini se Allahu është i Vetëmjaftueshëm dhe i Denjë për çdo lëvdatë." (Bakara, 267.)

Kjo botë është fusha e sprovës. Në botën tjetër nuk mundemi të marrim me vete asgjë. Atje mund të shkojmë vetëm me veprat që kemi kryer në këtë botë. Gjithçka që posedojmë në këtë botë, do t'u

ngelet trashëgimtarëve tanë, kur të ndërrojmë jetë. Njerëzit e urtë kanë thënë: "Kur njeriu të vdesë, do të përballet me dy fatkeqësi, për sa i përket pasurisë. Robi asnjëherë nuk ka parë fatkeqësi të tilla. Fatkeqësia e parë është marrja e të gjithë pasurisë. Ndërsa fatkeqësia e dytë është marrja në llogari për pasurinë, edhe pse ajo i merret e tëra."

Ndërsa i Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të, për të shprehur mirësinë e dhënies për hir të Allahut, ka thënë: *"Çdo mëngjes zbresin dy engjëj. Njëri prej tyre lutet duke thënë: O Zot! Jepi atij që jep në emrin Tënd! Ndërsa tjetri lutet duke thënë: O Zot! Shkatërroja pasurinë atij që është koprrac!"* (Buhari, Zekat, 27; Muslim, Zekat, 57.)

Nëse do t'i hedhim një vështrim natyrës, do të vërejmë qindra shembuj për mirësitë që na janë dhënë. Madje na janë dhënë mirësi më shumë seç kemi nevojë. Bletët bëjnë mjaltë më shumë seç kanë nevojë dhe na e japin ne. Pemët na japin fruta pa masë. Ndërkohë që për mbirjen e një fidani, mjafton edhe një farë e vetme.

Për pranimin e infakut, që është një adhurim financiar, ka disa kushte të vendosura nga Islami:

1. Infaku duhet të bëhet për kënaqësinë e Allahut të Lartësuar.

2. Pasuria që do të bëhet infak, duhet të jetë e fituar me mënyrë të lejuar.

3. Pasuria që do të bëhet infak, duhet të jetë prej pjesës më të mirë.

4. Njeriu që do të bëjë infak, duhet ta dije se në pasurinë që posedon kanë të drejtë edhe shoqëria, sidomos të varfrit. Prandaj, nuk duhet t'i mburret askujt.

5. Nevojtarëve duhet t'u jepet infakunë kohën e nevojës.

6. Infaku duhet të bëhet kur njeriu të jetë mirë me shëndet.

7. Infaku duhet të bëhet sipas mundësisë.

8. Infaku duhet të bëhet fshehurazi.

9. Në infak nuk duhet të ketë nxitim.

10. Prej infakut nuk duhet të pritet shpërblim.

11. Infaku nuk duhet të kthehet mbrapa.

12. Infaku duhet të bëhet duke përmendur emrin e Allahut Teala dhe t'i jepet atij që e kërkon. (Morali i Lartë Islam, MustafaBilgen, fq. 353-354.)

Nëse do t'u hedhim një vështrim periudhave kur institucioni i infakut ka funksionuar me plot kuptimin e fjalës, në civilizimin Islam, do të vëmë re ndihmë të ndërsjelltë dhe solidaritet të shkëlqyer ndërmjet njerëzve në shoqëri. Shumë vepra si xhamitë, medresetë, urat, shtëpitë për të pastrehët, mensat, çezmat dhe kanalet vaditëse, që i kanë ndërtuar gjyshërit tanë dhe që ne nuk mund t'i numërojmë dot, vëmë re se janë bërë prej kulturës së infakut. Në të njëjtën kohë, këto vepra që konsiderohen "sadakatun xharijeh/lëmoshë e vazhdueshme", e vazhdojnë shërbimin e tyre edhe pasi ndërtuesit e tyre ndërrojnë jetë. Në këtë mënyrë, bëhen shkak për shkrimin e sevapeve vazhdimisht në librin e veprave të tyre.

"Çdo mëngjes zbresin dy engjëj. Njëri prej tyre lutet duke thënë: O Zot! Jepi atij që jep në emrin Tënd! Ndërsa tjetri lutet duke thënë: O Zot! Shkatërroja pasurinë atij që është koprrac!"

(Buhari, Zekat, 27; Muslim, Zekat, 57.)



Kur bëjmë infak, numri nuk ka shumë rëndësi. Nëse ka nijet të mirë ai që e bën infakun, shpesh herë ky infak ua kalon veprave që mund të jenë shumë më të mëdha. Për sa i përket kësaj çështjeje, i Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë: *"Një dirhem i ka kaluar njëqind dirhemë."* Kur sahabët e nderuar e pyetën: "Si ka mundësi, o i Dërguari i Allahut?" Pejgamberi (a.s.) iu dha këtë përgjigje:*"Një burrë kishte dy dirhemë. Njërin prej këtyre, që ishte më i mirë, e dha për hir të Allahut*. (Domethënë dhuroi gjysmën e pasurisë së tij.) *Ndërsa* (burri tjetër ishte shumë i pasur). *Ai shkoi te pasuria, mori njëqind dirhemë dhe i dhuroi për hir të Allahut."* (Nesai, Zekat, 49.)

Besimtari, qoftë i pasur apo i varfër, bën nijet në një formë të sinqertë për çdo gjë. Nëse dëshiron, patjetër që mund të gjejë diçka për ta dhënë në emër të Allahut Teala. Bazuar në mundësitë që ka, ai mund të bëjë infak nga pasuria, koha, fuqia, dija, aftësia, arti, gjuha, zemra dhe lutjet e tij. Njeriu nuk duhet të harrojë se çdo infak i bërë për hir të Allahut (xh. sh.), në Ahiret do të jetë ushqimi/sevapi ynë dhe do t'i shërbejë lumturisë sonë të përhershme.

Paqja e Zotit qoftë mbi ata që akumulojnë ushqime/sevape nga ditët e sotme për të nesërmen, duke e bërë natën ditë!



Koha për të JETUAR ESENCËN e Islamit

Rabia Brodbeck

Ne jemi fëmijët e Habilit që ka rënë dëshmor. Ne e kemi për borxh ta tregojmë miqësinë tonë ndaj tij, për hir të gjakut që derdhi dhe dashurisë që shfaqi. Ne jemi nipërit e Ibrahimit (a.s.), i cili hodhi themelet e shtëpisë së tevhidit të Krijuesit të Gjithësisë. Ne jemi fëmijët e Ademit (a.s.). Ne jemi ndjekësit e pluhurit të këmbëve të të Dërguarit të Allahut, (a.s.). Ne jemi ndjekësit e mesazhit: ***"Ty të adhurojmë dhe vetëm prej teje ndihmë kërkojmë."*** Ne jemi mbartësit e amanetit Hyjnor. Prandaj, ne u kemi borxh atyre që kanë rënë dëshmorë në rrugë të Allahut dhe e kemi për borxh që të ndjekim gjurmët e tyre. Ata e kanë dhënë jetën e tyre, që ne të shohim, të zgjohemi, të kuptojmë dhe të gjejmë dritën e udhëzimit nga urtësia e Kuranit Fisnik. Ne ia kemi borxh Allahut (xh.xh.), që të mos kemi frikë nga vdekja dhe të ecim në rrugën e të vërtetës, duke i zbatuar detyrat që kemi ndaj Tij. Le të trashëgojmë qoftë edhe pak fare prej fuqisë së rezistencës që kishte në zemër Husejni (r.a.). Le të trashëgojmë qoftë edhe pak nga dashuria e Ismailit (a.s.), për nënshtrim ndaj Zotit, nga fuqia e trimërisë së Hamzait (r.a.), nga fuqia e Jusufit (a.s.), për të duruar kundrejt sprovave, dhe nga sinqeriteti i Aliut (r.a.), i cili u shtri dhe fjeti në shtratin e të Dërguarit të Allahut, (a.s.).

Le ta drejtojmë veten nga përhershmëria, nga tevhidi që na

jep nder, dhe nga Allahu Teala. Ne kemi ardhur në këtë botë për të përjetuar dashurinë Hyjnore, për të bërë miraxhin, për të rënë dëshmorë, për të fituar kënaqësinë e Zotit (xh.xh.), për të fituar Xhenetin dhe për të fituar Jetën e Përhershme. Ne kemi ardhur në këtë botë për të perceptuar nevojën për tevhidin dhe për esencën e Islamit. Ne kemi ardhur në këtë botë për të marrë këshilla nga ata që e kanë arritur pozitën e martirëve, për ta flijuar jetën për Atë që na e ka dhënë dhe për të vdekur me të njëjtën pastërti që kemi ardhur. Ne kemi ardhur në këtë botë për të arritur identitetin e vërtetë prej njeriu dhe për të jetuar të vërtetën e fjalës së shehadetit. Ne kemi ardhur në këtë botë për të mbartur amanetin Hyjnor, për të fituar dritën Hyjnore, për të flijuar çdo dashuri që nuk është për Allahun Teala dhe për të mbajtur premtimin tonë "Po", që e kemi dhënë në "Kalu Bela". Ne kemi ardhur në këtë botë për të ndjekur të Dërguarin e Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të. Ne kemi ardhur në këtë botë për të thënë të gjithë së bashku me një gojë: "Nëna, babai, fëmijët, pasuria, pronat dhe jeta ime të qofshin falë, o i Dërguari i Allahut!" Ne kemi ardhur në këtë botë për t'u bërë ummet i Muhamedit (a.s.). Ne kemi ardhur në këtë botë për ta pasuar të Dërguarin e Allahut, (a.s.).

Prandaj duhet të rendim pas të vërtetës. Ndër të tjera duhet të mësojmë të duam pa kushte. Duhet të shpëtojmë nga frika e humbjes dhe vdekjes. Ne duhet të specializohemi në artin e dhënies. Kur jetojmë, edhe duam. Kur duam, edhe japim. Prandaj nuk duhet të kaplohemi nga virusi i interesave vetjake dhe duhet të mësojmë të derdhim lot. Duhet të mësojmë artin e afrimit ndaj të tjerëve. Duhet të mësojmë t'i thyejmë idhujt në zemër. Duhet të mësojmë ta zbusim zemrën. Duhet të specializohemi në profesionin e dashurisë. Duhet të mësojmë artin e heshtjes. Rumiu thotë: "Mbylle derën e fjalës dhe hape derën e zemrës. Hëna do të të puthë nga dritarja."

Ne duhet të fitojmë dritën dhe Dashurinë Hyjnore. Duhet të përpiqemi të shohim me syrin e nevojës, e jo me syrin e epshit dhe pangopësisë. Duhet të përpiqemi ta përvetësojmë fenë dhe duhet ta lëmë kërkimin e përgjigjes. Duhet të përballemi me veten tonë dhe duhet të largohemi nga padrejtësia. Veten tonë nuk duhet ta humbasim dhe jetën tonë duhet t'ia kushtojmë Islamit. Njerëzit duhet t'i mbrojmë, por jo t'i shfrytëzojmë. Ne nuk duhet të marrim prej njerëzve, por duhet të kërkojmë prej Zotit (xh.xh.). Asnjëherë nuk duhet të konsumohemi dhe gjithmonë duhet të prodhojmë. Asnjëherë nuk duhet të jemi mendjemëdhenj. Gjithmonë duhet të jemi të gatshëm për t'u flijuar për Allahun Teala. Nuk duhet të shohim prapa dhe nuk duhet të humbasim. Hz. Mevlana thotë: "Zgjohu dhe shiko, o ti që je si një pikë! Bëje kurban veten pa hezituar, në mënyrë që të blesh një oqean në shkëmbim të një pike!" Ne duhet të marrim nga Allahu dhe t'u japim njerëzve. Në të vërtetë, përse të mos ua japim njerëzve atë që është e Allahut? Të mëdhenjtë tanë nuk kanë bërë rehat pa i dhënë të gjitha. Ndërsa ne nuk bëjmë rehat pa i marrë të gjitha.

Në këtë botë kemi nevojë për një nijet të pastër dhe të sinqertë. Nijeti është vetë jeta. Të dhënët për hir të Zotit tregon gjendjen shpirtërore të mirë. Sexhdeja është burim i frymëzimit. Namazi është drita e syve tanë. Agjërimi i zemrës është kënaqësi. Tradita e të Dërguarit të Allahut, (a.s.), është dashuri. Allahu i Lartësuar na bën thirrje që ta shohim bukurinë e përhershme të thesareve të krijimit. Allahu na fton te admirimi, dashuria dhe frymëzimi hyjnor.

Duhet të kuptojmë sa kemi nevojë për dritën e Tevhidit. Të vërtetën e shehadetit duhet ta shndërrojmë në stil të jetës. Meditimi dhe dashuria na mundësojnë të jetojmë esencën e Islamit. Dashuria për bindje, besim, nënshtrim, xhihad, ibadet dhe infak, na bën të jetojmë esencën e Islamit. Lufta me nefsin, lufta me vetveten, shërimi nga sëmundjet shpirtërore dhe largimi nga çdo lloj belaje, injorance, shkujdesjeje, mungese vetëdijeje dhe lidhjeje materiale, na mundësojnë të jetojmë esencën e Islamit. Nëse shpëtojmë nga një jetë e ngujuar brenda katër mureve dhe zhytemi në shkretëtirën e ekzistencës, për të jetuar urtësinë e ajeteve hyjnore, do të kemi mundësi të jetojmë esencën e Islamit.

Tashmë ka ardhur koha për t'u strehuar te mëshira e Zotit të botëve dhe për të pasuar atë që është dërguar mëshirë për botët. Tashmë ka ardhur koha për t'i perceptuar mirësitë e pafundme që Allahu i Madhëruar ia ka dhënë ummetit të Muhamedit (a.s.). Tashmë ka ardhur koha për të ndjekur gjurmët e atij që e ka jetuar Kuranin Fisnik. Tashmë ka ardhur koha për të jetuar të vërtetën e shehadetit.



Ti je XHENETI IM

Halime Demireshik

Filluan të ecnin në heshtje. Mësuesja Saxhide u tremb nga qetësia e Amines. A mos vallë nuk kishte dëshirë të vinte? A ishte duke u shpejtuar, a ishte duke i bërë presion? Ajo e këshillonte pa pushim Aminen. Mos vallë vajza kishte filluar ta ndjente veten mëkatare dhe të pa vlerë? Nuk duroi më dhe tha:

"E dashur Amina, sikur je ftohur pak. Unë të flas pa pushim dhe si duket të kam mërzitur..."

"Jo, jo!.. Unë isha duke menduar. Më keni thënë që jeta është e mbushur me surpriza... Teksa po ecim, sytë e mi fiksojnë vitrinat shumëngjyrëshe të dyqaneve, por mendja më rri tek personi që po shkojmë të takojmë! Jam duke u përpjekur që të mendoj për surprizat që na bën jeta. Sa shpejt ndryshojnë gjërat. Njerëzit që mendoja se i njihja më kanë dalë shumë ndryshe nga pretendimet e mia. Motër Saxhide, si është njohur shoqja juaj me zonjën Zylejha?"

"Ajo është njohur me anën e një mësueseje, të cilën e vlerëson shumë. Mësuesja i paska thënë që të shkonte të njihej me të dhe t'i kërkonte duanë e saj... Me anë të asaj shoqes u njoha edhe unë me Zylejhanë... Shtëpia e saj është e mbushur me njerëz të cilët kanë probleme dhe gjejnë ngushëllim tek fjalët e Zylejhasë... Allahu i ka larguar disa perde asaj dhe e ka lartësuar në botën e shpirtit... Zylejhaja merr letra edhe nga burgu dhe u jep përgjigje atyre letrave. I këshillon që të pendohen dhe të kthehen në rrugën e drejtë. Njerëz me profesione shumë të ndryshme e vizitojnë dhe i kërkojnë që të bëjë dua për to."

"Jam bërë shumë kureshtare!"

"Pas pak do ta shuash kureshtjen, mbërritëm."

I ranë ziles. Një grua me fytyrë të qeshur u doli tek dera dhe i ftoi të futeshin brenda në shtëpi.

Hynë brenda një shtëpie të vogël, përballë derës ndodhej një dhomë e vogël... Nën dritare kishte një shtrat dhe e mbuluar me batanije të gjelbër po buzëqeshte një vajzë e dobët... Një njeri i cili nuk e dinte që Zylejhaja ishte e paralizuar, mund të mendonte se dobësia që kishte i vinte nga ndonjë grip apo ndonjë sëmundje tjetër e lehtë; buzëqeshja e saj nuk të linte të kuptoje një vuajtje aq të madhe. Si mund të ishte kaq i lumtur një njeri që kishte njëzet e shtatë vite e paralizuar?! Me një zë të ëmbël tha:

"Kush paska ardhur, hajde e dashur Saxhide! Më paska marrë malli shumë për ty..."

Mësuesja Saxhide iu përgjigj:

"Edhe mua më ka marr malli e dashur Zylejha! Ju kam sjell një shoqen time, Amina..."

"Hajde bukuroshe, paske emër shumë të bukur!"

Amina u përkul për t'ia puthur dorën. Kur iu afrua e vuri re që gishtat e dorës të Zylejhasë ishin të kthyer nga brenda. Duart ia kishin lidhur me kordele të vogla shumëngjyrëshe, në mënyrë që të mos deformoheshin plotësisht... Amina u habit dhe nuk dinte se çfarë të bënte. Zonja Zylejha i tha:

"Ato janë unazat e mia të fejesës, a u habite? Hajde të të puth!.."

Amina e përqafoi. Zylejhaja mbante një erë shumë të mirë. Aminës i erdhi në mend një kushërirë e veta që ishte e paralizuar, ajo mbante erë ilaçesh dhe ankohej gjatë gjithë kohës. Ajo nuk i lejonte që ta preknin, jo më ta përqafonin. Një sëmundje e njëjtë, por dy mënyra krejt të ndryshme sjell-

jesh...

Zylejhaja filloi të fliste përsëri me zërin e saj të ëmbël:

"Uluni përballë meje, sepse kam dëshirë që t'ju shikoj sytë. Natën kur jam duke bërë dua gjithmonë më vijnë në mendje sytë dhe mendoj: 'O Allahu im, je Ti ai që m'i kujton sytë; kjo do të thotë që dëshiron t'ua plotësosh dëshirën e zemrës së tyre dhe kërkon që unë të bëj dua për ta.'

Mësuesja Saxhide dhe Amina u ulën tek kanepeja që ndodhej tek këmbët e shtratit. Sa kishin filluar të bisedonin, kur ra zilja. Zonja Zylejha tha:

"Do të jenë vajzat nga gjimnazi, që kishin dëshirë të vinin për vizitë..."

Në dhomë u futën rreth njëzet veta të moshës 17-18 vjeçe. Teksa Amina po mendonte se si do t'i nxinte të gjithë ato njerëz një dhomë aq e vogël, Zylejhaja interesohej për secilën prej tyre, i pyeste për emrat dhe i përqafonte me radhë. Pas përshëndetjes vajzat u ulën. Dukej qartë se edhe ato vinin për herë të parë. Amina po qëndronte në qetësi duke ndjekur zhvillimin e ngjarjes.

Zonja Zylejha pyeti :

"Ju falënderoj shumë që erdhët të më vizitoni. Sa të bukura që jeni, Allahu ju paska krijuar të gjithave shumë të bukura! Për çfarë keni dëshirë që t'ju flas?"

Njëra nga vajzat iu përgjigj me zë të ultë:

"E dashur Zylejha, një mësuesja jonë na ka folur për ju. Sa vjeçe keni qenë kur ju ka ndodhur aksidenti, si ia arritët ta përballoni? Si e keni gjetur çelësin e lumturisë?"

Zonja Zylejha i dha këtë përgjigje:

"Kur isha shtatëmbëdhjetë vjeçe pata një aksident, si rezultat i të cilit u paralizova nga qafa e poshtë. Nuk kam qejf të flas për këtë gjë, sepse mund t'u shkaktoj mërzi njerëzve të tjerë, pasi shkaktari i atij aksidenti ishte një fëmijë i vogël. Në fakt duhet të them që ai ishte mjeti, sepse sigurisht që ky ishte një caktim i Zotit!.. E ardhmja ime ishte e përcaktuar të ishte e tillë dhe që kjo të përmbushej dikush duhet të bëhej shkak, prandaj ai fëmijë i vogël nuk duhet të ndjejë faj!.. Sikur të mos ishte ai, do të ishte një njeri tjetër. Le të themi që ky ishte vetëm një aksident, për më tepër që unë nuk dua që dikush të mërzitet për fajin tim. Duhet ta kuptojmë që fati ynë është shkruar që përpara lindjes sonë. Çdo gjë që na ndodh është për të mirën tonë. Allahu donte që unë të qëndroja në këtë shtrat dhe unë jam e kënaqur nga kjo gjendje.

Unë deri në momentin e aksidentit kam qenë një myslimane që bëja përpjekje për të ndjekur rregullat e fesë sonë, por pas atij çasti lindi një dashuri shumë e madhe mes meje dhe Allahut, jeta ime filloi të ishte më e bukur!..

Tetë vitet më të bukura të jetës sime i kalova në spital pa lëvizur. A është e mundur të qëndrosh në spital për tetë vjet? Vite që i kalova e shtrirë në një shtrat, pa lëvizur dhe me sytë që shihnin veç tavanin... Nuk mund të haja as ushqimet e mia të preferuara; duke qenë se rrija shtrirë gjatë gjithë kohës, asgjë nuk më kalonte në stomak.

Në qoftë se doni ta kuptoni më mirë gjendjen e teze Zylejhasë, kur të shkoni në shtëpi qëndroni shtrirë në një shtrat pa jastëk. Edhe nëse djersitni nuk mund të fshiheni, edhe nëse doni të kruheni nuk mund ta bëni dot... Nuk është diçka e lehtë! Është e çuditshme, por Allahu nuk bëri asnjëherë që unë të thosha: 'Pse unë jam këtu, pse më ndodhi mua?' Allahu nuk lejoi që unë të ankohesha duke thënë: 'Pse?!' Nuk po i them këto fjalë që ju të ndjeni mëshirë për mua, por mendoj që duhet dikush të qëndrojë i shtrirë, në mënyrë që të tjerët ta marrin shembull dhe të jenë falënderues!

Duaja ime e përhershme ishte kjo:

'O Allahu im, unë jam duke qëndruar e shtrirë; të lutem bëj që dikush të më shikojë dhe të jetë mirënjohës për gjendjen e vet!.. Unë nuk mund të bëj asgjë për Ty, por të paktën le të jem shkak që njerëzit e tjerë të falënderojnë Ty!'

Motra ime më thotë gjithmonë: "Gjatë gjithë jetës ti ke dhënë." Ajo është një ndjenjë shumë e bukur, le të japim gjithmonë për hir të Allahut.

Si rezultat i këtij aksidenti, unë përfitova shumë gjëra pozitive. Një ditë doktori im i vendosi raftet e vogla njëra mbi tjetrën. E çuditur e pyeta:

"Çfarë po bëni?"

"Ti do të jesh mërzitur shumë, prandaj po të vendos një televizion mbi këto rafte."

Ai po e bënte atë gjë për të mirën time, që të kaloja kohën duke shikuar televizion.

"Nuk ka nevojë."- i thashë. Me të vërtetë që nuk ishte aspak e nevojshme, sepse mua më mjaftonin pamjet që më afronte Zoti im. Në momentin kur i nënshtrohesh përcaktimit të Zotit, Ai ju ofron gjëra pa fund. Zylejhaja ishte gati të jepte gjithçka për të përfituar nga këto të mira. Sikur ju të ishit në vendit tim dhe të shikonit ato që shikoj unë, nuk do ta ndryshoni as botën me këtë bekim. Allahu bëri që unë të edukoj egon time. Kur isha në spital e besoja se isha bërë me të vërtetë një besimtare e devotshme. Kam qëndruar me sy që fiksonin tavanin me muaj të tërë. Njerëzit mendonin se unë isha vetëm duke shikuar tavanin. Po ju them me sinqeritetin më të madh se kur zemra e njeriut është bashkë me Zotin dhe e kalon gjithë jetën duke e kujtuar Atë; në një tavan të thjeshtë mund të shikohen gjëra nga më të bukurat që një njeri i

thjeshtë nuk është në gjendje as t'i imagjinojë. Ah sikur ta gjeja edhe një herë atë tavan...

Çfarë mësuam nga kjo ngjarje; mësuam që të bëjmë durim dhe na tregoi se sa vlerë kanë gjërat që fitojmë si dëmshpërblim i atyre që humbasim. Unë gjithashtu kuptova rëndësinë e madhe të duarve dhe të këmbëve.

Disa ditë më përpara një mysafire më tha:

"Ne kemi një shtëpi me pamje nga deti. Është shumë e bukur dhe kemi dëshirë që t'jua bëjmë dhuratë. Ajo është shtëpi goxha e madhe dhe mund të prisni më shumë njerëz!"

Unë thashë:

"Allahu im, çfarë po kërkon t'i thuash Zylejhasë? A mos do të thuash që tashmë nuk do të mund ta shikoj më Xhenetin? Prandaj dëshiron të më dhurosh mua një pamje me det? Unë nuk dua të ndahem nga Ti. Çfarë pune kam unë me detin? Unë të zgjedh Ty. Ti je Xheneti im, o Allah!"

Të gjitha mysafiret po e dëgjonin me sy të përlotur. Amina ishte emocionuar shumë. E dëgjonte dhe mendonte për gjendjen e saj; lotët i rrjedhin lumë. Donte të qante me zë të lartë por po përpiqej që ta zotëronte veten.

Një nga vajzat pyeti:

"Çfarë është Xheneti?"

Zonja Zylejha filloi t'i përgjigjej pyetjes dhe përsëri të gjithë po e dëgjonin me vëmendje:

"I kujt është Xheneti sipas jush? A e keni menduar se kush janë ata që mund të futen në Xhenet? A kemi të gjithë të drejtë që të futemi në Xhenet? Pse të marrim rrugën e Xhehenemit? Zoti ynë është shumë i mëshirshëm... Ai na ka dërguar një Libër të mrekullueshëm dhe na ka thënë që nëse i bëjmë disa gjëra dhe qëndrojmë larg disa gjërave të tjera, do të mund të futemi ne Xhenet. Nuk është mjaftuar me kaq. Duke qenë se Allahu na do, ka dërguar dhe një shembull të gjallë të rregullave që duhen ndjekur... Na ka dërguar njeriun e Vet më të dashur. Ju këshilloj që të lexoni sa më shumë libra që flasin për jetën e Resulullahut. Në një libër unë kam lexuar këtë fjali: 'Në jetën e Resulullahut ka pasur shumë luftëra.' Për mendimin tim kjo nuk e përshkruan mirë jetën e Resulullahut. Një pjesë e vogël e jetës së tij ka kaluar në luftë kurse pjesa tjetër e saj i ka kaluar duke qenë afër ymetin të vet... Ai ka qenë njeriu bujar që ka ndihmuar këdo që ka pasur nevojë për ndihmë... Ai ka qenë njeriu më i lartë dhe njeriu më i dashur i Allahut... Si çdo epokë tjetër edhe koha e Resulullahut ka pasur luftërat e veta... Në çdo kohë ka pasur dhe do të ketë njerëz të mirë dhe të këqij... Përpjekjet dhe diskutimet mes këtyre dy grupeve do të jenë gjithmonë aktuale. Për më tepër që njeriu është në një luftë të vazhdueshme me egon e vet... Në qoftë se dëshironi të jetoni si njerëz, duhet ta merrni si shembull Resulullahun në çdo aspekt!

Shembulli i Resulullahut është i përshtatshëm për të gjitha kohërat. Kur ndodhi Miraxhi, Pejgamberi ynë nuk bëri vetëm një udhëtim nga një vend në një tjetër; Ai bëri edhe një udhëtim në kohë... Ai i shikoi të gjitha kohërat... A mund ta mendoni madhështinë e kësaj? Të shikosh dhe të jetosh të gjitha kohërat, ato të kaluarat dhe ato që do të vijnë. Ai u takua me Allahun. Ne kemi një Pejgamber shumë të veçantë, qoftë falënderuar Allahu!

Kjo ishte ajo që më ka mbajtur në jetë! Do të gënjeja në qoftë se do të thosha që këto gjëra i kam lexuar nga librat, sepse unë nuk kisha duart që të mbaja librin... Sikur të më ndihmojë dikush, do të më bien syzet dhe do të kem shumë probleme të tjera prandaj është e vështirë. Unë nuk lexoj dot libra. Më mjaftojnë gjërat që m'i shfaq Allahu...

Çfarë pret Allahu përballë kësaj dhurate të madhe që na ka dhënë? A dëshiron Ai që të bëjmë përgatitje për Xhenet? A keni ndonjë mendim? Unë e kam shumë të vështirë që t'ju them që të falni namaz. Më duket sikur po ju fyej po t'ju them atë fjalë... Nuk mund t'ia them një gjë të tillë një njeriu besimtar që e dëgjon zërin e ezanit pesë herë në ditë!..

"Për kë këndon ezani?" A këndon për gjyshen dhe gjyshin tim?

Nuk ka asgjë më të keqe për një mysliman se mungesa e namazit në jetën e tij. Mendoni pak për gjërat me të cilën e harxhoni kohën tuaj para se të ankoheni se jeni shumë të zënë dhe nuk keni kohë...

Në qoftë se unë do të kërkoja diçka prej jush, diçka për të cilën kam shumë nevojë; a do të ma jepni? Në qoftë se ju them që më ka marr uria ose që kam etje; a do të më jepni ushqim apo ujë?

Duke thënë këto fjalë motër Zylejhaja qante me dënesë, lotët e saj i fshinte mësuesja Hatixhe, por dukej sikur nuk ia arrinte t'i fshinte të gjithë lotët e derdhura.

"Sikur t'ju them që kam nevojë për t'u larë a do të më ndihmoni? Po sikur t'ju kërkoja diçka për botën e përtejme? Sikur t'ju kërkoja t'i bënit këto gjëra pesë herë në ditë a do t'i bëni? Unë kam shumë nevojë për të reja si ju që të më ndihmojnë të shlyej mëkatet e mia... Ju do të dilni të fituara nga të gjitha këto, por do të shpërblehem edhe unë. A do të më ndihmoni që të shpërblehem? Unë e ndjej që ma dhatë fjalën. Lotët tuaja e tregojnë këtë gjë më së miri..."

Amina e kuptoi që edhe vajzat e tjera që po dëgjonin e falnin namazin ashtu si vetë ajo, pa përkushtimin e nevojshëm.

“Kam një kërkesë për vajzat që e falin namazin. A e dini cila është gjëja për të cilën ndjej më shumë mall? Më mungon sexhdja, më vjen shumë keq që tashmë nuk mund ta ul kokën për t’iu lutur Allahut... Vajza të dashura, në momentin kur koka juaj do të mbështetet në tokë a mund të thoni: ‘O Allah, le të jetë balli im, balli i motër Zylejhasë.’ A mund ta bëni për mua këtë gjë? Ju e keni shumë të lehtë që të arrini diçka që unë e kam të pamundur!.. Ju lutem mos e privoni veten nga kjo kënaqësi!, O Allah, të lutem më fal mua, sepse kjo nuk është ankesë por vetëm mall...’

Nuk kam mall për asgjë tjetër as për të ecur, as për të shëtitur, as për asgjë tjetër, unë ndjej vetëm mungesën e sexhdes.

Zonja Zylejha vazhdonte të qante pa pushim. Ajo fliste dhe nuk reshtte së derdhuri lot.

“Disa ditë më përpara shikova një ëndërr. Sa mirë që ekzistojnë ëndrrat, sepse nuk ka mënyrë tjetër për ta shikuar atë botë... Isha në një vend të cilit nuk mund t’i vendos asnjë përcaktim... Isha para Zotit tim. Shikoja nga ana e majtë dhe vëreja njerëz të njohur, hidhja sytë nga e djathta dhe shikimi im përsëri rastiste në njerëz të njohur... Kishte shumë njerëz dhe të gjithë së bashku ishim duke falur namaz. Mbizotëronte një qetësi e papërshkrueshme. A e keni parasysh lumturinë e faljes së namazit, edhe kjo ishte një ndjenjë e ngjashme. Mendoj se sikur ta perceptonim mirë se përpara kujt jemi duke qëndruar do të fitonim kënaqësi të pafund nga çdo namaz...”



Të gjitha vajzat e pranishme u zotuan se do të përmbushnin kërkesën e motrës Zylejha. Në dhomë mbizotëronte një atmosferë e veçantë dhe secila kishte humbur në një botë të re dhe të bukur.

Zonja Zylejha vazhdoi të fliste:

“Kemi qarë shumë, tani le të qeshim pak...”

Fjalët e saj ndërprenë ngashërimet e vajzave të cilat filluan të buzëqeshnin. Njëra nga ato i tha:

“Motër e dashur, ne u kënaqëm shumë nga kjo vizitë, a mund të vijmë edhe herë të tjera?”

“Sigurisht, bijat e mia. Mund të vini sa herë që të keni dëshirë.”

Një vajzë tjetër i tha:

“E dashur motër, a mund të bëjmë një fotografi me ju?”

Vajzat u larguan duke marrë si kujtim një fotografi të asaj dite aq të bukur.

Zonja Zylejha iu drejtua Aminës:

“Bija ime, ke qarë shumë; cili është problemi yt?”

Kur dëgjoi këto fjalë, Amina nuk mundi t’u bënte më ballë lotëve që i kishin mbetur në grykë. Vetëm qante pa mundur që të ndalohej. Motra Zylejha i tha:

“Qaj bija ime. Loti është ilaç. Qaj bija ime, sepse loti është mëshirë. Loti është shpresa për falje. Loti është shërim.”

Zylejhaja e ndryshoi tonin e zërit dhe vazhdoi:

“Vajza ime e bukur... Në jetën e çdo njeriu ka momente në të cilat ndodhet në vështirësi të madhe. Shumica e njerëzve në një çast të vështirë zgjedhin rrugën më të lehtë: rebelimin ndaj Allahut... Këta njerëz nuk e kuptojnë se puna më me mend që mund të bëhet në këtë rast është nxjerrja e mësimeve prej fatkeqësisë. Me sa po shoh, ti je një njeri që ke pasur shumë përvoja të këqija në jetë. Mos ki frikë, sepse të gjitha këto do të zhduken, sepse në këtë jetë asgjë nuk është e pafund. Pafundësia është diçka që i takon vetëm Allahut. Ti duhet të merakosesh vetëm për një gjë: mendo për mësimet dhe përvojat e mira që do të nxjerrësh nga fatkeqësia të cilën po e përjeton në këto momente!..”

Amina filloi të fliste me ndalesa:

“Motër Zylejha... Unë nuk shqetësohem për problemet e kësaj jete, un mërzitem për jetën time e cila po shkon bosh. E gjithë fëmijëria dhe rinia ime ka kaluar pa asnjë gjë të mirë. Kur shoqja ime më e mirë vdiq, unë u kujtova për vdekjen. Në atë moment unë u përballa me vërtetësinë e jetës. Në atë moment Allahu bëri të mundur takimin tim me motër Saxhiden. Ajo mbajti dorën time dhe më qëndroi pranë në çastet e mia më të vështira. Nuk pata nevojë të luftoja e vetme me problemet e mia. Nga njëra anë kisha familjen, shoqërinë dhe egon time që më ftonin në një rrugë të gabuar; nga ana tjetër kisha motër Saxhiden prej së cilës merrja forcë për t’i përballuar këto tundime. Në mësimet e saj gjeta trimëri dhe guxim. Tani Zoti më dha kënaqësinë që të njihem me ju. Nuk di se çfarë të them. Në qoftë se më jepni leje, dua të bëhem një nga shërbyeset tuaja.”

“Çfarë është ajo fjalë bija ime, si mund të bëhesh shërbyesja ime... Ti hajde për vizitë sa herë që të kesh dëshirë. Mund të qëndrosh këtu sa të duash, por nuk ke nevojë që të jesh shërbyesja ime, ti duhet të bëhesh shërbyesja e rrugës së drejtë. Në qoftë se vepron kështu, do të më lumturosh edhe mua.”



Fëmija dhe shoqëria

Tuba Sokmen

Miqtë tanë të vërtetë janë ata njerëz që vijnë të parët kur ne kemi nevojë... Ata janë pranë nesh kur qeshim edhe kur qajmë... Ata janë njerëzit për dashurinë e të cilëve jemi të bindur edhe kur janë larg nesh; edhe malli për ta është i bukur dhe i çmuar... Kur ua shtrijmë dorën për ndihmë, ata vijnë me vrap, pa pritur asgjë në këmbim... Jeta është më e bukur me ta; uji që pimë dhe buka që hamë janë më të ëmbla... Vetëm qenia e tyre na jep siguri...

Ndjenjat e bukura që kemi për miqtë tanë dhe themelet e miqësive tanë kanë lëshuar rrënjë që në moshë të vogël... Kur nënat kanë qëndruar me gratë e lagjes për të biseduar, edhe fëmijët e tyre kanë zënë shoqëri me njëri- tjetrin. Duhet ta kuptojmë që të gjitha rregullat që zbatojmë sot me shoqërinë tonë i kanë themelet tek loja shtëpiash dhe tek lojërat me top. Ne kemi mësuar t'i duam dhe t'i respektojmë shokët tanë kur vraponim pas një topi në lagje. Duke komunikuar me miqtë tanë kemi mësuar se çfarë është: e drejta, e gabuara dhe të gjitha rregullat e tjera të jetës.

Miqësia e fëmijëve të sotëm është pak e ngatërruar... Sa keq që kushtet e jetesës dhe ambienti shoqëror ndryshojnë shumë shpejt. Në kohët e sotme familjet janë zvogëluar, kurse njerëzit largohen gjithmonë e më shumë nga njëri-tjetri. Njerëzit janë të detyruar të punojnë më shumë dhe koha rrëshqet prej nesh ashtu siç ndodh me rërën kur e marrim në dorë. Në mes të kësaj jete aktive e kemi të vështirë të gjejmë kohë për miqtë tanë. Shumicën e kohës ne vetëm u telefonojmë kushërinjve dhe miqve tanë, në mënyrë që të mos harxhojmë kohë. Nuk e kuptojmë dot që në këtë mënyrë ne po i largojmë edhe fëmijët nga njëri-tjetri dhe nuk u japim atyre mundësi për të krijuar shoqëri të sigurt. Për fëmijët e sotëm argëtimi ka vetëm një kuptim: kompjuteri dhe televizioni... Edhe në ambientet e hapura, fëmijët preferojnë të luajnë me telefonat e prindërve, në vend që të vrapojnë pas njëri- tjetrit.

Duart e tyre të vogla dhe mendjet e tyre të pastra janë ndotur nga ekranet e mjeteve digjitale; këta fëmijë, që nuk e vëzhgojnë ambientin që i rrethon, kur të rriten si do të mund t'i kuptojnë ndjenjat e njerëzve? Si do ta kuptojnë gëzimin që të jep ndarja e gjërave me njerëzit e tjerë? Si do të mësojnë këta fëmijë: faljen, humbjen dhe fitoren? Fëmijë që nuk kanë eksperiencën e lojërave në grup, si do të mësojnë të bashkëpunojnë me kolegët e tyre në të ardhmen? Ndjenjat që u dhurohen nga lojërat në kompjuter a do të mund t'i përgatisin për jetën e vërtetë?

Mënyra e dëfrimit, miqësia e krijuar dhe lojërat janë ato që ndikojnë direkt në formimin e karakterit të një njeriu. Fatkeqësisht brezi i sotëm i



fëmijëve e kalon të gjithë fëmijërinë para ekranit të televizionit dhe nuk arrin të bëjë përgatitje për jetën e vërtetë. Një shkollim i mirë dhe ushqimi i mirë nuk janë të mjaftueshëm për edukimin e duhur të një fëmije!... Fëmija i cili nuk ka shokë me të cilët mund ta masë forcën e vet, nuk arrin ta kuptojë ndjenjën e suksesit. Një fëmijë të cilit i mjafton shtypja e një butoni për të filluar një lojë të re, nuk arrin ta mësojë as se çfarë është llastimi.

Për shkak të lojërave në kompjuter dhe zakonit të të shikuarit televizion, mësuesit në shkollë ankohen nga mungesa e vëmendjes së fëmijëve, kurse prindërit ankohen nga ndjenja e egoizmit që vihet re tek fëmijët.

Trupi i fëmijës, gjuha dhe mendja e tij zhvillohen njëlloj si ndjenjat, që nga lindja e fëmijëve. Për të arritur një zhvillim të rregullt dhe të ekuilibruar është e rëndësishme që të krijohen ambiente të duhura për fëmijët. Për shembull: një fëmijë i moshës tre vjeçare është gati për të mësuar të ndajë lojërat e veta me fëmijët e tjerë; por në qoftë se atij nuk i krijohen mundësitë për të qëndruar me fëmijë të tjerë do të vihet re një vonesë në mësimin e këtij veprimi. Të gjitha reflekset duhet të mësohen në një mënyrë zinxhir, vonesa në të mësuarit e njërës prej tyre bën që të lindin probleme.

Tek fëmijët të cilëve u krijohet një ambient shoqëror, vihet re perceptimi i shpejtë i ndjenjave miqësore. Fëmijët e vegjël janë të prirë për të zgjedhur shokë të së njëjtës moshë dhe me të cilët mund të luajnë të njëjtat lojëra. Në një farë mënyre fëmijët mësohen që të bëjnë gjëra të dobishme për jetën e tyre. Me kalimin e viteve fëmijët fillojnë që të ndryshojnë kriteret në zgjedhjen e shokëve; fillojnë të fitojnë rëndësi vlera si: besnikëria, drejtësia, mirëkuptimi dhe besimi. Fëmija i kërkon këto vlera tek shokët e tij dhe mundohet që t'i ndreqë anët e këqija të shokëve të vet. Në këtë mënyrë, kjo miqësi e krijuar në bazë të dobive reciproke fillon të bëhet më e thellë dhe kompakte. Fëmijët që nuk krijojnë shoqëri në moshën e fëmijërisë janë të prirë që në moshë madhore të mundohen që t'i krijojnë shoqëritë në bazë interesi; prandaj nuk arrijnë që të krijojnë shoqëri të qëndrueshme.

Për çdo grupmoshë ekzistojnë probleme të caktuara. Fëmija ka nevojë që këto probleme t'i zgjidhë vetë, sepse kjo do ta ndihmojë shumë në jetën e vet në të ardhmen dhe do të ndihmojë zhvillimin e fëmijës. Mos të harrojmë se fëmijët diskutojnë shumë shpesh me njëri- tjetrin, por nga ana tjetër ata pajtohen shumë shpejt. Prindërit duhet t'i trajtojnë me maturi këto gjëra dhe t'i ndihmojnë fëmijët që të gjejnë rrugëdalje; një mënyrë e tillë e të vepruarit do të ndihmojë në zhvillimin e fëmijës.

Sado që nëna dhe babai të jenë njerëz të mrekullueshëm, ata nuk mund ta zënë kurrë vendin e shokëve të një fëmije dhe nuk do të mund ta ndihmojnë fëmijën që të fitojë gjërat që fiton nga shoqëria. Le të bëjmë sa më shumë dua që fëmijët tanë të krijojnë shoqëri me njerëz të mirë që do t'i ndihmojnë ta rrisin cilësinë e jetës dhe le të krijojmë kushtet që fëmijët tonë të rriten në një ambient të shëndetshëm.

Hutbe
të zgjedhura

Fëmija i mbarë

Ferit Piku

Allahu (xh.sh) thotë në Kuranin fisnik: "**Pasuria dhe fëmijët janë bukuri të kësaj bote, ndërsa punët e mira kanë shpërblim më të mirë tek Zoti dhe kanë shpresë më të madhe**". (Kehf, 46).

Fëmija është bukuria më e madhe, që mund të ketë prindi në këtë botë. Fëmija për prindin është si drita e syve. Fëmija ia mban gjallë emrin prindit edhe pasi ai të ketë ndërruar jetë. Por fëmija që është lumturia e prindit, mund të kthehet edhe në brengë të madhe. Ai mund të jetë bukuria e kësaj bote, por njëkohësisht mund të kthehet në hallin më të madh. Ai mund ta mbajë lart emrin e mirë të prindit, por edhe mund ta poshtërojë atë.

Përpara se fëmija të lindë, njeriu kërkon nga Zoti vetëm që të ketë fëmijë, duke menduar se do ta edukojë në formën më të mirë. Por pasi fëmija lind, të gjithë joshen nga bukuria, çiltërsia dhe naiviteti i fëmijës dhe harrojnë ta edukojnë atë. Dalëngadalë prindi thjesht kënaqet me fëmijën e tij, por harron ta edukojë atë. Por me rritjen e fëmijës rriten edhe kërkesat. Kështu prindit i shtohen hallet dhe brengat. Ndoshta ky fëmijë, për të cilin ti u lute që të vijë në jetë, një ditë bëhet brengë shumë e madhe për ty.

Fëmija i mbarë është dhurata më e madhe, që Zoti i jep njeriut pas besimit. Shumë njerëz luten që të kenë fëmijë, ndërsa njerëzit e mençur luten që Zoti t'iu japë fëmijë të mbarë. Fëmija i mbarë është ai, që kur e sheh të gëzon, kur i flet të dëgjon, ai që të ndihmon sa je i ri e kur të plakesh, ai përpiqet të t'i lehtësojë hallet. Është ai që kur ti vdes, të respekton me të gjitha mënyrat, ndërsa kur je në varr lutet për ty. Fëmija i mbarë me lejen e Zotit mund të ndërmjetësojë për ty.

Çdo prind ka aq shumë halle dhe shqetësime për fëmijën e tij, sa nuk do të mjaftonin net të tëra dimri për t'i treguar të gjitha. Të gjithë kanë dëshirë që fëmija i tyre të jetë i mirë, por si mund të arrihet kjo?! Si mundet që kjo dhuratë që na ka dhënë Zoti, të mos kthehet dënim kundër nesh?! Pas lejes së Zotit, duhen bërë disa punë dhe unë do të flas vetëm për tre prej tyre. Nëse i bëjmë këto punë, me lejen e Zotit fëmija jonë do të jetë i mbarë.

Detyra e parë është **MODELI**, sjellja jote, puna jote,



ajo që fëmija sheh tek ti. Shumë prindër ankohen, se djalin ia prishi shoqëria, shokët e këqij, por ndoshta vetë prindi nuk e ka bërë punën e tij, por e ka lënë fëmijën që të marrë atë rrugë që dëshiron, qoftë ajo e mirë apo e keqe. Fëmija imiton. Sidomos kur është i vogël, prindërit për të janë njerëzit më të mirë dhe nuk ka më të fortë dhe më të mençur sesa ata. Modeli i prindit instalon tek fëmija ose të mirën, ose të keqen. Këtu vlen shprehja "Çfarë do të mbjellësh, do të korrësh". Nëse sot i thua: "Po i ra njeri telefonit, ti thuaji se babi nuk është në shtëpi", nesër mos ia shkul veshin kur të gënjejë, se ia ke mësuar me gojën tënde. Nëse fëmija shikon babanë, që godet gruan e tij, mos u çudit nesër, kur të shikosh se ky fëmijë godet nënën dhe babanë e tij. Nëse fëmija sheh babanë e tij sesi falet, sesi komunikon urtë e butë në shtëpi, ai e merr si model prindin e tij edhe pse ndoshta ti nuk e ndjen diçka të tillë. Ashtu siç sillesh ti me fëmijën tënd, ashtu do të sillet edhe fëmija yt me njerëzit e tjerë. Dikush mund të thotë: "Kam dështuar në edukimin e fëmijës tim, nuk kam çfarë të bëj". Atëherë mos i prit shpresat, por rregulloje veten tënde, se ndoshta Zoti do ta rregullojë fëmijën tënd. Investo tek vetja jote, që Zoti të investojë tek fëmija yt. Nëse prindi është munduar ta edukojë fëmijën e tij dhe gjithmonë është lutur për të, por fëmija nuk ka marrë udhën e drejtë dhe prindi vdes me shqetësim për fëmijën e tij, mund të kalojë një kohë dhe fëmija yt merr rrugën e drejtë, pendohet për çfarë ka bërë dhe fillon jetën sipas urdhrave të Zotit.

Kurani na tregon, sesi Zoti dërgoi Musain (a.s.) bashkë me Hizrin në një udhëtim shumë të gjatë. Dikur ata arritën në një qytet dhe panë një mur të shtrembër. Hizri e drejtoi murin dhe Musai (a.s.)u çudit për këtë gjë. Hizri ia shpjegoi këtë gjë dhe i tha, se ai mur ishte i dy jetimëve të atij qyteti dhe nën mur kishte një thesar. Hizri e kishte bërë atë veprim, sepse babai i atyre fëmijëve kishte qenë besimtar i mirë dhe Zoti deshi t'i ndihmonte ata fëmijë për hatër të babait të tyre. Nëse ne rregullojmë veten tonë, inshallah Zoti do t'i drejtojë fëmijët tanë. Fëmija nuk dëgjon shumë me fjalë, por ai sheh me sy. Prandaj baballarët tanë i kujtojnë prindërit e tyre për sjelljet e tyre edhe pse ka vite që kanë ndërruar jetë.

Detyra e dytë është **KËSHILLIMI PËR MIRË DHE NDALIMI NGA E KEQJA**. Shumë prindër kanë shqetësim vetëm që ta ushqejnë apo ta veshin fëmijën e tyre. Shumë prindër ndjehen keq, se s'kanë para t'i blejnë një celular, disa të tjerë duan t'i blejnë fëmijës së tyre një makinë, të tjerë duan t'i blejnë një shtëpi dhe vazhdimisht janë të shqetësuar për këtë. Shkurt gjithë shqetësimi i prindërve është tek aspekti material. Pak prindër e dinë, që investimi më i madh është edukata që merr ky fëmijë. Sa përpiqen prindërit në këtë drejtim për fëmijët e tyre?! Kështilloje fëmijën për mirë, por me të mirë dhe me të butë. Ndaloje që të mos bëjë keq, por përsëri bëje këtë me të mirë dhe me të butë, sepse kurrë nuk do të arrish që ta edukosh një fëmijë me dhunë. Feja jonë na mëson, që t'i edukojmë fëmijët që të falen edhe pse nuk kuptojnë asgjë nga ato veprime, të cilat për momentin u duken të pakuptimta. Prindi edukon dhe fëmija skalitet. Profeti (a.s.)thotë: "**Fëmija lind në natyrën e pastër, por janë prindërit ata që e bëjnë çifut, të krishterë apo zjarrputist**".[1] Gjithashtu mësoje fëmijën tënd që ta thotë të vërtetën dhe të mos gënjejë kurrë. Mos u mërzit kur të thyen një gotë apo diçka më të madhe se ajo. Njeriu duhet të mërzitet, kur mëson se fëmija i tij gënjen dhe mashtron. Gotat blihen përsëri, por vesi është i vështirë për t'u hequr. Prandaj edukojë fëmijën që ta ketë zemrën e madhe. Të respektojë jo vetëm ty dhe nënën e tij, por edhe dajallarët, hallat, farefisin dhe të gjithë njerëzit e kësaj toke. Sot kemi shumë familje të ngushta, që nuk dalin jashtë portës së shtëpisë së tyre. Zoti na porosit në Kuran: "**O ju që keni besuar! Ruani vetet tuaja dhe familjet tuaja nga zjarri i xhehenemit**". (Tahrim: 6). Në këtë ajet përmendet edhe familja, sepse në përgjithësi prindi është shkaktari kryesor, që familja e tij të përfundojë në zjarrin e xhehenemit ose anasjelltas. Pra edukoje fëmijën tënd, se ky është investimi më i madh që mund të bësh për veten, për fëmijën dhe për gjithë shoqërinë.

Detyra e tretë është **LUTJA** për fëmijët e tu. Bëj dua' (lutje) për fëmijën tënd, se ai nuk është krijesa jote, por është krijesë e Zotit dhe kur ta shohësh që ai ka devijuar, lutju Allahut (xh.sh) ta drejtojë e ta udhëzojë fëmijën tënd. Feja na mëson që të bëjmë dua' përpara se fëmija të lindë. Kur të lindë fëmija, duhet t'i thërrasim ezanin dhe ikametin. Të bësh dua' për të është shumë më mirë, sesa ta shash për diçka jo të mirë që ka vepruar. Prandaj profetët e Zotit luteshin gjithmonë për fëmijë të hairit dhe Zoti na urdhëron për këtë në Kuran.

Por nëse nuk ke mundësi të lutesh për mirë, kij kujdes të mos lutesh për keq. Mos u lut kundër fëmijës tënd dhe mos e mallko atë, çfarëdo lloj gjëje që të ketë bërë. Mos e mallko, sepse ti je i pari që do ta paguash faturën e këtij mallkimi. Shumë njerëz i mallkojnë fëmijët e tyre dhe kur lutja e tyre plotësohet dhe fëmijët e tyre gjenden në hall, prindërit e tyre janë më në siklet se vetë fëmija i tyre, pasi e vuajnë këtë gjë, të cilën e kanë bërë me gjuhët e tyre. Pra bëni kujdes dhe lutuni për fëmijët tuaj në vend që t'i mallkoni ata. Profeti (a.s.)thotë: "**Lutuni për çdo gjë. Mos u lutni kundër veteve tuaja. Mos u lutni kundër fëmijëve tuaj, mos u lutni kundër pasurisë tuaj**".[2]

Një prind shkon bashkë me fëmijën e tij tek një dijetar i quajtur Muhamed Ibn Sirin dhe i thotë: "Ky fëmijë ma ka sjellë në majë të hundës. Çfarë mund të bëj unë me të"! Por dijetari e pyeti: "A je lutur ndonjëherë kundër këtij fëmije?" Burri tha: "Të them të drejtën po, jam lutur". Atëherë dijetari i tha: "Shko

1. **Hadith i vërtetë**. Buhariu (1359) dhe Muslimi (2658).
2. **Hadith i vërtetë**. Muslimi (3009) dhe Ebu Daudi (1532).

se ti ia ke shkatërruar jetën këtij fëmije, përpara se ai të shkatërrojë jetën tënde". Prandaj kurrë nuk duhet të lutemi kundër fëmijëve tanë, se vallahi ne do ta vuajmë shumë këtë gjë.

E lus Zotin që t'i bëjë fëmijët tanë të mbarë, t'i ruajë Zoti nga çdo e keqe, t'i bëjë këta fëmijë gëzim e lumturi për ne në këtë botë dhe në botën tjetër.

Shpresoj se këto fjalë që thamë, do të jenë një tërheqje vëmendje për një investim shumë të madh, që pak njerëz e bëjnë e ai është Investimi tek fëmijët. Investimi më i madh është edukata, sjellja, vlerat e këtij fëmije. Për Zotin do t'ia shohësh hairin në këtë botë dhe në botën tjetër. Historia që do të tregoj tani nxjerr në pah, se fëmija është gëzim dhe lumturi jo vetëm për prindin, por për mbarë shoqërinë.

Flitet për një zonë, ku njerëzit nuk ishin shumë besimtarë, nuk e kishin frikë Zotin, nuk e njihnin botën tjetër. Imami i xhamisë gjithmonë pas namazit të xhumasë merrte djalin e tij 11-vjeçar dhe të dy bashkë dilnin për të shpërndarë një libër të vogël që titullohej "Rruga për në xhenet", duke shpresuar që dikush ta lexonte dhe t'i drejtohej zemra. Në një nga xhumatë po binte një shi i rrëmbyeshëm. Fëmija ishte veshur mirë, sepse ishte përgatitur që të dilte në rrugë, por kur ia tha të atit për të dalë, babai i tij iu përgjigj: "Nuk është kohë për të dalë sot, sepse po bie shumë shi dhe nuk ka as njerëz". Fëmija i thotë: "Baba! Ti më ke thënë se ka shumë njerëz, që nuk e njohin Zotin. Prandaj edhe pse bie shi, njerëzit përsëri kanë nevojë që dikush t'ua kujtojë Zotin". Por babai i tij refuzon që të dalë. Atëherë djali merr leje nga i ati, që të dalë vetë e të shpërndajë libra. Ky fëmijë doli me çiltërsinë e tij, duke u shpërndarë broshura të gjithë njerëzve që po kalonin, derisa në fund i mbetet vetëm një libër, i cili ftonte për në xhenet. Nuk kishte më njerëz rreth e rrotull tij, por ai ishte betuar, që nuk do të shkonte në shtëpi, derisa t'i kishte shpërndarë të gjithë librat. Atëherë mendoi të trokasë në derën e ndonjë shtëpie. Shkoi dhe trokiti në derën e një shtëpie. Trokiti një herë, dy herë, tre herë. Kur po bëhej gati të ikte, pasi askush nuk po i përgjigjej, një zë nga brenda i tha që të kthehej dhe të trokiste përsëri. Ai u kthye dhe filloi t'i binte fort derës, madje edhe vetë po çuditej që po e bënte një veprim të tillë. Kaluan gati 10 minuta dhe askush nuk po përgjigjej. Djali u bë gati të ikte, por në atë moment dikush e hapi ngadalë derën e shtëpisë. Doli një grua e përlotur. Dukej se kishte halle dhe probleme. Ajo pa këtë fëmijë me sytë që i ndrisnin, ndërsa shiu sa vinte e shtohej. Djali i zgjati librin dhe i tha: "O nënë! Zoti të do shumë ty. Lexoje këtë libër". Pastaj iku si era. Çfarë ndodhi?! Pas një jave, imami pasi mbaroi mësimin që mbante për njerëzit, u tha nëse kishin ndonjë pyetje. Një grua nga fundet e rreshtave të grave u ngrit dhe tha: "I nderuar imam! Me siguri ti nuk më njeh mua e as këto shoqet e mia nuk më njohin. Ka pak kohë që më ka ndërruar jetë burri. Të gjithë njerëzit më braktisën, sikur s'më njihnin. Kur e pashë veten në atë gjendje dhe kur e pashë motin e zymtë me shi dhe rrebesh, shkova në katin e dytë të shtëpisë time dhe vendosa të var veten time. Por çuditërisht filloi të binte dera. Kujtova se mos është ndonjë kalimtar i rastit dhe prandaj nuk e hapa derën për 5 minuta. Por kur dera filloi të binte me forcë, atëherë pyeta veten se kush interesohej për mua. Dola dhe pashë një fëmijë, që i ndriste fytyra dhe sytë nga gëzimi. Më zgjati një libër dhe më tha: "Nënë! Zoti të do ty". Pastaj iku me të shpejtë. Mbeta vetëm me librin në dorë. Libri titullohej "Rruga për në xhenet". Kur lexova atë libër, pashë që po bëja gjynahun më të madh, po vrisja veten time. E pashë që Zoti kishte menduar për mua dhe sot jam në këtë vend falë Zotit dhe shkak për këtë është ai fëmijë, që më dha atë libër". Imami e dinte, që ai fëmijë ishte djali i tij 11-vjeçar, i cili insistoi të dilte atë ditë. Të gjithë njerëzit qanin nga gëzimi. Imami u ngrit, e puthi djalin e tij në ballë dhe tha: "Ty të bëri Zoti shkak për ta shpëtuar atë grua dhe jo mua. Unë them fjalët, por punën e bëre ti". Kjo është kënaqësi dhe realisht fëmija i mirë është gëzim për prindin e tij, por është pasuri e madhe për të gjithë njerëzit e tjerë.

> E LUS ZOTIN QË T'I BËJË FËMIJËT TANË TË MBARË, T'I RUAJË NGA ÇDO E KEQE, T'I BËJË GËZIM E LUMTURI PËR NE NË KËTË BOTË DHE NË BOTËN TJETËR.

Prandaj Zoti na ndihmoftë që të bëhemi të mirë në veten tonë, që të ndikojmë sadopak tek fëmijët tanë. Atyre që Zoti nuk iu ka dhënë fëmijë, e lus Zotin t'iu japë fëmijë të mirë. Atyre që Zoti u ka dhënë fëmijë, inshallah Zoti i ndihmon që t'i edukojnë fëmijët e tyre. Atyre që Zoti i ka sprovuar dhe fëmijët e tyre kanë devijuar nga rruga e drejtë, Zoti me mëshirën e Tij i ktheftë në rrugën e hairit dhe i largoftë nga shoqëria e keqe. Atyre që Zoti i ka sprovuar, duke ua marrë jetën e fëmijëve të tyre, inshallah Zoti u jep durim dhe i bën ata fëmijë ndërmjetësues për prindërit e tyre në botën tjetër, pasi profeti (a.s.)ka thënë: "**Kur Zoti ia merr robit të vet fëmijën dhe ai bëhet i durueshëm, do të ketë si shpërblim Xhenetin**".[3] Zoti i bëftë fëmijët tanë të mirë dhe të mbarë dhe ne na bëftë fëmijë të mirë për prindërit tanë, pasi edhe ata persona që janë me thinja në kokë, ta dinë se janë fëmijët e dikujt. Zoti na ndihmoftë gjithmonë.

Amin!..

3. **Hadith i vërtetë**. Buhariu (6060).

Sekreti i suksesit të vezirit

Ferudun Ozdemir

Një ditë Sulltan Javuz Selimi mblodhi të gjithë vezirët e tij me qëllim që të përcaktonte si "kryevezir" atë që do të përmbushte dëshirën e tij duke u kërkuar:

"Më sillni një unazë të tillë që kur ta shohë një njeri i trishtuar të lumturohet. Po ashtu kur ta shohë një njeri i lumtur, ta humbasë lumturinë."

Pasi dëgjuan kërkesën e Sulltanit, të gjithë vezirët iu vunë punës. Dolën në tregje e pazare, pyetën e kërkuan rreth e rrotull. Koha kaloi dhe erdhi vakti për t'u përgjigjur para sulltanit. Kështu vezirët dolën para tij me unazat e përgatitura dhe nisën t'i përshkruajnë. Gëzimi i Sulltan Javuz Selimit lexohej lehtë në fytyrë...

Unazën e përgatitur nga çdo vezir, Sulltani fillimisht e vendosi në dorën e një të varfri, i cili u lumturua nga ky vlerësim. Më pas të njëjtat unaza Sulltani i vendosi edhe në dorën e tij, por nuk u pa ndonjë ndryshim në gjendjen e tij emocionale.

Koha kaloi dhe teksa një nga vezirët vendosi në dorën e tij një tjetër unazë, papritmas lumturia në fytyrën e Sullat Selimit u zhduk. Provuan t"ia vinin të njëjtën unazë një të varfri por gjendja e tij nuk ndryshoi, ishte përsëri i qeshur dhe lumturia e tij lexohej lehtësisht.

Pas kësaj, Sulltan Selimi pa humbur kohë e shpalli atë kryevezir. Të habitur nga kjo gjendje, vezirët e tjerë vrapuan ta pyesnin kryevezirin si e arriti këtë sukses:

"Ç'ishte ajo unazë që papritmas rrëmbeu lumturinë e Sulltanit? Si është e mundur që e njëjta unazë e lumturoi pafundësisht të varfrin e gjorë?"

Kryeveziri u përgjigj me delikatesë:

"Krejt e thjeshtë! Një ditë teksa po shëtisja i lumtur në treg një njeri asket ma preu rrugën dhe më vështroi me një shikim të mprehtë. Më pas me një ton qortues më tha:

"Edhe kjo shkon e vjen!"

Kur i dëgjova këto fjalë papritmas u mërzita, u trishtova. Ndërsa një lypsar që po qëndronte diku në qoshe të rrugës, pasi na dëgjoi, i qeshi fytyra, u gëzua, u lumturua...

Aty e kuptova që ishte kjo ajo që po kërkoja, prandaj menjëherë e shkrova këtë shprehje në unazën që i dhashë sulltanit. Kështu, sapo e vendosi në dorë, lexoi shkrimin: ***"Edhe kjo shkon e vjen!"*** dhe gëzimi u venit në çast. Sepse të gjithë ne e dimë se çdo gjë është e përkohshme, kalimtare...!"

Konsideroje veten në këtë botë, një mysafir i ftuar për gosti në një saraj mbretëror. Mos ia ngul sytë bukurive të sarajit sepse asgjë prej tyre nuk mund të jetë e jotja. Mos mendo se do qëndrosh pafundësisht në saraje sepse ti nuk je tjetër vetëm se një mysafir i ftuar. Herët a vonë do largohesh. Nëse mendon kështu nuk do mërzitesh kur të ikësh. Por nëse harron se je një mysafir i përkohshëm, kur të ndahesh do mërzitesh, dëfrimet e kohës do kthehen në dhimbje...

Përktheu dhe përshtati: Elona SYTARI





USHQIMET E DOMOSDOSHME
për një shëndet të mirë

Janë disa produkte që nuk duhet të mungojnë asnjëherë në shtëpinë tonë. Këto produkte, jo vetëm pasurojnë edhe më shumë tryezën tonë, por edhe e shkurtojnë kohën e përgatitjes së tyre.

FRUTAT DHE PERIMET

Shpeshherë konsumimi i drithërave, i brumërave dhe i sheqerit sjellin një mbingopje të organizmit me karbohidrate. Prandaj këshillohet të konsumohen frutat dhe perimet, duke qenë të pasura me vitamina dhe betakaroten e ato janë antioksidantë të fuqishëm që ndihmojnë. Në vazhdim do të paraqesim disa këshilla për shëndet të mirë.

Bananet, sallata jeshile, limoni, trangujt, karotat, ananasi, brokoli, kungulleshkat, patatet, frutat dhe perime të tjera meritojnë vend të posaçëm në frigoriferin tonë, sepse janë shumë ushqyese, kanë vitamina dhe minerale të cilat nuk mund t'i gjejmë në produkte tjera, kanë numër të ulët të kalorive e disa nga to nuk kanë fare kalori, përgatiten lehtë dhe konsumohen të kombinuara me shumë lloje të ndryshme të mishrave. Ato kanë efekte të jashtëzakonshme shëndetësore në të gjithë trupin, prandaj konsumimi i tyre preferohet shumë. Frutat dhe perimet mund të konsumohen shumë mirë edhe në formën e lëngjeve. Lëngje të këtilla janë shumë ushqyese dhe i japin organizmit energji gjatë tërë ditës Ato mund të konsumohen në çdo kohë. Është mirë që në lëngjet e frutave dhe perimeve të mos përdore sheqer, sepse mund të shtojë numrin e kalorive. Lëngjet e tilla konsiderohen edhe si ushqime dietike.

MERRNI SA MË SHUMË SELEN

Minerali i selenit është një ndihmës i mirë në luftën kundër kancerit, obezitetit dhe mbipeshës. Personat, të cilët kanë të ulët nivelin e selenit në gjak apo antioksidantëve të tjerë kanë një bel më të trashë se ata persona që kanë një nivel më të lartë seleniumi. Seleni gjendet te drithërat, djathi dhe arrat.

SHTONI USHQIMET E PASURA ME PROTEINA

Të hani një ushqim sa më të pasur me proteina ju jep shumë energji. Por, konsumimi i tepruar mund të sjellë dhe mungesë kalciumi. Është e nevojshme që 25 për qind e kalorive të merret nga proteinat. Nëse ju konsumoni 2000 kalori në ditë, 500 prej tyre duhet të jenë proteina. Produkte të nevojshme janë: qumështi, kosi, peshku, mishi etj.

KONSUMONI YNDYRAT E DUHURA

Disa studime kanë treguar se për të pasur një trup sa më elegant duhet të konsumohen yndyra të pangopura të gjendura te vaji i ullirit, omega-3 i gjendur te peshku në forma vajore, yndyrat omega-6 që gjenden te vaji i misrit, te vezët, etj.

KUJDES!

Është e shëndetshme dhe preferohet që të mënjanohen produktet e konservuara nga frigoriferi ynë për shkak të koncentrateve që posedojnë dhe disa herë të kontrollojmë afatin e qëndrueshmërisë së një produkti për shkaqe shëndetësore.



DUHANI DËMTON edhe shikimin

Përveç zemrës dhe mushkërive, pirja e duhanit më shumë se 20 cigare në ditë mund të dëmtojë edhe sytë, sipas zbulimit të universitetit Rutgers.

Në këtë studim janë përfshirë 71 persona të shëndetshëm, tetë nga të cilët kanë pirë më pak se 15 cigare në ditë, dhe 63 persona që pinin më shumë se 20 cigare në ditë. Pjesëmarrësit ishin midis moshave 25 dhe 45 vjeç.

Studiuesit kanë shqyrtuar mënyrën dhe nivelet e kontrasteve (dallime delikate në mbrojtjen nga drita) dhe ngjyrave nga një monitor CRT.

Rezultatet treguan ndryshime të rëndësishme tek duhanpirësit në lidhje me shikimin e ngjyrave të kuqe dhe gjelbër dhe ngjyrave blu dhe të verdha, i cili sugjeron se konsumimi i substancave kimike, të tilla si ato të përfshira në cigare, mund të shkaktojë një humbje të përgjithshme të vizionit të ngjyrave.

Studimi tregon se duhanpirësit e rëndomtë kanë një aftësi më të reduktuar për të dalluar kontrastet dhe ngjyrat se sa joduhanpirësit.

Edhe pse kërkimi nuk jep një shpjegim fiziologjik për rezultatet, ekipi i shkencëtarëve thekson se nikotina dhe tymi dëmtojnë sistemin e enëve të gjakut si dhe retinën e syve.

DËMET E MUNGESËS së Kalciumit

Kalciumi është shumë i përhapur dhe në organizmin e njeriut ka rreth 1 deri 1.5 kg kalciumi. Pothuajse 100 për qind e kalciumit në trup gjendet në kocka dhe dhëmbë, dhe ai është i nevojshëm për një trup të shëndetshëm dhe funksionim të mirë të të gjithë organizmit.

NGËRÇET NË MUSKUJ

Simptomat e mungesës së kalciumit në organizëm përfshijnë: dridhje në gishtat dhe ngurtësi, spazma të muskujve dhe dhimbje gjatë konvulsione, oreks i dobët, marrja e dobët e ushqimit, ritmi jonormal i zemrës, dhimbje në laring, vështirësi në frymëmarrje, depresion, madje edhe psikozë.

DËMTIMI I TRURIT DHE ZEMRËS

Në rast të defektit afatgjatë mund të ndodhë dëmtimi i trurit dhe dëmtimi i përhershëm i zemrës. Pjesët e para të trupit në të cilin do të ndjeni mungesën e kalciumit janë muskujt dhe eshtrat. Përveç kësaj, rreziku i marrjes së osteoporozës si dhe frakturave të kockave rritet.

Përveç kalciumit, është e rëndësishme që të keni mjaft vitaminë D dhe magnez, pasi ato luajnë një rol të madh në thithjen e duhur të saj. Ushqime të pasura me kalcium janë: algat detare, qumështi dhe produktet e tij, spinaqi, panxhari, rrepka, bizelet, lakra, brokoli, mjalti, fiq të thatë, banane, bajame, portokalli.

Trupi nuk mund të prodhojë kalcium në mënyrë të pavarur. Ju nuk keni nevojë të merrni ndonjë shtesë nëse e hani atë mjaftueshëm përmes dietës suaj. Trupi absorbon më mirë kalciumin nëse e administron atë përmes dietës, krahasuar me plotësimin, dhe disa studime kanë treguar se shtesat e kalciumit mund të rrisin rrezikun e gurëve të veshkave.





APPLE ME ORË INTELIGJENTE PËR EKG

Seria e pestë e orës së mençur Apple do të vijë me dizajn të përmirësuar qeramike dhe mbështetjen elektrokardiogram në rajone të shumëfishta. Kjo bazohet në detajet më të fundit nga raporti i investitorëve, i cili erdhi nga analisti Ming-Chi Kuo.

Funksioni EKG është aktualisht në dispozicion vetëm për përdoruesit në SHBA, pasi që Apple duhet të merret me rregullore të ndryshme shëndetësore në vende të ndryshme, në mënyrë që të zbatojë këtë funksion në elektronikën e saj.


Problemi me kalimin e kësaj karakteristike në një orë të zgjuar është se pajisja bëhet një "pajisje mjekësore", një kategori krejtësisht e ndryshme, e rregulluar me ligje dhe rregulla të ndryshme.

Përveç kësaj, Kuo përmend se Apple Watch Series 5 do të ketë një dizajn të ri prej qeramike. Nuk dihet saktësisht se çfarë do të thotë kjo, por dihet se versionet premium të qeramikës të modeleve më të hershme të Apple Watch kishin disa probleme, kështu që ridizajni ka kuptim.

SHKENCËTARËT ZBULOJNË ORËN E DYTË BIOLOGJIKE NË TRUPIN E NJERIUT

Shkencëtarët e Harvardit kanë gjetur ADN ribosomale të njohur si ora rDNA, ose një orë biologjike që zbulon se sa vjeç jemi. Dr. Bernardo Lemos, një profesor i epigjenetikës mjedisore në Harvard, thotë se pjesë të vogla të ADN-së mbledhin sinjale rreth viteve aq mirë sa shfaqin vitet tona biologjike. Ai dhe bashkëpunëtorët e tij thanë se rDNA ishte një "armë tymi" në kontrollin gjenom të plakjes. Ata mendojnë se ai mund të shpjegojë orën e mëparshme të panjohur.

Për të përcaktuar sa shpejt ose ngadalë ora biologjike prek secilin prej nesh, shkencëtarët po kërkojnë metilatin, një molekulë të vogël në ADN. Ora biologjike është pjesë e një gjenomi që ndihmon shkencëtarët të përcaktojnë atë që quhet orë biologjike, që tregon sa është trupi i dikujt në të vërtetë i vjetër në bazë të ndryshimeve që ndodhin në ADN dhe mund të ndihmojnë në parashikimin e sëmundjeve. Tani është shumë më e lehtë për shkencëtarët të ndjekin orën biologjike, pasi në vend që të shohin një sërë kromozomesh në disa vende, tani ata janë duke ndjekur vetëm një gjenom të veçantë.



"Ky është me të vërtetë një zbulim i madh pasi metilati përgjatë ADN-së mund të përdoret për përcaktimin e saktë dhe konfidencial të moshës. rDNA është ndoshta një hap në drejtimin e duhur për të lidhur disa orë të ndryshme mekanikisht", tha Lemos.

Ajo që i dha Lemos besim në zbulimin e tij është dobia e veçantë që ka bërë kur është fjala për përcaktimin e zgjedhjeve që trupi ynë i bën për të përshpejtuar ose ngadalësuar procesin e plakjes. Kur vëzhgoi orën rDNA në minj që ishin pjesë e eksperimentit, ai zbuloi se ora e tyre tregonte më pak sinjale të plakjes biologjike, edhe kur minjtë ishin më të moshuar.

Njohja e orës biologjike dhe mënyra e funksionimit të tij mund të na ndihmojë të ndikojmë në procesin e plakjes biologjike. Shkencëtarët po përpiqen të zbulojnë se si ushqimi përmes proceseve kimike përshpejton ose ngadalëson orën biologjike.

OPERATORËT BËJNË THIRRJE PËR TESTIME SIGURIE TË PAJISJEVE 5G

Industria e rrjeteve mobile bëri thirrje për implementimin e një skeme të re Evropiane për testimin e sigurisë së pajisjeve 5G përpara se të implementohen.

Disa vende kanë ndaluar kompani të caktuara për furnizimin e operatorëve lokalë me pajisje të rrjetit 5G për shkak të shqetësimeve të sigurisë. Gjigandi Huawei dhe ZTE janë dy prej kompanive më të prekura.

GSMA, një shoqatë e cila përfaqëson 800 operatorë celularë, tha një skemë testimi do të eliminonte nevojën për të bllokuar furnizues të ndryshëm. Australia, Zelanda e Re dhe Shtetet e Bashkuara kanë ndaluar Huawei të furnizojë operatorët celularë me pajisje për rrjetin 5G.

Kanadaja gjithashtu po kryen hetime ndaj produkteve të Huawei ndërsa gjigandi Britanik BT ka vendosur të heqë pajisjet e Huawei nga bërthama e rrjetit 5G.

Shumë vende tremben se qeveria Kineze përdor Huawei për të spiunuar rivalët dhe vjedhur informacione. Huawei është shprehur disa herë se nuk ka lidhje me qeverinë Kineze dhe nuk i bashkon asgjë përveç taksave. Por kritikët vënë në pikëpyetje lirinë e çdo biznesi Kinez përballë influencës së Pekinit. GSMA shqetësohet se bllokimi i kompanive si Huawei mund të shtyjë implementimin e 5G-së dhe të rrisë kostot.

"Pasoja të tilla janë plotësisht të shmangshme," thuhej në deklaratën e GSMA.

Institucioni shpreson që të krijojë një task force Evropiane për të testuar pajisjet. GCHQ Britanike kishte bërë testime të pajisjeve të Huawei dhe kishte evidentuar "mangësi" duke mos dhënë garanci se firma nuk përbën kërcënim. Deklarata e GSMA gjeti mbështetjen e Deutsche Telekom dhe Telefonica. Vetë Huawei është anëtar i GSMA dhe një prej mbështetësve më të mëdhenj të Kongresit Mobil Botëror që do të mbahet në fund të muajit nga GSMA.



“O besimtarë,
mos i bëni miq
armiqtë e Mi dhe tuajit,
duke u shprehur
atyre dashuri,
ndërkohë që ata
kanë mohuar
të vërtetën...”

(Mumtehine, 1)



ISSN 2227-3611